

1 E mërkurë, 12 nëntor 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, kjo është
8 lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
11 procesverbal, vërej që të akuzuarit janë të gjithë të
12 pranishëm në sallën e gjyqit.

13 Do të vijmë sot me dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes së
14 z. Thaçi 1DW008. Përpara se të fillojmë me dëshminë e
15 dëshmitarit, është një aspekt paraprak që dëshiroj ta trajtoj.
16 Është një urdhër me gojë, pra, që dua të jap.

17 Së pari, dje gjatë seancës Trupi Gjykses shënoi tri faqe
18 të materialit DHT03918-DHT03940 për identifikim dhe i dha
19 numrin përkatës P04508. Materiali përkatës është një
20 intervistë, në fakt, me Wolfgang Petritsch që është marrë nga
21 një libër. Mbrojtja e Thaçit e kundërshton pranimin e
22 materialit sepse sipas tyre është një pretendim i ri në thelb
23 dhe pretendimi apo akuza është në kundërshtim me argumentet e
24 ZPS-së e veçanërisht është në kundërshtim me materialin e ZPS-
25 së që ka numrin P02094. Mbrojtja e Thaçit pretendon se nuk

1 janë njoftuar në kohë dhe ZPS-ja në këtë fazë të procesit nuk
2 duhet të dalë me një argument të ri që është në kundërshtim me
3 argumentet e tyre të mëparshme.

4 ZPS-ja u përgjigj se kundërshtimi është i pabazë sepse
5 dëshmitari e trajtoi çështjen e shkëmbimit të të burgosurve,
6 përshirë edhe cili prej UÇK-së ka marrë pjesë në takimet gjatë
7 këtyre shkëmbimeve dhe këtë e bëri gjatë pyetjeve të palës
8 thirrëse, edhe prandaj është krejt normale që ata të kërkojnë
9 pranimin e materialit. Fakti se materiali pranohet si dëshmi
10 nuk nënkupton se materiali pasqyron pozicionin e ZPS-së në
11 mënyrë përfundimtare. Gjithashtu, dy dëshmitë e dy materialeve
12 nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën në mënyrë ekskluzive dhe
13 materiali i është dhënë ZPS-së nga Mbrojtja e Thaçit kështu që
14 nuk mund ta nxirrnin më herët, nuk mund ta kërkonin për pranim
15 më herët.

16 Fillimisht, Trupi Gjykses vëren se materiali është
17 nxjerrë në listën e materialeve të Mbrojtjes së Thaçit më 28
18 maj 2024, pra, dhe ka qenë i disponueshëm për palët dhe
19 pjesëmarrës. Sidoqoftë Trupi Gjykses vlerëson se materiali
20 është relevant sa i takon njohurive që kanë pas të akuzuarit
21 dhe nëse kanë marrë pjesë në negociata për persona që
22 mbaheshin të ndaluar.

23 Së pari, Trupi Gjykses nuk pajtohet me pretendimin e
24 Mbrojtjes së Thaçit se përmbajta e këtij materiali është
25 domosdoshmërisht në kundërshtim me materialin që është me

1 numrin P02094. Veçanërisht, Trupi Gjykses vëren se thirrjet
2 duket sa janë mbajtur në data të ndryshme dhe kanë qenë me
3 persona të ndryshëm dhe të dyja thirret, në fakt, kanë ndodhur
4 në realitet. Trupi Gjykses vëren më tej se përputhshmëria apo
5 natyra kontradiktore e këtij materiali me prova të tjera që
6 janë pjesë e provave gjyqësore duhen vlerësuar në tërësinë e
7 tyre dhe kjo do të bëhet në fund të gjykimit.

8 Sa i takon autenticitetit, Trupi Gjykses është i bindur
9 se intervista është autentike *prima facie*. Është një pjesë e
10 një libri që është botuar dhe që përmban prejardhjen, datën,
11 autorin dhe emrin e të intervistuarit. Faqe të tjera të këtij
12 materiali tashmë janë pranuar si prova gjyqësore dhe kanë
13 marrë numrin 1D00147.

14 Sa i takon vlerës provuese, Trupi Gjykses është i bindur
15 se dëshmitari ka dhënë kontekst të mjaftueshëm.

16 Sa i takon dëmit që i shkakton Mbrojtjes, Trupi Gjykses
17 vlerëson se është e rëndësishme të trajtohet fakti që Mbrojtja
18 e Thaçit kundërshton për faktin se nuk janë njoftuar në kohë.
19 Trupi Gjykses vlerëson se mungesa e pretendimit se z. Thaçi
20 supozohet se ka marrë pjesë në procesin e lirimit të disa
21 burgosurve gjendet e përcaktuar në dosjen gjyqësore, në
22 kundërshtim me pretendimin e Mbrojtjes së Thaçit për faktin se
23 ZPS-ja ka tërhequr dëshmitarit që mund t'i kishte përdorur për
24 të pranuar këtë material, nuk mund të kuptohet si fakt se ZPS-
25 ja ka dashur të manipulojë argumentet e veta.

Trupi Gjykses vëren më tutje se Mbrojtja e z. Thaçi ka pasur njohuri dhe ka dijeni për pjesëmarrjen në negociata për personat e ndaluar. Në këtë aspekt Trupi Gjykses udhëzon palët dhe pjesëmarrësit që, ndër të tjera, materialet P01091, P01092, P02094, edhe të shohim po ashtu provat e Dëshmitarit 04147, më konkretisht bëhet fjalë për transkriptin 14011. Pra, këtu mund të gjendet materiali përkatës. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk pajtohet me Mbrojtjen e Thaçit se ky material në thelb është një akuzë e re apo një pretendim i ri dhe se nuk janë njoftuar në kohë dhe se kjo atyre iu shkakton cenim.

Lidhur me këtë pikë Trupi Gjykses vëren se ka qenë pikërisht Mbrojtja e Thaçit që ka nxjerrë dëshmi nga Dëshmitari 008 lidhur me këtë aspekt. Prandaj është krejt e drejtë për palën kundërshtare ta trajtojë këtë aspekt me dëshmitarin për sa kohë është relevante për argumentet e tyre apo për provat e tyre.

Rrjedhimit, meqë palët kanë pasur shansin t'i bëjnë pyetje dëshmitarit lidhur me këtë material, Trupi Gjykses është i bindur se vlera provuese *prima facie* e këtij materiali nuk zhbëhet nga efekti cenues.

Kështu që Trupi Gjykses konstaton se materiali me numër provizor P04508 përmbush kriteret e rregullës 138 dhe pranon provat -- më falni, faqet përkatëse si prova gjyqësore. Duke mbajtur parasysh se faqet e këtij libri -- disa faqe të këtij libri janë pranuar si prova gjyqësore, Trupi Gjykses udhëzon

1 që materiali P04508 t'i bashkëngjitet materialit 1D00147 dhe i
2 kërkon Sekretarisë së seancës që të heqi numrin e përkohshëm
3 të kësaj prove.

4 Me kaq mbyllim urdhrin e parë dhe të vetëm me gojë për
5 sot.

6 Tani mund të sillni dëshmitarin në sallë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Sa i takon dëshmitarit tjetër, do
8 të vijë pas pushimit të drekës dhe duhet njoftuar ZMMD-ja Zyra
9 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve një orë më përpara që të bëjë
10 organizimin përkatës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
12 problem. Një orë mjafton.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
15 Dëshmitar. Do të vazhdojmë me pjesën e mbetur të dëshmisë
16 suaj. Ju rikujtoj të përgjigjeni qartë, me fjali të shkurtra.
17 Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirish kërkonit që pyetja të
18 përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që ta
19 sqarojmë. Gjithashtu, na thoni ku e bazoni njohurinë, faktet
20 dhe rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

21 Jeni ende nën detyrim për të thënë të vërtetën sikurse
22 vetë e cituat përmes deklaratës solemne.

23 Gjithashtu flisni afër mikrofonit dhe bëni një pauzë prej
24 pesë sekondash përpara se të përgjigjeni si dhe flisni ngadalë
25 për përkthyesit.

1 Në çdo moment që mendoni se keni nevojë për pushim, na
2 njoftoni dhe do të bëjmë organizimin përkatës.

3 Gjithashtu, e falënderoj përfaqësuesin e SHBA-së që ka
4 ardhur sot paradite, në çdo moment që keni nevojë të bisedoni
5 me dëshmitar apo doni t'i drejtoni Trupit Gjykses, mjafton që
6 të ngrini dorën dhe do t'ju japim fjalën.

7 Tani do të vazhdojmë me pyetjet e Trupit Gjykses. Do të
8 fillojmë me pyetjet e Gjykatës Mettraux që është në të
9 djathtën time, në të majtën tuaj.

10 DËSHMITARI: CHRISTOPHER HILL [Vijon]

11 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

12 Pyetje nga Trupi Gjykses:

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëmëngjes, Ambasador.

14 PË. Mirëmëngjes.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet që ju bëri
16 pyetje Mbrojtja e Thaçit lidhur me qëllimet e UÇK-së dhe si i
17 kishit kuptuar ju qëllimet e UÇK-së, objektivat e UÇK-së?

18 PË. Nuk më kujtohet të më kenë pyetur për objektivat e UÇK-
19 së. Diskutua pikëpamjet e mia, që unë mendoja se UÇK-ja donte
20 pavarësinë e Kosovës dhe rolin e tyre në këtë proces.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në flas për këtë e kisha
22 fjalën. Nuk dua të flas për objektivat, por unë dua të
23 trajtojmë bashkë këto objektiva, qëllime dhe kush i ka
24 shprehur publikisht këto qëllime. Po do ju bëj një pyetje
25 tjetër. Nëse UÇK-ja si organizatë kishte disa qëllime

1 politike, atëherë sigurisht që kishte persona përgjegjës që
2 duhet t'i materializonin këto objektiva, apo jo?

3 PË. Po, është logjike.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Asokohe kush ishte në UÇK,
5 kush ishte përgjegjës në UÇK që t'i realizonte këto objektiva?

6 PË. E kemi diskutuar këtë. Unë mendoj që z. Krasniqi është
7 shpallur publikisht si zëdhënës i UÇK-së, pra, ishte personi
8 që i bënte të ditura qëllimet.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë do ju tregoj
10 dokumentin nëse keni nevojë, por a ju kujtohet që në mes të
11 gushtit 1993 pasi ju i kishit kërkuar anëtarëve të UÇK-së të
12 evidentoheshin relatorët apo pikat e kontaktit, u lëshua një
13 komunikatë me disa emra që ishin përfaqësues politikë. Besoj
14 se ka qenë 13 gusht 1998, jo 1993.

15 PË. Më kujtohet që është bërë një njoftim publik në të cilin
16 kishte disa emra. Nëse mund të jap pikëpamjen time, sipas meje
17 edhe në cilësinë time si i dërguari i posaçëm, unë e kisha të
18 qartë dhe të tjerët ma kishin bërë të qartë se ne e dinim kush
19 fliste për UÇK-në.

20 Për shembull, z. Demaçi fliste për rolin që kishte ai në
21 UÇK, po askush nuk na e konfirmoi, askush tjetër nuk na e
22 konfirmoi këtë. Kishte shumë persona që prezantoheshin si
23 persona që flisnin në emër të UÇK-së. Problemi ynë ishte që
24 nuk kishim një pikë kontakti të konfirmuar me të cilin mund të
25 komunikonim për të ardhmen.

1 Çështja e pavarësisë së Kosovës ishte më shumë slogan. Të
2 gjithë thonin që ky është qëllimi ynë. Ishte shumë e vështirë
3 të gjeje ndonjë shqiptar në Kosovë që të thoshte duam thjesht
4 autonomi. Personat shpreheshin dhe thonin, "Unë e mbështes
5 faktin që Kosova duhet të jetë një republikë", por sikurse të
6 gjitha republikat e tjera të Jugosllavisë që ishin shkëputur
7 nga Jugosllavia, pra, kur thoshin republikë, krahasoheshin me
8 shtete të tjera që ishin shkëputur nga Jugosllavia.

9 Më falni që mbase po e shtjelloj shumë. Duke mbajtur këtë
10 parasysh ne filluam të kërkonim pika kontakti që mendonim që
11 ishin të besueshëm dhe vërtetë mund të flisnin në emër të UÇK-
12 së. Edhe unë kam kaluar, kam shpenzuar kohë me z. Demaçi sepse
13 ishte një person që kishte ndikim, ose do përdor një term
14 modern influences, influencer. Unë nuk besoj se ai fliste për
15 UÇK-në por fliste më shumë për veten.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do flasim dhe për z.
17 Demaçin për një rast, z. Ambasador. Por, a ju kujtohet se si i
18 shprehte qëllimet e veta politike UÇK-ja? A ju kujtohet, pra,
19 që këto, herë pas here, i shprehte përmes ideve politike të
20 ashtuquajturve deklarata politike ose komunikata?

21 PË. Po. Po edhe këto ishin shumë të mjegullta për ne sepse ne
22 nuk e dinim kush i lexonte këto komunikata. Ishin çështje
23 sigurie, për çështje sigurie që nxirreshin, apo vërtet nuk
24 ekzistonte një strukturë që në fakt të besonim dhe ne. Prandaj
25 ne nuk mund t'i përdornin këto komunikata si bazë për të

1 përcaktuar një strukturë vertikale organizative të UÇK-së.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt iu përgjigjët dy
3 pyetjeve të mia të radhës, se do ju pyesja a e dinit kush i
4 lëshonte këto dokumente. Dje na thatë se në një moment mësuat
5 se ekzistonte një drejtori politike pranë Shtabit të
6 Përgjithshëm.

7 PË. Po, kështu është, por nuk mund tua them se si e mësova
8 këtë. Nuk ka qenë në burime të hapura, burime publike.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe me sa kuptova unë, ju
10 mësuat se z. Thaçi ishte një nga anëtarët e këtij organi.
11 Kështu?

12 PË. Po, sepse në një moment u bë një njoftim, një shpallje
13 publike. Po e them këtë se kishte shumë persona, përshirë
14 persona që nuk ishin në qeveri, apo persona që punonin në
15 agjencitë e tjera amerikane që përpiqeshin po ashtu të mësonin
16 kush e drejtonte UÇK-në dhe nëse kishte ndonjë person që e
17 drejtonte UÇK-në. Kështu që kur dilnin emra të rinj ne
18 interesoheshim, dhe një prej këtyre emrave ishte emri i
19 drejtorit politik. Nuk ishim të qartë se çfarë ishte, çfarë
20 nënkuptonte ky pozicion, por për ne duhej kontaktuar ky
21 person.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ju ndihmoj dhe me
23 kujtesën mbase se si mund ta keni mësuar informacionin për
24 drejtorinë politike, por fillimisht dëshiroj t'ju pyes nëse e
25 dinit apo dini tani kush kanë qenë anëtarët e tjerë të

1 drejtorisë politike?

2 PË. Jo, nuk mund t'ju them tani kush janë, po mbase po të më
3 thoni ju disa emra, unë mund t'ju them nëse më thonë apo s'më
4 thoni diçka këta emra.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë do t'ju bëj një
6 pyetje tjetër.

7 I lutem Sekretarisë të nxjerrë në ekran provën P01078.

8 Ambasador, ky është një dokument që e keni parë tashmë.
9 Është një prej kabllogrameve.

10 Shkojmë pak më poshtë. Do të shikoni që data e dokumentit
11 -- shkojmë më poshtë, më lart, më lart - 1 mars 1999. E shihni
12 datën?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë më poshtë. Dhe
15 shohim që e keni klasifikuar ju, Ambasadori Christopher R
16 Hill. E shihni?

17 PË. Po. Nuk dua të përsëris shpjegimin që dhashë më përpara.
18 Ky është aspekt teknik.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj. Shkojmë në faqen
20 4 të dokumentit, ju lutem, 075372. Shkojmë pak më poshtë në
21 dokument.

22 Në mes, te paragrafi në mes është një fjali që fillon me
23 fjalët "Më në fund ...". E shihni?

24 PË. Ja ta lexoj një çast. "Shtabi i Përgjithshëm mund të
25 marrë vendimet për ..."

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ua lexoj unë fjalinë.

2 PË. E pashë, e pashë, po. Disa nga fjalët këtu janë
3 redaktuar. Unë po lexoj versionin që kemi në ekran. Thotë:

4 "Më në fund", pastaj një emër apo një funksion është
5 redaktuar, "i tha KDOM-it amerikan sot në mbrëmje se Demaçi u
6 emërua nga Shtabi i Përgjithshëm të kryente disa funksione
7 konkrete dhe këto funksione nuk përfshijnë vendimmarrje
8 politike për Shtabin e Përgjithshëm. Vetëm Shtabi i
9 Përgjithshëm me drejtorin politik që ka drejtimin mund të
10 marrë vendime politike."

11 Pyetja e parë që kam unë është nëse ju kujtohet ky
12 kabllogram dhe përmbajtja e këtij kabllogrami?

13 PË. Jo. Dua ta bëj të qartë se këto kanë qenë raportime të
14 rregullta që dorëzoheshin nga ekipi amerikan që ka qenë në
15 terren. Nuk ishin nga ekipi i OSBE-së, por OSBE-ja dhe
16 amerikanët punonin krah për krah me njëri-tjetrin. Ne e dinim
17 që ekipi amerikan kishte kontakte të mira, por nuk ishim
18 gjithmonë të sigurt se informacionet që merrnim ishin të
19 sakta.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni marrë ndonjëherë
21 ndonjë informatë që do ta kundërshtonte përmbajtjen e kësaj
22 deklarate që sapo lexuam?

23 PË. Nuk kam dëgjuar ndonjëherë që drejtoria politika ishte
24 pjesë e Shtabit të Përgjithshëm apo që të drejtonte ndonjë
25 gjë. Nuk e kam dëgjuar ndonjëherë dhe nuk ka qenë as supozimi

1 ynë.

2 Supozimi ynë, dua të jem i qartë, supozim në mungesë të
3 fakteve, pra, supozimi ynë ishte që Shtabi i Përgjithshëm
4 ishte më shumë organ ushtarak dhe përbëhej prej komandantëve
5 lokalë që ishin bashkuar në një mënyrë, në një moment dhe
6 drejtoria politike ishte më shumë organi që merrej me botën e
7 jashtme.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, që t'i përgjigjeni
9 pyetjes time, nëse nuk ju kujtohet mund të thoni që nuk ju
10 kujtohet. Po a keni marrë ndonjëherë ndonjë informacion që e
11 kontradikton informatën, informacion që sapo lexuam?

12 PË. Personat - po unë s'jam në pozicion kush ma ka thënë,
13 pra, personat thonin që s'duhet t'i marrim fjalë për fjalë
14 këto informacione. Ideja që drejtoria politike ka ndonjë rol
15 brenda Shtabit të Përgjithshëm ishte diçka që personat në
16 drejtorinë politike, përfshirë z. Demaçi, ishte një -- pra,
17 ishte një përpjekje për të treguar që ne kemi përgjegjësi dhe
18 jemi përgjegjës. Më falni, dua të vazhdoj.

19 Për ne kjo tregonte se bëheshin shumë përpjekje, në
20 kuptimin që personat donin ta konsolidonin pozicionin e tyre
21 dhe të ishin më të fortë se disa të tjerët. Nuk ishte një grup
22 personash i organizuar mirë që të kishin hierarki komanduese
23 dhe përgjegjësi komanduese të mira. Kjo ishte përshtypja jonë
24 gjatë të gjithë kohës, dhe fakti që ne nuk mund të gjenim një
25 person që të fliste në emër të të tjerëve, në fakt, i

1 konfirmonte dyshimet tona. Prandaj shkova në Shqipëri duke
2 shpresuar, emrin e kishte Zeka, Xhavit Haliti, po, Xhavit
3 Haliti, sepse menduam se mund të ishte ai personi. Sepse disa
4 persona në qeverinë amerikanë thonin që ky është personi që
5 drejton apo që kryen funksione të caktuara apo që siguron armë
6 për personat. Në bisedat me të ai nuk na tregoi shumë, dhe unë
7 fillova të dyshoja se mbase ai po fsheh diçka, po asgjë s'mu
8 konfirmua asnjëherë. Disa prej udhëtimeve që patëm në Shtime
9 dhe në vende të ngjashme, të gjitha udhëtimet i kemi bërë për
10 të zbuluar një person apo për të gjetur një person që mund të
11 fliste në emër të organizatës, por që nuk ndodhi asnjëherë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të flasim tani për z.
13 Demaçi. Do përpiqem t'ju jap disa sugjerime dhe ju mund të
14 jepni mendimin tuja. A mund të them unë që ju nuk kishit
15 mendim shumë të lartë për z. Demaçi asokohe?

16 PË. Ne, apo unë?

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju, nuk kishit mendim
18 shumë të lartë.

19 PË. Jo, unë do të përgjigjem me "ne", sepse unë nuk kisha
20 mendim të ndryshëm nga të tjerët. Ai ishte gjithmonë shumë i
21 rreptë, shumë strikt për çdo temë. Ai kishte një lloj mllëfi
22 se kishte qenë i burgosur dikur. Dihej dhe njihej si një
23 person me opinione shumë të forta dhe shumë të egra ndaj
24 Serbisë, jo vetëm në Kosovë po dhe pjesa tjetër e Jugosllavisë
25 e dinte këtë. Ai nuk ishte një person me të cilin mund të

1 bashkëpunojë. Nuk ishte një person që mund të punojë me një
2 dokument që në të vërtetë po ashtu kishin persona të tjerë të
3 cilët kishin dyshime. Kishte opinione shumë të forta lidhur me
4 disa rrethana në jetë, dhe shumë mirë që kishte opinionet e
5 veta dhe u qëndronte fort, por në aspektin e bashkëpunimit
6 ishte shumë i vështirë dhe ne nuk ishim të interesuar që të
7 promovonim atë si person.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur përpiqeshit -- kur po
9 përpiqeshit të formonit ekipin negociues në vjeshtën e '98-s
10 dhe të gjenit partnerë nga ana e LDK-së dhe UÇK-së, a mund të
11 them unë që z. Demaçi nuk ishte një prej personave që ju e
12 donit në këtë ekip për këtë qëllim?

13 PË. E saktë. E kam takuar disa herë sepse ndonjëherë personat
14 që kanë mendime të forta mund të ketë dhe ndikim. Dhe nuk doja
15 të isha në një situatë ku nuk e njihja apo nuk i dija mendimet
16 e tij. Por, për faktin e bashkëpunëtorëve tonë, personalisht
17 unë nuk isha në favor të z. Demaçi që ta konsolidonte këtë
18 ekip.

19 Duhet të kuptoni që në mungesë të sistemit komandues
20 sigurisht që kishte një lloj lufte për pozicione mes
21 personave. Edhe ai mendonte se ai kishte kaluar apo kishte
22 vuajtur më shumë se të tjerët dhe i takonte rrjedhimisht një
23 rol drejtues.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ju mendonit se nuk
25 ishte e drejtë kjo gjë?

1 PË. Nuk më takonte mua të caktoja kush duhet të kishte rol
2 udhëheqës apo rol drejtues, por unë nuk doja të ishte ai
3 personi që do ta konsolidonte këtë rol. Pra, ishte shqetësim
4 sepse kur takohen me amerikanët ata marrin një pozicion
5 tjetër. Kanë një lloj influence. Kështu që unë e takova
6 personin në mënyrë që të shmangia një situatë që ai ta
7 shfrytëzonte dhe takimin që të avanconte pozicionin e vet.
8 Mendoj se ai kishte problemet e veta me personat, kështu që
9 nuk mendoj se ja doli mbanë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt, ju keni bërë një
11 gjë të mirë, siç do ta shohim më vonë. Po a ju kujtohet që në
12 nëntor 1998, një person me origjinë serbe që kishte qenë
13 inspektor në policinë serbe u arrestua dhe u përfshi Shaun
14 Byrnes që të lirohej ky person?

15 PË. Nuk më kujtohet. Kanë ndodhur disa raste të këtij lloji
16 ku ekipi i Shaun, sepse ekipi i Shaun kishte kontakte të mira
17 me persona të ndryshëm, përfshirë personat që kishin armë në
18 terren, pra ishin në gjendje t'i bindnin këta persona që kjo
19 nuk është ide e mirë, dhe nëse qëllimi juaj është të keni
20 marrëdhënie më të mira me amerikanët, atëherë rrëmbimi i
21 personave nuk është gjëja e duhur që duhet të bëni. Siç më
22 kujtohet mua, në përgjithësi ka pasur disa raste të suksesshme
23 çka do të thotë disa persona janë liruar dhe sipas meje ky
24 ishte roli më i rëndësishëm për KDOM-in dhe për OSBE-në, në
25 fakt. Edhe pikërisht për këtë arsye, kur patëm takimin për

1 tetë ushtarët serbë, unë doja të sigurohesha që të ishte e
2 pranishme edhe OSBE-ja, sepse nëse do të ishim të suksesshëm,
3 në fakt, suksesin do e kishim prej OSBE-së dhe KDOM-it, dhe jo
4 prej meje, sepse roli im ishte rol negociues. Unë kisha rolin
5 që të arrinim në një status për Kosovën dhe të inkurajonim
6 personat që të ulnin armët edhe të punonin edhe t'i ktheheshin
7 jetës të përditshme.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'i kthehem ushtarëve
9 të Armatës Jugosllave pas një çasti, megjithatë për momentin
10 do t'i kërkoj Sekretares të paraqesë në ekran provën P188.
11 Faleminderit.

12 Ambasador, dokumenti që e keni në ekran është një libër
13 me kujtime i komandant Remit, Rustem Mustafa, që është
14 shkruar nga një person tjetër. Domethënë, autori është i
15 ndryshëm nga Remi. A ju kujtohet komandant Remi?
16 PË. Më kujtohet emri. Por, nuk më kujtohen rrethanat në të
17 cilat e kam dëgjuar këtë emër. Por mendoj që ai kuptohej që
18 ishte një prej luftëtarëve të UÇK-së.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares të
20 kalojmë në faqen 82 të librit. Më thuhet që është faqja 14 në
21 versionin në PDF.

22 Ambasador, do ju kërkoja t'i hidhnit një sy dokumentit në
23 të majtë, pranë kolonës në të majtë. Diku në tekst është një
24 pyetje ku fillon si më poshtë: "Ndërkohë që keni qenë në Shalë
25 ende ...". Domethënë thjesht më lejoni t'jua shpjegoj se për

1 çfarë bëhet fjalë.

2 Është një libër, dhe në këtë pjesë është botimi i një
3 interviste të dhënë nga Remi. Domethënë, pyetjet janë shënuar
4 me ngjyrë të theksuar, dhe ndërkohë jepen përgjigjet që ka
5 dhënë Remi.

6 PË. Ky është një shembull i diçkaje që bëhet në shqip dhe
7 pastaj është përkthyer në anglisht, besoj.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

9 PË. Tani që ta kuptoni, disa prej intervistave të mia
10 sigurisht që janë dhënë në anglisht pastaj janë përkthyer në
11 shqip, pastaj nga shqipja janë përkthyer përsëri në anglisht,
12 edhe zakonisht kjo është arsyeja pse nuk e identifikoj atë
13 çfarë është thënë.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ta lexoj, dhe sigurisht
15 që mund ta lexoni dhe vetë nga ekranin, Dëshmitar. Pyetja, ose
16 komenti nga gazetari është si më poshtë:

17 "Ndërkohë që keni qenë ende në Shalë UÇK-ja arrestoi një
18 roje pylli serbe. Ai u lirua në Majac, por media serbe tha që
19 ai ka ikur vetë, është arratisur vetë prej atij vendi. Si
20 ndodhi ky lirim?"

21 Ndërkohë që Remi thotë:

22 "Brenda një periudhe të shkurtër u kryen dy arrestime dhe
23 dy lirime. Së pari, bëhej fjalë për një roje pylli dhe një
24 inspektor të caktuar. Ne këtë e bëmë në mënyrë të tillë që të
25 dëshmonim që ne kishim vërtetë fuqi dhe që ata të kishin

1 kujdes lidhur me sulmet ose me veprimet që mund të ndërmerrenin
2 kundër personave tonë në UÇK."

3 Vijojmë në faqen tjetër:

4 "... edhe në vende të cilat ne nuk mund t'i kontrollojmë,
5 si për shembull, në qytet, ne mund të merrnim këdo që
6 dëshironin. Këtë mesazh dëshironim që të jepnim."

7 Dhe pastaj bëhet pyetja tjetër:

8 "A mund të na jepni disa hollësi të tjera në lidhje me
9 këtë arrestim?"

10 Dhe Remi këtu thuhet që ka dhënë këtë përgjigje:

11 "Në momentin kur Christopher Hill ka qenë në Kosovë dhe
12 nuk e ka vizituar përfaqësuesin e Zyrës së UÇK-së, Adem
13 Demaçin, ne dëshironim që ta bënim z. Demaçi një faktor të
14 rëndësishëm. Unë lëshova një urdhër për tre ushtarë që të
15 dilnin dhe të kapnin një inspektor që quhej Zoran Zbilic. Ata
16 e kryen këtë detyrë që iu ngarkova unë në mënyrë të suksesshme
17 dhe sollën inspektorin serb në Llapashticë, ku ne e mbajtëm
18 atë për tre ditë. Shaun Byrnes insistoi fort, si dhe zyrtarë
19 të tjerë të OSBE-së, që ta lironim atë. Unë për vete as që nuk
20 doja fare ta diskutoja këtë si çështje. Më pas Adem Demaçi u
21 fut në këtë debat, dhe për hir të tij, unë e lirova këtë
22 person. Unë mendoj që me këtë pozicion të përfaqësuesit
23 politik të UÇK-së ne vijmë më tej dhe e lirim këtë person.
24 Në përgjithësi kjo ishte diçka e përgatitur."

25 Dëshmitar, a ju kujtohet ndonjë gjë tani pasi lexova këtë

1 pjesë të librit?

2 PË. Jo, nuk më kujtohet asgjë. Mua më duket sikur kjo është
3 diçka e cila është shkruar për t'i shërbyer atij që ka dhënë
4 intervistën sepse zakonisht edhe kur thuhet që dikush u
5 arratis ose ja doli që të largohej nga vendi i ndalimit të
6 vet, edhe kjo është diçka që është e stisur dhe zakonisht nuk
7 është e vërtetë. Megjithatë, ajo çfarë mendoj unë që është e
8 qartë këtu është se puna e Shaun Byrnes është bërë më e
9 fokusuar, më e përqendruar, domethënë, që ai është më shumë i
10 dhënë dhe më shumë i përfshirë në gjetjen e një zgjidhje për
11 çështje të tilla. Personalisht jam skeptik sepse unë nuk e kam
12 vizituar, nuk e kam takuar Adem Demaçin dhe nuk e shikoj se si
13 lidhet pjesa e Adem Demaçit me lirimin e një inspektori që
14 quhet Zoran Zbilic.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Megjithatë, besoj që ju e
16 pranoni që ata që kanë qenë mbështetës të z. Demaçi, mbasi z.
17 Remi ka qenë një prej mbështetësve të tij, ndoshta nuk kanë
18 qenë shumë të lumtur ose të kënaqur që ju nuk keni qenë më
19 shumë i përfshirë me z. Demaçi, apo jo?

20 PË. Unë e thashë dhe më përpara, besoj që unë e kam takuar më
21 shpesh z. Demaçi sesa besoj që pretendonte ai ose që e
22 meritonte ai, dhe në çdo rast z. Remi nuk ishte përgjegjës për
23 takimet e mia, ose për punën time.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do e përsëris edhe një
25 herë pyetjen time. A e pranoni mbase që persona të cilët kanë

1 qenë mbështetës të z. Demaçi, ndoshta z. Remi ka qenë një prej
2 këtyre mbështetësve, ndoshta nuk e kanë pëlqyer shumë
3 qëndrimin tuaj për sa i takon përfshirjes së z. Demaçi? A
4 pajtoheni ju me këtë, Dëshmitar?

5 PË. Nuk jam në gjendje t'i përgjigjem kësaj pyetje. Unë nuk
6 jam takuar me të gjithë në çdo vizitë që kam bërë, kështu që
7 nuk i di rrethanat se pse, ose pse nuk e kam takuar z. Demaçi
8 në këtë rast. Kështu që në këtë rast nuk kam një përgjigje të
9 qartë, por di të them që asnjëherë nuk kam thënë që nuk do e
10 takoj atë, sepse e di se çfarë stature kishte ai dhe çfarë
11 rëndësie kishte. Kështu që nuk jam shumë i sigurtë që pse z.
12 Remi, pra ka marrë këtë veprim dhe e ka menduar që mënyra për
13 t'u përgjigjur ndaj këtij veprimi timit ishte që të shkoje dhe
14 që të rrëmbeje dikë. Domethënë, është një proces të cilit nuk
15 i jap dot zgjidhje, është një proces torturues, logjike, do të
16 thoja, kështu që nuk di të jap përgjigje tjetër.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj. Ju nuk jeni z.
18 Remi, nuk mund të jepni shpjegimin që mund të ketë pasur ai. A
19 ju kujtohet një takim i Ministrit të Punëve të Jashtme
20 Italiane Lamberto Dini gjatë asaj periudhe, pra në vitin 1999?
21 PË. Mendoj që e kam takuar në Beograd. Mendoj që ka ardhur në
22 Rambuje, po ashtu, edhe me katër ministra të tjerë, dhe besoj
23 që e kam takuar bashkë me ta.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet një rast,
25 dhe në qoftë se nuk do ju kujtohet do shikojmë një dokument

1 për të kujtuar rrethanat, por pyetja për moment është kjo: A
2 ju kujtohet rasti kur ministri Lamberto Dini u ankua lidhur me
3 komunikatë që ishte nxjerrë nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-
4 së? Ju kujtohet ky rast, Dëshmitar?

5 PË. Jo, nuk më kujtohet konkretisht. Por, ajo çfarë më
6 kujtohet është që italianët ishin vëzhgues më skeptikë të
7 sjelljes së UÇK-së.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do mundohem t'ju ndihmoj,
9 Ambasador, se ka kaluar shumë kohë.

10 Për këtë do i kërkoja Sekretares të paraqesë në ekran
11 provën 1D2678.

12 Sikurse mund ta shikoni dokumentin në ekran, bëhet fjalë
13 për një tjetër kabllogram që mban datën 26 shkurt 1999. Nëse
14 do të vijojmë në fund të dokumentit besoj që nuk mund të
15 lexoni emrin tuaj në titullin "I dërguari i posaçëm për
16 Kosovën". E shikoni këtë, Dëshmitar?

17 PË. Po e shoh. A mund të shikoj pak fillimin e dokumentit se
18 dua të di kush e ka shkruar këtë dokument. Karen Decker. Në
19 rregull, e pashë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja
21 DHT05129. Besoj që është faqja e dytë e këtij dokumentit.

22 Ambasador, do ju kërkoj që të shikonit paragrafin 12 të
23 këtij dokumenti. E shikoni në ekran?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do e lexoj për

1 transkriptin. Këtu thuhet:

2 "[Ambasadori] Hill kërkoi një shpjegim të Komunikatës
3 numër 31 të UÇK-së të cilën [Ministri i Punëve të Jashtme i
4 Italisë] e lexoi gjatë takimit ministerial, dhe ku thuhej që
5 UÇK-ja nuk mbështeste përpjekjet në Rambuje. Përfaqësuesi i
6 UÇK-së, Thaçi, deklaroi se çfarë lloj marrëveshje të jetë
7 arritur në Rambuje, ajo do ta detyronte UÇK-në që ta zbatonte
8 atë dhe do të respektohej në Kosovë. Thaçi tha, 'Unë e
9 garantoj këtë, unë e kam kompetencën për ta bërë këtë gjë'.
10 Hill u përgjigj se ishte e rëndësishme që të thuhej kjo gjë në
11 mënyrë të tillë që të ndihmohej rifitimi i besimit nga grupi i
12 kontaktit."

13 Pyetja e parë është kjo: A ju kujtohet ky diskutimi nga
14 Ministri Dini dhe pjesëmarrësve të tjerë sa i takon një
15 komunikate të lëshuar nga UÇK-ja?
16 PË. Tani që e pashë këtë pjesë të kabllogramës sigurisht këtu
17 domethënë bëhet fjalë për një takim në Rambuje, midis z.
18 Thaçi, sigurisht që nuk e pashë kush ishte tjetër pjesëmarrës
19 aty, por ka qenë z. Thaçi dhe Sekretarja Albright. Dhe mesa e
20 kuptoj unë Ministri i Jashtëm Dini mbase i është ankuar
21 Albright që pastaj më ka thënë mua, dhe unë kam organizuar një
22 takim midis Albright dhe kam thënë që kjo situatë nuk shkon
23 kështu dhe duhet që ta rregullojmë atë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në këtë dokument, pra,
25 sugjerohet që ju e keni trajtuar këtë çështje me z. Thaçi e

1 keni biseduar këtë çështje me z. Thaçi, apo jo?

2 PË. Kjo është ajo çfarë ne e quajmë në zhargonin diplomatik
3 "Memorandum bisede", pra, është shkruar dhe është identifikuar
4 dhe ka marrë dritën jeshile nga Shtabi i Sekretares, kështu që
5 -- për shembull, këtu thuhet që:

6 "... [Ambasadori] Hill bëri presion ose ushtroi trysninë
7 e tij në mënyrë të tillë që delegacioni të punonte."

8 Dhe në qoftë se do të vazhdojmë pastaj me pjesën tjetër
9 të tekstit të kabllogramit, besoj që kjo më jep më shumë
10 kontekst, e kuptoj pak më mirë se për bëhet fjalë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur diçka në një
12 kabllogram në këtë tekst është në thonjëza, a do të thotë kjo
13 që është fjalë për fjalë, është marrë shënim fjalë për fjalë
14 nga personi që ka bërë zbardhjen?

15 PË. Po. Kjo është e rëndësishme sepse ajo çfarë sugjerohet
16 këtu, dhe sigurisht domethënë dua t'ju them që nuk e kam
17 lexuar gjithë tekstin, thjesht lexova këtë që më treguat ju,
18 por në diplomaci ne kemi tendencën që lexojmë shumë shpejt, të
19 lexojmë ndonjëherë -- i lexojmë gjërat dhe mbrapsht.

20 Megjithatë ajo çfarë sugjerohet këtu është që ministri i
21 punëve të jashtme të Italisë thotë që Shtetet e Bashkuara
22 pretendojnë se UÇK-ja e mbështet procesin e Rambujesë, por
23 është një "po", sa për të larë gojën, sepse ata thjesht duan
24 që të sigurojnë bombardim e Serbisë dhe nuk e kanë të
25 përnjëmendtë "po-në". Kjo është një akuzë shumë e rëndë e bërë

1 nga Ministri i Punëve të Jashtme të Italisë për UÇK-në.

2 Kështu që ne i thamë UÇK-së asokohe që kjo situatë nuk na
3 ndihmon fare ne. Në thelb, UÇK-ja po përpiqet të krijojë
4 probleme midis nesh dhe anëtarëve të tjerë të grupit të
5 kontaktit. Mua personalisht më duhej t'i tregoja, t'ju thoja
6 njerëzve në UÇK-së "mos insistoni më shumë sesa ç'duhet, mos
7 vazhdoni me synimet tuaja plotësisht, sepse ne si Shtete të
8 Bashkuara jemi shumë të interesuar që të kemi marrëdhënie
9 shumë të mira me aleatët tanë", dhe një prej aleatëve ishte
10 Italia. Dhe ne po mundoheshim që t'i tregonim UÇK-së që ne nuk
11 duam që ta detyrojmë, për shembull, Italinë, që Italia të bëjë
12 diçka në qoftë se nuk marrim një "po" të plotë dhe të ndjerë
13 dhe të vërtetë prej jush. Dhe "z. Thaçi, përderisa jeni
14 përfaqësuesi ju duhet që ta rregulloni këtë situatë". Pra, me
15 fjalë të tjera, ne jemi përpjekur që t'ja bënim të qartë UÇK-
16 së që nuk duhej të bënin këtë lloj sjellje.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, në ekran patëm
18 komunikatën numër 31 të UÇK-së. Megjithatë do t'ju tregoj një
19 tjetër dokument në mënyrë të tillë që ta keni pak më të qartë
20 situatën. Në qoftë se ju kujtohet diçka, në rregull, në qoftë
21 se jo, nuk ka problem.

22 Për këtë arsye do i kërkoj Sekretares që të paraqesë në
23 ekran një provë tjetër që ka numrin P131. Prova është P3541.

24 Ambasador, do t'ju shpjegoj se çfarë keni në ekran dhe
25 pastaj do të shikojmë pjesët përkatëse. Në ekran keni atë

1 çfarë ka titullin Deklaratë Politike numër 31.

2 PË. A mund të më ndihmoni me datën?

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt do t'jua shpjegoj
4 unë datat se janë dy data të rëndësishme.

5 PY. Nuk e kujtoj datën kur ka përfunduar seanca në Rambuje,
6 dhe nuk e di kur ka filluar saktësisht -- kur kanë filluar tre
7 javët e konsultimeve. Për këtë arsye ju pyeta.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, kabllogrami që ne
9 pamë para pak çastesh është e datës 26 shkurt. Dhe ndërkohë në
10 qoftë se shikoni Deklaratën Politike kjo është lëshuar me
11 datën 20. Por, në qoftë se do shikoni dokumentin e botuar në
12 gazetë, botimi i deklaratës politike është bërë në gazetën
13 Zëri i Kosovës, të enjten, me datë 25 shkurt 1999. Dhe me datë
14 26 është kabllogrami.

15 PË. Megjithatë kabllogrami ka reflektuar bisedën që ka
16 ndodhur me datë 21 apo jo?

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

18 PË. Por, meqenëse ra fjala, kjo do të thotë që ka kaluar
19 shumë kohë derisa është nxjerrë kabllogrami, por nga ana
20 tjetër kjo tregon që njerëzit i kushtojnë rëndësi procesit,
21 domethënë e shikojnë procesin, dokumentin disa herë përpara
22 sesa ai të dërgohet.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj.

24 Do të doja që t'ju tërhiqja vëmendjen që të lexonit dy
25 paragrafët e fundit të kësaj deklarate. Do ju kërkoja që t'i

1 lexonit me mendje dhe pastaj do ju bëj disa pyetje.

2 PË. Mendoj që e kuptoj se cila është situata këtu. Dhe nuk do
3 kisha mundësi që ta kuptoja plotësisht pyetjen në qoftë se nuk
4 do kisha lexuar këtë pjesë të dokumentit që kam përpara

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Çfarë kuptoni ju me këtë?

6 PË. UÇK-ja duke thonë "po" në Rambuje, ose duke thënë "po"
7 për konsultimet në Rambuje, kjo ishte një përpjekje prej
8 personave që ishin atje që e ndjenin që kishte vetëm një
9 objektiv, dhe ky objektiv ishte pavarësia dhe asgjë tjetër nuk
10 kishte vlerë për ta dhe kjo ishte një garanci për këta persona
11 që të mos shqetësohen dhe nuk kemi ndryshuar asgjë në qasjen
12 tonë. Domethënë, me fjalë të tjera, është një garanci ku
13 thuhet që pavarësisht që çfarë keni lexuar në median
14 perëndimore kjo është ajo çfarë ka ndodhur realisht. Pra, ne
15 jemi të vendosur për pavarësi dhe ata e quajnë vetëvendosje
16 këtë gjë. Të paktën kështu është në tekst.

17 Për mua kjo është interesante sepse ata po përpiqen të
18 justifikojnë dhe të thonë që vetëm Shtetet e Bashkuara mund
19 t'i bëjnë gjërat realistet. Kështu që me fjalë të tjera ata po
20 shpjegojnë që po punojnë shumë nga afër me Shtetet e
21 Bashkuara. Për mua personalisht, si person që kam punuar në
22 terren me Wolfgang Petritsch dhe që kam punuar gjithashtu edhe
23 me norvegjezë që ishin në kryesi, dhe OSBE-në, këto lloj
24 komentesh nuk na ndihmonin fare. Dhe jo vetëm kaq, por nuk na
25 kënaqnin fare. Pra, nuk na ndihmonin neve, për shembull, për

1 të dhënë opinionin që ne ishim më shumë mbështetës ndaj UÇK-së
2 se sa ç'ishim për shembull për Italinë apo për qasjet e
3 Italisë.

4 Atëherë, meqenëse ra fjala, në qoftë se do i kthehesha
5 edhe një herë kabllogramit, pra, NODIS, që ishte titulli i
6 kabllogramit, është niveli më i lartë i dokumentit të tillë,
7 pra, NODIS, në qoftë se t'i ke kokën NODIS në një kabllogram,
8 kjo do të thotë që bëhet fjalë për tema shumë të rëndësishme
9 dhe besoj që aty ishte e qartë që unë jam përpjekur që t'i jap
10 Thaçit një mesazh të ashpër. Mbështetur në karrierën time të
11 gjerë diplomatike nuk është e pazakontë që të kesh këtë lloj
12 keqardhje të njëanshme, dhe pala përkatëse thotë që: Ne nuk
13 jemi pajtuar me asgjë të re, thjesht mos u shqetësoni. Ne
14 thjesht kemi thënë një "po" se duam që amerikanët të jenë të
15 kënaqur, sepse duam që amerikanët të vazhdojnë të jenë më
16 marrëdhënie të mirë me evropianët.

17 Kështu që kjo ka qenë pak a shumë ajo që çfarë kuptoj unë
18 nga teksti.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Le të vazhdojmë pas dhjetë
20 ditësh për një temë të cilën ju e keni diskutuar dhe që ka të
21 bëjë me të dyja palët. Pra, e kam fjalën më konkretisht për
22 negociatat e Rambujesë, domethënë, periudhën nga 18 marsi, nga
23 fillimi i negociatave deri kur është nënshkruar marrëveshja.

24 Së pari dua t'ju pyes këtë: A e dini se ku shkuan z.
25 Thaçi, z. Krasniqi dhe z. Veseli nga Franca në kohën kur

1 mbaroi raundi i parë i negociatave?

2 PË. Nuk e di. Unë e di që ata u morën nga një avion francez.

3 Unë kisha menduar që ata do të shkonin në Shkup, por pastaj

4 kam dëgjuar që u dërguan në Prishtinë me avion. Besoj që e kam

5 dëgjuar këtu në Hagë, ndoshta dje, ndoshta pardje. Ata kanë

6 shkuar në vende të ndryshme, besoj. Megjithatë, besoj që kam

7 dëgjuar fjalë që z. Thaçi ka qenë në Tiranë.

8 Po ashtu më kujtohet që jam përpjekur që të merrja

9 informacion nga ambasada jonë në qoftë se ata kishin ndonjë

10 shenjë që z. Thaçi ishte atje, dhe ishte e vështirë dhe për

11 ambasadën që të gjente ndonjë gjurmë të z. Thaçi.

12 Pra, sado shumë UÇK-ja të ishte e përgatitur dhe të

13 dëshironte të ecte përkrah nesh, e para, a) ato nuk ishin një

14 strukturë vertikale e organizuar, dhe kjo është një mënyrë

15 shumë elegante për të thënë sesa të organizuar ishin ato; së

16 dyti, ata nuk ishin vërtetë të interesuar me ne, me përjashtim

17 faktit ose të rasteve kur vërtetë e kishin ndjesinë se nuk

18 kishin asgjë zgjidhje tjetër por që të punonin me ne.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani, sa i takon këtyre

20 fjalëve që qarkullonin që juve keni dëgjuar lidhur me z. Thaçi

21 që ka qenë në Tiranë, në Shqipëri, a ju kujtohet edhe kjo ose

22 fakti që ai ka qenë jashtë vendi dhe që ai është takuar me z.

23 Shala dhe z. Berisha, gjëra të cilat janë thënë në librat e

24 tyre përkatëse? Në qoftë se doni mund të lexojmë libra,

25 pasazhet ose pjesët, paragrafët përkatës të tyre.

1 PË. Ka kaluar shumë kohë që prej atëherë, që prej kohës që
2 kam lexuar librin e z. Shala, por mesa kam kuptuar unë, ai ka
3 qenë në Shqipëri. Nuk e di në qoftë se ka qenë në Tiranë apo
4 jo. Megjithatë më lejoni të them që duhet të kuptoni që rruga
5 për në Kukës, në veri të Shqipërisë, dhe atje zakonisht
6 kryheshin takime me zyrtarë shqiptarë. Megjithatë nuk e di,
7 nuk di si t'i përgjigjem pyetjes tuaj. Unë di që Senatori Dole
8 ka qenë shumë i zhgënjyer dhe ishte po ashtu i inatosur sepse
9 ai kishte qenë një mbështetës shumë i fortë i shqiptarëve të
10 Kosovës dhe ishte ndjerë disi jo i respektuar që nuk kishte
11 qenë në takime reale. Kështu që më duhet të them që dje,
12 ndoshta, jam befasuar në mënyrë të këndshme kur lexova dhe kur
13 mora më shumë informacion që ka pasur takime me njerëz që
14 dukej sikur e kuptonin Rambujenë dhe që e merrnin atë si
15 zhvillim pozitiv.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohen udhëheqësit
17 e UÇK-së? E kam fjalën këtu për emrat të caktuar, si për
18 shembull, Xhavit Halitin, Azem Sylën dhe Kadri Veselin. Gjatë
19 kësaj periudhe, pra, periudhës nga negociatat deri te
20 nënshkrimi, a keni parë ndonjërin prej tyre?

21 PË. Nuk më kujtohet që i kam parë. Nuk më kujtohet t'i kem
22 takuar. Përsëri ky është një sugjerim, një ide që unë e kam
23 sot që besoj që është e vlefshme dhe sot, se nuk është se
24 kishte ndonjë organizim shumë të madh. Dhe për këtë gjë nuk
25 mund të flas lidhur me dikë, dhe nuk mund të them konkretisht

1 në qoftë se i kam parë këta persona apo jo.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani për të qenë i qartë,
3 ma thoni se nuk e kuptova drejt nga ajo çfarë thatë, a keni
4 takuar persona të tillë si Xhavit Haliti, Azem Sylën, Kadri
5 Veselin, gjatë periudhës nga bisedat deri në nënshkrimin?
6 PË. Unë u mundova të thoja që nuk më kujtohet. Nuk e
7 përjashtoj mundësinë që të jem takuar me ta. Megjithatë më
8 kujtohet, për shembull, që kam shkuar në një takim me persona
9 të UÇK-së. Ndoshta këta kanë qenë aty të pranishëm aty në
10 takimin me anëtarët e UÇK-së, Tina Kaidanow, ishte personi që
11 mbante shënime kryesisht, Shaun Byrnes, shkruante po ashtu,
12 merrte shënime. Dhe siguroheshim ose përpiqeshim që të
13 siguroheshim që Shaun Byrnes t'i ndante këto shënime me ne,
14 sepse, për shembull, shikoja shënime dhe në qoftë se unë
15 shikoja shënime të caktuara të Tinës ose të dikujt tjetër,
16 thosha "Jo, nuk është tamam kështu situata, kështu që duhet ta
17 ndreqim këtë gjë".

18 Kështu që me fjalë të tjera po përpiqem të them që nuk e
19 di kush ka qenë në këtë takim, por më duhet të them që u
20 befasova pozitivisht, isha optimist, unë isha optimist. Dhe
21 pavarësisht se ishte e vështirë situata në Kosovë dhe nuk mund
22 të ishe optimist për asgjë në Kosovë në atë kohë, për mua
23 ndjesia ishte optimiste se procesi i Rambujesë do
24 funksiononte.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju bëj një pyetje dhe

1 në qoftë se nuk e kujtoni më thoni. Pra, ka ndodhur në një
2 moment që ju jeni informuar personalisht që Shtabi i
3 Përgjithshëm i UÇK-së u pajtua me nënshkrim e Rambujesë, pra
4 ra dakord që të nënshkruante Marrëveshjen e Rambujesë?
5 PË. Besoj që më është thënë kjo në një pikë të caktuar, sepse
6 e gjithë ideja për t'u takuar në Paris nuk ishte që të shkonim
7 në Paris me UÇK-në dhe të na thonin "jo" prapë, por të shkonim
8 në Paris dhe të merrnim një "po" dhe të merrnim nënshkrimin e
9 dokumentit. Kështu që kjo ishte faza e dytë dhe duhet të kemi
10 pasur ndonjë sinjal pozitiv lidhur me këtë. Përsëri, bisedat e
11 mia me personat, me njerëzit gjatë kësaj periudhe besoj që ka
12 zgjatur diku tre janë në qoftë se nuk e kam gabim.

13 Pra, për të qenë i singertë me ju, unë isha shumë i
14 shqetësuar sepse po -- pala shqiptare po na thoshte "po", por
15 nga ana tjetër nuk po merrnim një "po" të qartë nga ana serbe.
16 Kështu që isha i shqetësuar, kështu që nuk është se kam
17 shpenzuar shumë kohë për të lexuar librin tim. Por më kujtohet
18 që shqiptarët u kthyen në Kosovë për të gjetur paqe, por pas
19 Rambujesë serbët u kthyen në serbi për t'u përgatitur për
20 luftë. Kështu që sigurisht që ndjesia ishte jo neutrale,
21 domethënë kishte ndjesi pozitive për atë çfarë po ndodhte për
22 Kosovën, por ndërkohë kishte një lloj shqetësimi lidhur me atë
23 çfarë do të ndodhte në Serbi.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kujtohet ta keni
25 informuar në atë kohë Sekretaren e Shtetit Albright që Shtabi

1 i Përgjithshëm ju kishte dhënë një sinjal pozitiv?

2 PË. Jam i sigurt që e kam transmetuar një gjë të tillë në një
3 pikë. Megjithatë, sikurse u tha dhe prej dikujt dje, kishim
4 shumë pengesa gjatë rrugës, gjëra të papritura. Kishim, për
5 shembull, OJQ, kishim gjithashtu edhe persona të tjerë të
6 cilët nuk punonin për mua, për shembull, drejtori për Evropën
7 jug-lindore, Lary Rossin - në qoftë se nuk gabohem - dhe ata
8 kishin zhvilluar, kishin ushqyer disa marrëdhënie të tyre.

9 Dhe në qoftë se ti je i dërguari i posaçëm, ti duhet që
10 të jesh i gatshëm që të ndalosh çdo bisedë që nuk ke kërkuar
11 në një farë mënyrë. Megjithatë, realiteti ishte që të dilnin
12 gjëra të papritura, kështu që -- dhe pengesa gjatë rrugës dhe
13 jam i sigurt që ajo, e kam fjalën këtu për Sekretaren e
14 Shtetit, merrte ndjesi pozitive dhe mesazhe pozitive nga grupe
15 të caktuara, dhe jam i sigurt që në një moment të caktuar kohe
16 ja kam transmetuar dhe unë, e kam konfirmuar dhe unë këtë gjë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam dhe disa pyetje të
18 tjera, Ambasador.

19 Do të vazhdojmë tani me zhvillimet e kohës, domethënë me
20 18 mars 1999 dhe nënshkrimin e marrëveshjes së Rambujesë. A e
21 kam kuptuar unë drejt që katër përfaqësues të delegacionit të
22 UÇK-së e kanë nënshkruar këtë marrëveshje?

23 PË. Nuk më kujtohet kjo gjë. Por, ajo çfarë kujtoj unë është
24 që i gjithë delegacioni i shqiptarëve të Kosovës ishte dakord
25 me marrëveshjen. Nuk më kujtohet se kush e ka nënshkruar, po

1 të gjithë ishin dakord që të nënshkruanin dokumentin dhe ishin
2 pozitiv në atë marrëveshje nënshkrimi në Paris.

3 Më duhet të them që isha shumë i kënaqur nga fakti që
4 personat të cilët nuk ishin ulur në një tryezë të përbashkët,
5 nuk kishin pasur të njëjtin mendim, të njëjtën qasje më
6 përpara, në atë moment ishin në një mendje, ishin bashkë. Pra,
7 ishin persona të cilët për shkaqe politike ose për shkak të
8 mendimeve që kishin për Rugovën nuk ndanin të njëjtat qasje,
9 megjithatë në Rambuje ishin të gjithë bashkë. Dhe pas nëntë
10 muajsh isha i kënaqur, megjithëse nuk e kishim foshnjën.
11 figurativisht, në duar, për ne ishte një arritje e madhe.

12 Por nga ana tjetër, ne kishim edhe një ndjenjë melankolie
13 sepse Serbia nuk ishte aty dhe ishim në një pikë shumë të
14 rëndësishme historie.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shumë shkurtimisht, dhe më
16 tregoni në qoftë se nuk e kam kuptuar siç duhet, por unë do ju
17 them si e kam kuptuar unë: z. Thaçi e ka nënshkruar dokumentin
18 në emër të UÇK-së, z. Rugova në emër të LDK-së, z. Qosja në
19 emër të partisë së vet, dhe z. Surroi si një përfaqësues i
20 shoqërisë civile. Ju kujtohet kjo gjë?

21 PË. Nuk më kujtohet në qoftë se z. Surroi e ka nënshkruar
22 këtë dokument apo jo. Mbase po, nuk e di. Ajo çfarë kemi
23 menduar ne si të rëndësishme janë këto tri grupe, domethënë,
24 UÇK-ja, LDK-ja dhe intelektualët e pavarur. Ky është termi i
25 tyre, jo i imi. Atëherë nuk më kujtohet që të kemi patur katër

1 nënshkrime, por më kujtohen këto tri nënshkrime që sapo ju
2 përmenda.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj që e thatë përpara
4 një çasti, Ambasador, sepse t'i e gjen veten në një situatë ku
5 njëra palë të nënshkruajë marrëveshjen dhe pastaj nuk ke
6 askënd tjetër nga pala tjetër për nënshkrimin e marrëveshjes.

7 Kam dy pyetje, pra: Cila ishte arsyeja dhe a është e
8 saktë që shtete të caktuara, përfshirë këtu Italinë ishin disi
9 të nguruar për të pasur një situatë të tillë?

10 PË. Mendoj që ishin disa shtete në grupin e kontaktin, besoj
11 që është e drejtë të thuhet që Italia ishte një prej këtyre
12 shteteve, megjithëse unë nuk jam përfaqësues i qeverisë
13 italiane për shtetin italian, nuk kam folur as atëherë dhe nuk
14 jam -- nuk kam të drejtë të flas as sot. Ju thoni që "si ka
15 mundësi të nënshkruhet marrëveshja kur vetëm njëra palë e
16 nënshkruan?".

17 Por, koncepti asokohe ishte që t'i jepej mesazhi i qartë
18 serbëve dhe t'i thuhej, "Serbë, kjo do të ndodhë, kështu që ju
19 do ishte mirë që të bëheni pjesë e procesit. Kjo është mënyra
20 më e mirë që të garantohen ose të mbrohen interesat e Serbisë
21 dhe që të bëheni pjesë, të jeni pjesë e këtij procesi".

22 Përderisa Milosheviqi kishte thënë shumë e shumë herë, pra,
23 kishte thënë që "shqiptarët nuk do pajtohen, nuk do bien
24 dakord asnjëherë për asgjë", dhe marrëveshja, në fakt,
25 rrëzonte pikëpamjen e tij që shqiptarët nuk do pajtoheshin me

1 asgjë. Dhe ai kishte thënë gjatë gjithë kohës që "Shqiptarët
2 nuk do pajtohen me asgjë dhe për rrjedhojë ne nuk na duhet të
3 pajtohemi me asgjë". Po ky ishte një mesazh i kundërt me atë
4 çfarë kishte thënë Milosheviqi. Ne po i thonim Milosheviqit, e
5 kishe gabim, ja e arritëm marrëveshjen, por t'i tani do bësh
6 mirë të mendosh se cila do jetë lëvizja e radhës e Serbisë.

7 Domethënë kjo ishte ideja. Të paktën jo për mua, sepse
8 unë personalisht mendoj që luftërat janë shumë të rënda, dhe
9 unë personalisht kam shumë probleme me zgjidhje të tilla,
10 luftërat përfshijnë me vete shumë tragjedi të tjera. Por,
11 kishte njerëz që thonin, "Oh, duhet të përgatitemi". Unë nuk
12 isha njëri prej tyre dhe nuk thoja, për shembull: Duhet ta
13 bombardojmë Serbinë për dy ditë dhe çdo gjë është në rregull
14 pastaj. Thjesht t'i demonstrojmë Milosheviqit që u bombardove
15 dhe duhet domethënë që ai të përqafojë procesin.

16 Unë personalisht nuk kam qenë njëri prej këtyre
17 personave.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do shihemi përsëri pas
19 pushimit. Dhe vazhdojmë me pyetjet me z. Milosheviq pasi të
20 bëni pushimin e shkurtër.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
22 pushim për dhjetë minuta.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 --- Seanca ndërpritet në orën 10.05

25 --- Seanca rifillon në orën 10.15

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni

2 dëshmitarin në sallë.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

5 Ambasadori Hill. Vazhdojmë me pyetjet që do t'ju parashtrojë

6 Gjykatësi Mettraux.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit

8 për durimin tuaj. Po flisnim për presidentin Milosheviq dhe do

9 vazhdoj prej aty.

10 Shkurt, dje diskutuat, ashtu si dhe ditën më përpara, një

11 rast për të cilin thatë që ka ndodhur por nuk ishit i sigurtë

12 në vjeshtë, ku Presidenti Milosheviq ngriti pretendime nga më

13 të ndryshmet kundër z. Thaçi. Nuk jam i interesuar të di për

14 çfarë bëhej fjalë në këto pretendime.

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po jam i interesuar të di

17 disa gjëra. E para është të di nëse në atë kohë kur ju kishit

18 takimin me z. Milosheviq a e dinit se kush ishte z. Thaçi?

19 PË. Duhet ta kem ditur përndryshe nuk do ta kisha përmendur

20 me emër atë gjatë bisedës. Po e deduktoj që e kam bërë këtë

21 gjë.

22 Sa i takon asaj që po ndodhte, Milosheviqi mendonte se ne

23 po largoheshim nga Rugova dhe mendonte që ky ishte gabim i

24 madh i rëndë sepse mendonte që ai pastaj do të duhej të merrej

25 me UÇK-në që ishte një qëndrim shumë më i ashpër. Tani, dua të

1 theksoj këtu se edhe Rugova asnjëherë nuk kërkoi më pak se
2 pavarësia dhe ai, por pranoj që nuk ishte i interesuar në
3 luftën e armatosur.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani, në qoftë se e dini
5 natyrisht, Milosheviqi a e paraqiti, a e ngriti si problem
6 praninë e z. Thaçi si alternativë ndaj Rugovës që ishte
7 problem?

8 PË. Tani, sa i takon takimit mund të ketë ndodhur pas daljes
9 në pah apo bërjes publike të emrit të Thaçit, nuk e di. Nuk
10 jam i sigurtë kur jam takuar për herë të parë me Thaçin. Por
11 mendoj se Milosheviqi ishte i shqetësuar se ne do të
12 mënjanonim Rugovën dhe të zgjidhnim UÇK-në si partnerin tonë.
13 Pse ishte i shqetësuar për këtë, nuk jam i sigurtë. Natyrisht
14 KDOM-i ishte një kontingjent shumë aktiv nën përgjegjësinë,
15 nën drejtimin e Shaun Byrnes dhe merrej, trajtonte,
16 komunikonte me njerëz, shumë njerëz të ndryshëm me uniforma
17 kamuflazhi sesa të LDK-së. Pra, kjo mund të ketë qenë një prej
18 arsyeve. Por si koncept i përgjithshëm, ai ndjente se në një
19 farë mënyre ne po braktisnim, po hiqnim dorë nga Rugova. Tani
20 dua të them që shumë njerëz të tjerë ndjenin të njëjtën gjë,
21 në fakt mendonin që ne duhet të hiqnim dorë nga Rugova. Dhe
22 natyrisht, z. Gelbard ishte shumë më shumë i interesuar të
23 bisedonte, të komunikonte me UÇK-në.

24 Por çështja sepse ai përmendi Thaçin me emër nuk më
25 kujtohen rrethanat, por duhet të ketë qenë ndonjë takim midis

1 Thaçit dhe disa amerikanëve dhe për këtë arsye ai donte që të
2 na thoshte neve që ky ishte gabim pra.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa i takon, për aq sa ju
4 kujtohet, natyrisht, a përmendi ai ndonjë udhëheqës tjetër të
5 UÇK-së?

6 PË. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet. Më kujtohet vetëm ky
7 emër.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 PË. Dhe mendoj që kjo kishte të bënte, mund të ketë qenë në
10 kontekstin kur UÇK-ja tha se drejtori i tyre politik do të --
11 se kush do të ishte drejtori i tyre politik. Mendoj që
12 shpallja është bërë në fund, nga fundi i verës kur UÇK-ja
13 nxori ato lloj deklaratash. Nuk e di.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më lejoni të shoh nëse
15 mund t'ju rifreskoj memorien lidhur me këtë. Sa i takon
16 periudhës kohore a ju kujtohet nëse takimi që keni bërë me
17 udhëheqësit e UÇK-së, përfshirë z. Thaçi në Dragobil në 6
18 nëntor, ishte përpara apo pas takimit me Milosheviq?

19 PË. Po të isha i sigurtë që ka ndodhur përpara, do të ishte
20 përgjigje e thjeshtë. Po nuk jam i sigurtë.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull.

22 Tani e keni përsëritur dhe kjo është një temë tjetër, e
23 keni përsëritur disa herë që disa njerëz ju akuzojnë juve se
24 ishit pak më shumë i afërt me LDK-në dhe jo kaq i afërt dhe jo
25 i afërt në mënyrë të mjaftueshme me UÇK-në. Ju kujtohet të

1 keni thënë gjëra të tilla?

2 PË. Po, por nuk jam as 12 vjeç dhe e kuptoj që njerëzit do të
3 akuzojnë për gjëra të tilla dhe thjesht njeriu duhet të
4 vazhdojë të bëjë punën më të mirën që mund të bëjë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju shpjegoj se pse po
6 ju pyes. Nuk po ju ngacmoj që të ngatërrohem me juve --

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- me dikë të tillë. Por
9 z. Rubin a ishte një prej personave që e kishte këtë qëndrim?

10 PË. Duhet ta pyesni atë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju pyes juve, zotëri.
12 Dhe po ju jap mundësinë t'i përgjigjeni diçkaje, lidhur me
13 diçka që ai tha dhe do t'i kthehem asaj pas një çasti.

14 PË. Mendoj që ai ka patur më shumë besim në UÇK-në sesa në
15 LDK-në.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të shfaqim dokumentin
17 që na ndihmon për të sqaruar pyetjen time. Është prova
18 materiale 1D358.

19 Është dokument që ju është treguar juve nga Mbrojtja e
20 Krasniqit dhe, z. Ambasador. Pra, së pari, siç e shihni është
21 dokumenti mban datën 26 shkurt 1999, që të keni një ide të
22 kohës dhe tema është "Delegacioni i UÇK-së pritët ngrohtë" dhe
23 është i klasifikuar nga ju. E shikoni këtë?

24 PË. Po. Edhe këtu është i klasifikuar nga unë, kjo është
25 çështje thjesht administrative. Po shoh që nuk ka atë rreshtin

1 e zakonshëm që gjendet në këto lloj dokumentesh që tregon se
2 ky dokument vjen nga KDOM-i, por ndoshta nuk është bërë në atë
3 kohë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do kalojmë fillimisht tek
5 kjo faqe. Ndoshta në faqen e dytë do gjeni --
6 PË. Po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- informacionin që ju
8 intereson juve, zotëri. Por në qoftë se do shkojmë pak më
9 poshtë shihni nën paragrafin, poshtë paragrafit 1 është vera
10 aty, thuhet verë.

11 Në qoftë se shkojmë pak më poshtë, ju lutem.

12 Fjalja e fundit në përmbledhje, në këtë përmbledhje
13 lexon:

14 "Buja", që është Ramë Buja, "dhe Krasniqi", që duhet të
15 jetë Jakup Krasniqi, i njihnim më herët, që i dimë më herët që
16 është Jakup Krasniqi.

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe vazhdon leximi,
19 "shprehën besimin se kundërshtimi i Demaçit do të tejkalohet".

20 E shikoni këtë?

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe kalojmë në faqen
22 tjetër. Tani do t'ju kërkoja të shikonit paragrafin 6. Pak më
23 poshtë. Më jep një sekondë, një çast që ta lexoni dhe do t'ju
24 bëj pyetje lidhur me të.

25 PË. Në rregull.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju lexoj dy fjali që
2 janë me interes këtu. Aty lexon:

3 "Siç u konstatua më lart ose shënuar më lart, Buja
4 komentoj se Shtabi i Përgjithshëm do të takohet atë pasdite me
5 Demaçin. Buja tha se ai, Krasniqi dhe Sulja do të merrnin
6 pjesë në këtë takim. Kur u pyet lidhur me Demaçin, të dy,
7 Krasniqi dhe Buja thanë menjëherë dhe në mënyrë të prerë se
8 ata "do të merreshin me të" dhe se kundërshtimi i tij ndaj
9 paketës së Rambujesë dhe ndaj qeverisë së Kosovës së propozuar
10 nga Rugova, Qosja dhe Thaçi në shkurt, më 24 shkurt, do të
11 tejkalohet, pra, kundërshtimi i tij do të tejkalohet."

12 Tani, kur e pyeta z. Rubin lidhur me këtë pjesë, dhe në
13 veçanti fjalët në thonjëza, "do të merremi me të", "do ta
14 rregullojmë punën e tij", sugjerimi i tij ishte, përgjigja e
15 tij ishte që ky ishte dhe një anshmëri e juaja, tregonte
16 anshmërinë tuaj ndaj UÇK-së.

17 PË. Anshmëria ime? Pra, që mbështesja njërin palë më shumë se
18 tjetrën?

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po. Anshmëria juaj,
20 zotëri.

21 PË. Po unë nuk e kam shkruar këtë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet diskutimi me
23 z. Buja, z. Krasniqi lidhur me kundërshtimin e z. Demaçi?

24 PË. Jo. Nuk më kujtohet. Nuk mendoj që e kam bërë këtë
25 diskutim. A thuhet këtu që unë kam bërë këtë diskutim? Unë

1 mendova që kjo vinte nga Shaun Byrnes.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, për t'u përgjigjur
3 pyetjes tuaj, nuk është diçka që pasqyron anshmërinë tuaj.
4 Është e saktë? Pra, në përgjigje ndaj pyetjes time përgjigja
5 juaj është që kjo nuk pasqyron ndonjë anshmëri tuajën? Është e
6 saktë?

7 PË. Ashtu është. Unë dua të them që kjo pasqyron faktin se
8 gradualisht UÇK-ja po pranonte pikëpamjen se Rambujeja ishte
9 një gjë e mirë dhe duhej të mbështetej. Ata siguruan
10 mbështetje nga Grupi i Kontaktit, veçanërisht të Shteteve të
11 Bashkuara dhe kjo do të shtonte presionin në mënyrë shumë më
12 të madhe ndaj Serbisë dhe Milosheviq.

13 Pra, e marrë këtë si pjesë të procesit. Demaçi ishte, si
14 mund ta them në mënyrë diplomatike pa qenë i pasjellshëm dhe i
15 paedukatë, mendoj që ai ishte një individ shumë kokëfortë,
16 person shumë kokëfortë. Dhe mendoj që ata thjesht aty po
17 thonin që do të tejkalonin këtë kokëfortësi.

18 Që të jap një mendim të përgjithshëm. Nga njëra anë
19 Uashingtoni ishte shumë i shqetësuar nëse kjo do të çonte në
20 një situatë ku ne do të përfshiheshim në një luftë kinetike
21 duke bërë bombardime që ishte ajo që kishin në mendje në
22 Uashington me mendime të ndara nëse kjo do të ndihmonte apo
23 jo. Sandy Berger, këshilltarja për siguri kombëtare, më tha
24 mua pasi gjithë kjo ndodhi se ai tha: Vetëm kam dëgjuar, kam
25 dëgjuar vetëm dy njerëz që më kanë thënë që Milosheviqi do të

1 hiqte dorë pas dy ditësh bombardimesh, por njerëzit e tjerë,
2 gjithë të tjerët më thanë që kjo është -- po ecim, po shkojmë
3 në diçka të panjohur që nuk i dimë zhvillimet në moment që
4 fillojnë bombat se ç'a ndodh më tej nuk mund ta dimë as nuk
5 mund ta dimë paraprakisht.

6 Kjo ka qenë kategoria e njerëzve që ishin shumë të
7 shqetësuar sesi kjo do të zhvillohej më tej.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk do t'ju pyes z. Hill.

9 Dhe këto janë dy çështjet e fundit për të cilat do t'ju
10 bëj pyetje. Pyetja e parë ka të bëjë me procesin e lirimit të
11 nëntë ushtarëve të ushtrisë jugosllave që ju diskutuat. Dhe
12 juve ju tregua prova materiale P0191 pjesa e dorëshkruar e një
13 libri që i atribuohet Jakup Krasniqit.

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe do të kërkoj ndihmën
16 tuaj këtu.

17 Në qoftë se mund të kalojmë në faqen SPOE0023106.

18 T'u jap pak kontekst, Ambasador, në qoftë se keni nevojë
19 të lexoni më përpara mund të lexoni. Ju kujtohet që ju treguan
20 informacione nga palët lidhur me një takim ku keni qenë i
21 pranishëm ju, z. Petritsch, përfaqësuesi i Shtabit të
22 Përgjithshëm më datë 11? Dhe pastaj duket që është bërë një
23 takim i dytë më datën 13 ku ka qenë i pranishëm Ambasadori
24 Walker gjithashtu. Pra, jemi në këtë periudhë kohore --

25 PË. I cili -- se m'u tregua një fotografi dhe ajo ishte

1 në vend krejt tjetër.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ashtu është. Dhe këtu --
3 në qoftë se keni nevojë të lexoni gjithë faqen mund ta lexoni,
4 por këtu do të shikoni se z. Krasniqi apo fjalët që janë aty,
5 i atribuohen atij, shpjegon procesin. Ai këtu përmend, rreshti
6 6 i paragrafit të parë, se:

7 "Pas diskutimeve shumë të vështira kërkon që premtimi të
8 bëhet me shkrim në formë të një marrëveshjeje, (kjo ishte
9 minimumi i asaj që ishim marrë vesh në Shtabin e
10 Përgjithshëm)."

11 Pyetja ime e parë është, dhe e di që ka kaluar shumë
12 kohë, a ju kujtohet si pjesë e këtyre negociatave gjatë këtyre
13 tre ditëve, në një moment të caktuar, ju keni bërë propozimin
14 që shkëmbimi i pengjeve të bëhej në mënyrë të vonuar, pra,
15 pengjet shqiptare të liroheshin dhjetë ditë më vonë, që të
16 ndaluarit shqiptarë, pra, të liroheshin më vonë dhe që Shtabi
17 i Përgjithshëm ishte i shqetësuar se nëse Milosheviqi do t'i
18 përmbahej kësaj marrëveshjeje?

19 PË. Ishin të shqetësuar për singeritetin e Milosheviqit.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Singeritetin, nëse ju
21 preferoni dhe ata kërkuar që ju të angazhoheshit në mënyrë të
22 shkruar, pra, me shkrim. Ju kujtohet kjo në veçanti kjo gjë?

23 PË. Më kujtohet. Më kujtohet. Dhe pyetja, fillimisht,
24 problemi ishte që nga z. Krasniqi, i cili dukej që ishte
25 bashkëbiseduesi i drejtpërdrejtë në çështje me mua. Ai tha,

1 "Si mund t'i besojmë Milosheviqit?" Dhe unë i thashë, "Ky nuk
2 është problemi juaj. Ky është problemi im. Problemi juaj është
3 që të më besoni mua". Dhe këtë pikë e rregullova në një farë
4 mënyre, por unë në fakt po përdorja gjithë argumentet dhe
5 mundësitë që kisha duke i paraqitur aty në tavolinë dhe duke
6 thënë, kjo është mënyra më e mirë që mund të arrijmë tani në
7 këtë moment.

8 Dhe ideja e vonesës nuk ishte ide, pra, që shkëmbimi të
9 bëhej me vonesë, lirimi i të burgosurve, i të ndaluarve
10 shqiptarë, nuk ishte ide e Milosheviqit, që të jetë e qartë.

11 Dhe më kujtohet, tani që e përmendët edhe ju, më kujtohet
12 që ata donin diçka me shkrim, një angazhim me shkrim dhe i
13 kemi bërë një gjë të tillë. Kur një diplomat amerikan jep
14 diçka me shkrim, kjo kalon përmes një procesi të tërë
15 burokratik. Duhet të shkruhen gjërat e tjera. I vetmi person
16 që kam parë ndonjëherë të bëjë një gjë të tillë ka qenë
17 Holbrooke gjatë armëpushimit kur ne patëm armëpushim menjëherë
18 përpara Dajtonit. Dhe i thashë, "Dick, nuk mund ta bësh një
19 gjë të tillë". Dhe ai tha, "Nuk mund të pres që Uashingtoni të
20 bëjë një gjë, të përcaktojë këtë gjë".

21 Pra, mendoj që ka një situatë të ngjashme, por mendoj që
22 unë kam patur më shumë vështirësi burokratike sa i takon sepse
23 më duheshin që edhe njerëz të tjerë të pajtoheshin dhe të
24 miratonin këtë qasje që kishim.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe nëse vazhdoni të

1 lexoni më poshtë do të shihni në mes të paragrafit, z.

2 Krasniqi sqaron se më 13 janar ai kishte apo:

3 "Kishim", siç thotë ai, "vështirësi për t'u konsultuar me
4 kolegët të cilët ishin jashtë vendit."

5 Dhe pastaj vazhdon më poshtë duke thënë, kjo është pjesa
6 e fundit në paragraf dhe kërkoj ndihmën tuaj lidhur me këtë,
7 thotë:

8 "Ne, me vendimet që ishim duke marrë, do të hapnim rrugën
9 për një proces të rëndësishëm në Kosovë. Me marrjen e këtij
10 vendimi ne u ndihmuam nga praktika e ndjekur nga shumë prej
11 mbledhjeve, kuvendeve të pleqve në mes të njerëzve tonë të
12 cilët i kërkojnë kreut të familjes që ai nuk duhet të dërgojë
13 përfaqësues në kuvend nëse nuk është në gjendje të marrë një
14 vendim. Pra, ne kishim përgjegjësinë, sigurisht, që ishte
15 shumë e vështirë dhe ishte shumë e vështirë, më e vështirë
16 sesa ajo e kuvendit të pleqve që tregohet në histori
17 popullore. Vendimi ishte shumë i vështirë por ishte i
18 rëndësisë së madhe për ngjarjet që do të vinin pastaj në
19 vijim."

20 Tani ju jeni në dijeni, e kuptojmë, se njihni kulturën
21 shqiptare. Çfarë kuptoni, si e kuptoni ju z. Krasniqi kur
22 thotë këtë gjë?

23 PË. Nuk jam i sigurtë përveç faktit që mund të them atij i
24 ishte dhënë një formë pushteti.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a kuptoni ndoshta që

1 përdorimi kur thotë ai "ne" po flet për vete dhe të tjerët që
2 marrin përgjegjësinë për vendimin për lirim të tyre?
3 PË. Mendoj që kuptimi i kësaj, sa u takon të tjerëve, persona
4 që ishin të përfshirë në këtë dhe jam i sigurtë që kjo nuk
5 vinte thjesht vetëm nga ai, por nga njerëz të ndryshëm,
6 ushtarakë të ndryshëm që donin të krijonin një lloj mekanizmi
7 për kthimin e të burgosurve sepse nuk ishte bërë asnjëherë një
8 gjë e tillë dhe mendoj që njerëzit e donin këtë gjë. Dhe
9 mendoj që ata e donin dhe ata që ishin shumë të ashpër lidhur
10 me këtë pikë duhej të tejkaloheshin. Pra, mendoj që kjo ishte
11 kuptimi i saj.

12 Gjithashtu, kishte shumë gjëra që ishin rreth idesë që
13 ndoshta kjo ashpërsia apo kjo kokëfortësi ishte dekurajuese në
14 sytë e amerikanëve. Dhe mendoj që ideja që mbështes këtë është
15 që duhet të rrini me amerikanët, duhet të jeni afër me
16 amerikanët sepse ata janë të vetmit që mund të bëjnë që gjërat
17 të ndodhin në interesin e tyre dhe ishte kjo ndjenja që mos
18 t'i ngacmojmë amerikanët tepër apo mos t'i zhgënjejme tepër
19 dhe kjo ishte arsyeja sepse ishte e dobishme që amerikanët të
20 ishin aty dhe ata të tregoheshin shumë miqësor -- të mos
21 tregoheshin shumë miqësor me njërin anë apo me tjetrën. Mendoj
22 që kjo ishte në interes tonin dhe nuk do të çonte në ndonjë
23 rezultat më të mirë.

24 Nuk ndodhi. Dhe në Rambuje pati pjesëmarrje të barabartë
25 por ishin të interesuar ta largonin LDK-në, e cila kishte qenë

1 përgjegjëse për çështjet e Kosovës, kur them përgjegjëse
2 flasim në kuptimin e politikave të jashtme. Gjithmonë takonim
3 Rugovën, pra, në këtë kuptim e kisha fjalën.

4 Pra, kur pamë amerikanët që ishin në favor të pikëpamjeve
5 të UÇK-së filluan të flisnin në mënyrë dhe flisnin shumë egër
6 kundër Milosheviqit, disa nga personat që ishin kundër në UÇK
7 u bënë më optimistë dhe menduan që ne në fakt do të punonim në
8 favorin e tyre. Sidoqoftë për mua kjo nuk ishte qasja e duhur.
9 Unë ua thashë këtë personave në Uashington, u thashë që duhet
10 të kemi një qasje të ekuilibruar, të punojmë me të gjithë
11 njësoj, por nuk ranë të gjithë dakord me propozimin tim.

12 Disa persona, madje tani kur shikon moshën time do
13 qeshni, po disa persona thoshin që "Është shumë i ri z. Hill
14 për të marrë vendime të këtij lloji".

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] S'po komentoj për këtë, z.
16 Hill.

17 Kur keni biseduar në të shkuarën - më falni - javët e
18 fundit me Mbrojtjen dhe e kam fjalën për shënimin përgatitor,
19 paragrafin 16, sipas këtij paragrafi ju keni thënë se "ju
20 kujtohen problemet me disa gazetarë dhe ushtarët serbë".

21 Unë dua t'ju pyes tani nëse ju kujtohet sot, sepse dje
22 nuk ju kujtohej, pra, ju kujtohet ajo ngjarja me ndalimin e
23 nja dy gazetarëve serbë?

24 PË. U përpoqa t'ua thosha dhe dje, problematika të tilla
25 dilnin. Sikurse e diskutuam dhe ju më treguat madje dhe një

1 artikull para 45 minutash dikush ishte rrëmbyer në mënyrë që
2 të dëshmonin diçka dhe më pas liroheshin. Ndodhnin shpesh
3 raste të tilla, persona ndaloheshin, persona liroheshin. Pra,
4 dilnin problematika të tilla dhe ne ju thonim që ne nuk ju
5 mbështesim nëse rrëmbeni persona, e bënim të qartë pikëpamjen
6 tonë.

7 Në atë kohë, sigurisht që ishte diçka e pakëndshme. I
8 dëgjonim herë pas here. Por problemi, puna ime ishte që të
9 kisha persona që të punonin për një dokument dhe e dinim që ky
10 dokument sigurisht nuk ishte tërësisht në përputhje me
11 objektivat e tyre.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju premtoj që është hera e
13 fundit që do përpiqem që t'ju rifreskoj kujtesën, po dua t'ju
14 jap mundësinë t'ju kujtohet. Kjo përmendet në një dorëshkrim
15 që mendohet se është i z. Krasniqi.

16 Dhe është në faqen SPOE00231058. Faqja 22 e librit.

17 PË. Kur është botuar ky libër? Apo është i pabotuar?

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në ballinë thuhet "Libër",
19 thotë "Prishtinë, shkurt 2020".

20 Shkojmë më poshtë.

21 Z. Ambasador, paragrafi që më intereson është i fundit që
22 fillon me fjalën "Delegacioni ...".

23 Autori këtu flet për dy takime që ka pasur me ju dhe me
24 drejtorin tjetër të departamentit të shtetit, z. Rossin dhe më
25 pas zëvendësin, z. Petersen. Mua më intereson diçka që thuhet

1 në mes të paragrafit, është një fjali ku thuhet:

2 "Në këtë takim është biseduar edhe për dy gazetarë serbë
3 të zënë rob në afërsi të Goleshit. Christopher Hill kërkoi që
4 t'i lironim sa më parë, unë i thashë se kjo do të ndodhë në
5 prag të festës së 28 nëntorit."

6 Po ndaloj këtu. E dini çfarë është festa e 28 nëntorit?

7 PË. Mendova se ishte pushim jugosllav në fakt, mendova se
8 ishte një pushim jugosllav.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas tha:

10 "Kjo atij u duk pak larg dhe me cinizëm të hollë më
11 thotë: 'Mos doni t'i dorëzoni në Vlorë'?"

12 PË. Vlora, qyteti në Shqipëri?

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ua lexoj dhe më pas do
14 t'jua bëj pyetjen.

15 "Unë i përgjigjem: 'Më 28 nëntor. Më 28 nëntor kudo në
16 Kosovë është Vlorë'."

17 Dhe më pas vijon dhe thotë:

18 "Kjo përgjigje në ato momente më erdhi krejt natyrshëm
19 dhe doja t'i thosha se ne vazhdojmë të ecim në rrugën që
20 armiq të tanë na e kishin ndërprerë në nëntorin e vitit 1912,
21 të formalizuar në Londër në gusht të vitit 1913 nga Konferenca
22 e Ambasadorëve.

23 [Mikrofoni çaktivizuar].

24 PË. Nuk --

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast, një

1 çast.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'jua bëjmë dhe një
3 herë pyetjen se mikrofonin ishte i fikur.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
5 ka diçka.

6 Z. MISETIC: [Mikrofonin çaktivizuar].

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic më bëri me
8 shenjë që kisha mikrofonin e fikur kështu që ju faleminderit.
9 Z. Misetic është një shok i mirë.

10 Z. Ambasador, ju kërkoj ndjesë. A ju kujtohet takimi dhe
11 diskutimi që keni bërë me z. Krasniqi për këto çështje?
12 PË. Do kisha dashur të më kujtohej. Besoj çfarë kam dashur të
13 them këtu është se kam dashur të tregoj se e dija ku ishte
14 dita e flamurit, ku u ngrit flamuri me dy krenare, pra, në
15 këtë pjesë të Ballkanit, pra, ishte në Vlorë në 1912. Nuk më
16 kujtohej konkretisht në cilin ditë të muajit ishte. Por
17 ndonjëherë ishte mirë t'i tregoj një bashkëbiseduesi shqiptar
18 që dije diçka për historinë e tyre. Është e dobishme se kur
19 tregon se ke njohuri historike, personat janë më të prirur të
20 të thonë të vërtetën.

21 Po nëse ju tregoni, po, unë di diçka për vendin tuaj, kjo
22 është e dobishme. Nuk e di saktësisht si ka rrjedhur biseda.
23 Edhe mendoj se arsyeja pse nuk e mbaj mend është se këta
24 persona janë liruar. Kështu që ky për mua ishte lajm i mirë
25 edhe pastaj vazhdon punën që kishte planifikuar.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Këto ishin
2 pyetjet e mia.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
4 [Përkthim] Gjykatësi Gaynor tani, në të majtën tuaj në të
5 djathtën time do t'ju bëj pyetje.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mirëmëngjes, Ambasador. Do
7 t'ju bëj pyetje vetëm për dy kabllograme të Departamentit të
8 Shtetit që janë në listën e materialeve të Mbrojtjes së z.
9 Thaçi. Bëhet fjalë për materialin P1067 dhe P1069.

10 Fillimisht do i lutesha Sekretarisë që të vendosë në
11 ekran materialin P1067. Do të shihni kabllogramin në ekran që
12 ka dalë nga Ambasada Amerikane në Beograd drejtuar Sekretares
13 së Shtetit në Uashington dhe ashtu për dijeni të Drejtorisë
14 Politike Evropiane dhe Ambasadës Amerikane në Tiranë. E
15 shihni?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni qenë ju një prej
18 personave që e keni marrë këtë kabllogram?

19 PË. Po, ka të ngjarë. Është pak çudi që Beogradi ta ketë çuar
20 kaq vonë gjatë ditës këtë kabllogram, sidoqoftë nuk është e
21 rëndësishme kjo gjë.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Unë në fakt dua të kuptoj
23 çfarë nënkupton kjo 031743Z Nëntor 98, është ora kjo 1734?

24 PË. Ah, po. Kjo është një kabllogram që Shaun Byrnes ia ka
25 çuar Beogradit dhe më pas nga Beogradi është shtypur mesazhi i

1 Shaun dhe është përcjellë më tej.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ky raport është dërguar më 3
3 nëntor që është tre ditë pas vizitës tuaj në Dragobil më 6
4 nëntor me Shaun Byrnes, saktë?
5 PË. Si rregull është e saktë. Po kam unë një pyetje,
6 paqartësia ime është në fakt kur është hartuar kjo dhe si e
7 nxorën kaq shpejt. Kjo është data kur ka dalë në fakt
8 kabllogrami.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E kuptoj. Pra, ju po shkonit
10 në Dragobil të takonit Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin dhe të
11 tjerët me Shaun Byrnes, a ka mundësi që edhe pse mund të mos e
12 keni lexuar kabllogramin në detaje, Shaun Byrnes me siguri do
13 ta ketë ndarë analizën e tij lidhur me strukturën e UÇK-së me
14 ju?

15 PË. Nuk mund t'ua them me siguri. Shaun kishte qenë më parë
16 në Ambasadën e Beogradit dhe ishte shumë i shqetësuar se
17 kanalet e raportimit do të ishin përmes Beogradit dhe jo
18 përmes të dërguarit të posaçëm që ndodhej të ishte edhe
19 ambasadori në Shkup. Pra, ishte shumë i shqetësuar që kishte
20 këtë kanal komunikimi dhe kanali komunikimit s'ishe përmes
21 meje.

22 Në një botë ideale, që nuk ishte aspak rasti, çfarëdo
23 ishte në këta kabllograme si rregull duhet të ishte ndarë me
24 mua dhe ne duhet të kishim biseduar me njëri-tjetrin apo të
25 kishim koordinuar për këtë.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

2 Dhe shohim tek paragrafi 5, po e lexoj, z. Byrnes këtu
3 shkruan:

4 "Mesa mund të themi në këtë pikë, 'Shtabi i Përgjithshëm'
5 i UÇK-së apo zyrat qendrore përbëhen prej gjashtë drejtorive:
6 Politike, informacionit, logjistika, policia, drejtësia dhe
7 operativja. Drejtoria politike përbehet nga shtatë persona,
8 një prej të cilëve se jeton jashtë vendit mesa duket (Bardhyl
9 Mehmeti). Hashim Thaçi, 'komisari' politik i Drenicës duket të
10 jetë kreu i drejtorisë politike. Drejtoria politike mund të
11 jetë dhe një sinonim për udhëheqjen e UÇK-së."

12 Keni ndonjë koment lidhur me atë që ka thënë Shaun Byrnes
13 që Thaçi mund të ketë qenë drejtuesi i vërtetë i UÇK-së?
14 PË. Kishte persona që nuk pajtoheshin me shumë nga gjërat që
15 po ndodhnin atje në terren, po njerëz të singertë. Shaun ishte
16 më i prirur se unë të besonte se ekzistonte një objekt që
17 kishte linjën hierarkike të komunikimit që njihej ndryshe si
18 UÇK-ja. Dhe fjala, termi 'komisar' është një term perëndimor.
19 Mbase Shaun për faktin që ka punuar në Moskë kishte huazuar
20 terma të tilla si termi 'komisar'.

21 Megjithatë ai mendonte se ekzistonte një strukturë e
22 mirëorganizuar, unë nuk ndaja të njëjtin mendim sikurse Shaun.
23 Unë e respektoj shumë Shaun, por mendoj se kjo ishte një
24 orvatje për të përshkruar një organizatë edhe mendoj se e
25 kishte ekzagjeruar pak përshkrimin e kësaj organizate.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Më pas në këta paragrafë
2 thuhet:

3 "Drejtuesi politik i Malishevës", pra, Hashim Thaçi,
4 "pretendon se flet në emër të të gjitha zonave dhe nënkupton
5 se është Shtabi i Përgjithshëm."

6 Pra, ky është raportimi i Byrnes dhe kjo i është thënë
7 drejtpërdrejt Byrnes mesa duket?

8 PË. Shaun, ne themi në shërbimet e huaja ishte shumë i ëmbël,
9 karizmatik. Dilte, bisedonte me persona. Mbase mund t'ia ketë
10 thënë dikush këtë gjë. Por siç ndodh shpesh në Kosovë dhe jo
11 vetëm në Kosovë, informacionet shpesh nuk janë të vërteta dhe
12 nuk kanë për synim të informojnë personin po të kenë një
13 ndikim te personi që duhet ta marrë këtë informacion. Pra, kjo
14 ishte një përpjekje për të na bindur ne dhe për të na thënë ne
15 që kjo është një organizatë dhe një ushtri vërtetë e
16 strukturuar. Unë nuk e pashë. Unë nuk e shihja njësoj si ai,
17 unë nuk e shihja atë që shihte ai, dhe të jem i sigurtë nuk
18 pajtohem me deklaratën e tij.

19 Dhe ia kam thënë këtë atij. Sigurisht që unë nuk mund
20 t'ia censuroja kabllogramet Shaun, po unë nuk ndaja të njëjtin
21 mendim, unë nuk do ta kisha përshkruar në mënyrën sesi e ka
22 përshkruar ai.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shohim disa nga konstatimet
24 që janë zbardhur apo janë pasqyruar në këtë kabllogram.

25 Shkojmë në faqen tjetër.

1 Në krye të faqes thuhet kështu.

2 "Për pjesën më të madhe, trupat e UÇK-së dukeshin të
3 rinj, të veshur me uniforma që dukeshin krejt të reja dhe
4 kishin armë këmbësorie moderne. Në Likovc, pamë disa persona
5 të rinj të veshur me kostume ngjyrë gri të lehtë dhe që kishin
6 armë 7 mm. Disa të tjerë ishin veshur me kostume të zeza dhe
7 quheshin elita "Tigrat" e njësimit "Tigri" edhe mbanin
8 automatikë, kishin po ashtu mitraloza dhe kishin
9 granatahedhëse.

10 "Në zonën e Malishevës, në darkë pamë grupet më të
11 mirëstrukturuara të trupave të UÇK-së. Në dy raste kemi parë
12 grupe me 30-40 burra që kishin dhe armatimet që ishin gati
13 duke dalë nga fshati Pagarushë."

14 Ndalojmë pak për përkthyesit se ishim shpejt.

15 Pra, përshtypja që jepet në këtë tekst është që vetë
16 grupi që punonte me Shaun Byrnes kanë parë forca ushtarake të
17 UÇK-së me armatime, me uniforma, madje në një rast e kam parë
18 që ishin organizuar tamam siç duhet organizuar në një ushtri.
19 Çfarë mund të thoni lidhur me këtë?

20 PË. Unë prapë mendoj që këto paragrafë kanë synim të kenë
21 ndikim dhe jo të informojnë. Këtu thotë ai që këta "Trupat e
22 UÇK-së dukeshin të freskët, të rinj". Unë nuk e di çfarë ka
23 dashur të thotë ai me këtë. Nuk e di. Kishin fjetur mirë,
24 s'kishin fjetur mirë. Thotë me "Uniforma të reja të
25 hekurosurat".

Unë mendoj se e kuptoj pse e ka shkruar ai këtë. Por për faktin thjesht ne nuk mundeshim për nëntë muaj të gjenim një person që të merrte vendime, thjesht takonim persona që thonin, "Po, po do flasim ne me dikë", "Do ju kthejmë ne një përgjigje me këtë", ne nuk mendoj, ne nuk kishim parë një strukturë të organizuar sipas standardeve perëndimore që mund të jetë e ngjashme me ushtrinë e NATO-s.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shkojmë në faqen 5. Po fillimisht shikojmë fundin e faqes 4, këtu thuhet që:

"Kontaktet e UÇK-së flisnin shpesh për Shtabin e Përgjithshëm po janë shumë të mjegullt kur bëhet fjalë për përbërjen dhe vendndodhjen e Shtabit të Përgjithshëm."

"... Shtabi i Përgjithshëm duket se ka të paktën gjashtë drejtori."

Në faqen tjetër, këto gjashtë drejtori janë të evidentuara si në vijim: Operativja, logjistika, drejtoria politike, që drejtohet nga Hashim Thaçi, informimit, që "është përgjegjëse për çështjet e zbulimit po mund të ketë dhe funksionin e shtypit, për shtypin", policia "përgjegjëse për zbatimin e ligjit", "Sabit Geci ose Gecaj pretendon se është përgjegjës për këtë drejtori" dhe drejtoria e drejtësisë.

Pra, këtu është një përshkrim i detajuar i strukturës së Shtabit të Përgjithshëm bazuar në informacionin që ka marrë Shaun Byrnes dhe ekipi i tij, prezumoj.

PË. Ka mundësi që këtë ta ketë marrë prej burimeve të UÇK-së

1 këtë informacion.

2 Një koment që do të bëja unë është që UÇK-ja donte të
3 tregonte që ne jemi përgjegjës për Kosovën, jo kjo LDK-ja, dy,
4 nëse na duhen aleatë në një betejë kundër Serbisë, atëherë të
5 themi që kemi një ushtri të mirë në terren dhe emri i kësaj
6 ushtrie është UÇK dhe meqë kemi ushtri dhe kontroll politik, e
7 vetmja gjë që mungonte ishte forca ajrore dhe shpesh na thonin
8 që duhet të përfshiheshim në fushatën bombarduese.

9 Pra, mendoj se kjo është, siç ua thashë, është shkruar
10 për të pasur ndikim dhe jo për të informuar. Kur shikon dhe
11 lexon gjëra të këtij lloji, pikëpyetja duhet të jetë: Në
12 rregull verifikoje këtë informacion. Shko shikoje konkretisht
13 në terren. Shikoje si funksionon. Si është e formuar kjo
14 strukturë. Mund të thoni që jam thjesht person skeptik që s'e
15 pranoj që UÇK-ja ka qenë e organizuar në këtë formë. Për mua,
16 problemi ishte që Kosova që është 80, 90 për qind shqiptare
17 ishte keqtrajtuar nga serbët, nuk mund të vazhdonte më ky
18 vend. Duhej rikthyer autonomia, duhet të gjenin pika kontakti
19 në terren për të punuar për propozimin tonë - kur them
20 propozimin "tonë", sigurisht bëhet fjalë për Grupin e
21 Kontaktit - dhe duhet t'i kërkonit Beogradit të ndryshonte.

22 Pra, për mua ky material i shkruar kështu më tregon që ai
23 ka dash të thotë të përgatitemi për luftë.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani do të bëjmë pushim.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Tani do bëjmë pushim për gjysmë ore.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
4 deri në orën 11.30.

5 --- Pauza fillon në orën 11.00

6 --- Seanca rifillon në orën 11.30

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
9 Gaynor ka disa pyetje të tjera për ju, Ambasador.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
11 Smith.

12 Ju lutem vazhdojmë me dokumentin që kemi në ekran, në
13 pjesën e fundit të këtij dokumenti.

14 Ambasador, thuhet që sa i takon Shaun Byrnes:

15 "Sipas Hashim Thaçit, drejtorja politike përbëhet nga
16 personat e fundit, nga personat që janë këtu", domethënë, i
17 pari është "ai vetë". "Jakup Krasniqi". Dhe "ne as nuk e kemi
18 parë dhe as nuk kemi dëgjuar lidhur me veprimtaritë e tij. Por
19 Thaçi thotë që ai është aktiv."

20 Dhe pastaj përmendet "Bardhyl Mahmuti".

21 A keni pasur informacion sa i takon anëtarësisë së
22 drejtorisë politike, Ambasador?

23 PË. Këta janë emra që i kam të dëgjuar. Nuk jam i sigurtë
24 nëse kam ndonjë koment domosdoshmërisht. Kaq mund të them.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Kalojmë tek i

1 njëjti dokument por dy faqe më tej, në këtë pjesë të
2 dokumentit raportohet që:

3 "Udhëheqësit e UÇK-së me të cilit jeni takuar kohët e
4 fundit na e kanë bërë të qartë gatishmërinë e tyre për
5 kontakte të vazhdueshëm me përfaqësuesit amerikanë. Thaçi dhe
6 Mahmuti janë posaçërisht të gatshëm për t'u takuar me
7 ambasadorët Holbrooke dhe Hill dhe ata janë të gatshëm për të
8 qenë udhëheqësit e UÇK-së."

9 Në fakt, ju jeni takuar dy ditë më pas me këta dy
10 persona, apo jo, Dëshmitar?

11 PË. Po.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua t'ju pyes pak lidhur me
13 përshtypjen që ju krijua gjatë këtij takimi. Në përmbledhjen
14 tuaj në paragrafin 28 ju thoni:

15 "Thaçi ishte udhëheqës politik, jo udhëheqës ushtarak.
16 Hill nuk e pa ose nuk e kuptoi që Thaçi kishte kontroll përtej
17 asaj çfarë ju bë atij e qartë brenda dhomës së takimit."

18 A pajtoheni ju, Dëshmitar, që UÇK-ja ishte një lëvizje
19 çlirimtare e armatosur?

20 PË. Po. Po pyetja që shtrohet është se sa e integruar ishte
21 UÇK-ja krahasimisht me grupe të tjera të ndryshme që lidheshin
22 vetëm tangentialisht me të, por ndërkohë vepronin sipas kokës
23 së tyre dhe urdhra të tyre. Kështu që pyetja që shtrohet
24 është: A bëhet fjalë për një organizatë që sugjerohet prej
25 Shaun këtu, apo jo?

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Duke pasur parasysh se bëhet
2 fjalë për një lëvizje çlirimtare të armatosur, cili është
3 dallimi, cila është ndasia midis një lideri ose udhëheqësi
4 politik dhe një udhëheqësi ushtarak në kuadrin e lëvizjes
5 çlirimtare të armatosur?

6 PË. Udhëheqësi politik është një person i cili luan një rol
7 të ministrit të punëve të jashtme, në qoftë se do shprehesha
8 kështu, dhe nuk është përgjegjës për çështjet e brendshme.

9 Përshtypja ime, dhe unë mund të flas vetëm për opinionet
10 dhe përshtypjet e mia, përshtypja ime është që në qoftë se do
11 shikoni historikun e Thaçit ça formimi ka ai, nuk ka asgjë që
12 sugjeron që ai mund të lëvizte gjërat brendapërbrenda UÇK-së,
13 por në pikëpamjen e jashtme ai e kuptonte se si funksiononte
14 bota dhe e kuptonte që ishte e rëndësishme që Shtetet e
15 Bashkuara të ishin në anën e tij, në anën e tyre.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të kalojmë në një
17 dokument tjetër që është i pranuar në prova që mban numrin
18 P1059. Është një kabllogram tjetër. Ambasador, tani në ekran
19 do të shfaqet një kabllogram, mund ta shikoni besoj që është
20 dërguar më datë 18 dhjetor 1998. Duket sikur është dërguar nga
21 Beogradi, nga Ambasada Amerikane atje për Uashington D.C. dhe
22 është dërguar në orën 9.38. Po ashtu është lista e marrësve të
23 këtij kabllogrami përfshirë këtu CIA, Italia dhe ambasadën në
24 Shkup e të tjerë. Ndërkohë që në fund fare është "NSC for
25 Hurley". Çfarë është kjo mund të na e thoni?

1 PË. Së pari më lejoni t'ua shpjegoj se si janë të
2 strukturuara, si janë të formuluar kabllogramet. Së pari janë
3 marrësit që janë ambasadat dhe pastaj janë edhe operacionet
4 ushtarake që janë shtabet ushtarake ose zyrat ushtarake të
5 rëndësishme. Sikurse mund ta shihni, është edhe SECSTATE që
6 është Departamenti i Shtetit, kjo është version i shkurtuar,
7 por për arsye të caktuara duket sikur ky është një kabllogram
8 që i është dërguar një personi. Po në fakt nuk ndodh kështu.

9 Se, për shembull, në qoftë se ti ke humbur orën dhe
10 mendoni se e keni lënë diku në një zyrë, pra, domethënë, në
11 qoftë se lexon tek titulli SECSTATE, kjo nuk do të thotë që ky
12 është një kabllogram ose një njoftim që i dërgohet Sekretarit
13 të Shtetit. Kështu që për këtë arsye është e rëndësishme që të
14 kuptohet konteksti dhe kujt i dërgohen kabllogramet. Në këtë
15 kabllogram, për shembull, janë vendet e Evropës Qendrore,
16 Ballkani Perëndimor, domethënë, duket sikur ky është një
17 kabllogram që i dërgohet të gjithëve këtyre që janë marrësit,
18 por nuk është kështu në fakt.

19 Sa i takon NSC, domethënë, ky është Këshilli Kombëtar i
20 Sigurisë. Dhe kush përbëhet, pra, kush janë përbërësit e
21 Këshillit Kombëtar të Sigurisë? Është sekretari i shtetit,
22 presidenti i vendit, e tjerë e tjerë. Domethënë, është nivel
23 shumë i lartë. Kështu që duhet të jesh i kujdesshëm që të
24 marrësh masat e nevojshme që ky kabllogram të mos përfundojë
25 në duart e të gjithëve figurativisht.

1 Duhet ta kem ditur besoj në atë kohë, po tani nuk më
2 kujtohet, pra, është një akronim EXDIS. Besoj se e patë atë
3 kabllogramin ku ishte Madeleine Albright në sallë që quhej
4 NODIS, domethënë, që "nuk duhet të shpërndahet". Por EXDIS do
5 të thotë që "shpërndarja është e kufizuar".

6 Pra, është pak e vështirë që të dërgosh një kabllogram
7 EXDIS në disa zyra. Sepse një kabllogram me këtë kodin EXDIS
8 duhet që të jetë i përfshirë sekretari, ndihmëssekretari i
9 Evropës, nuk më kujtohet se kush ka qenë, por ideja është që
10 ti nuk do që ndihmëssekretarit të Evropës të mund t'i dërgosh
11 të gjitha kabllogramet. Pra, dua të them që këto janë raporte
12 të përditshme, janë raporte që dërgohen nga Shaun dhe nuk
13 është hera e parë që këto kabllograme janë të mbikategorizuara
14 ose me shumë specifikime.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Këtu thuhet që:

16 "Ky është një raport i hartuar nga KDOM-i mbështetur në
17 konstatimet në terren dhe në bisedat me udhëheqësit e UÇK-së
18 si dhe vëzhgues të mirinformuar kosovarë, përfshirë këtu edhe
19 zyrtarë të nivelit të lartë të policisë serbe."

20 PË. Më lejoni të them --

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
22 dëgjoni deri në fund pyetjen pastaj përgjigjuni dhe mos u
23 mundoni që t'i dilni përpara pyetjeve që do t'ju bëhen në të
24 ardhmen. Sepse pyetja që të bëri Gjykatësi më përpara ishte
25 çfarë është NSC-ja. Dhe ti na dhe një shpjegim shumë më të

1 hollësishëm. Kështu që ju lutem dëgjoni pyetjen deri në fund.

2 Dhe pastaj jepni përgjigjen.

3 PË. Po. (C) është "konfidenciale".

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ka të ngjarë që ky

5 kabllogram të jetë përgatitur nga Shaun Byrnes?

6 PË. Absolutisht po.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, duket në pamje të parë

8 që baza nga ku është marrë informacioni është goxha e plotë,

9 apo jo?

10 PË. Kështu duket.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Le të kalojmë tek dokumenti

12 në faqen e dytë. Në paragrafin e dytë të gjatë aty, ai thotë

13 që:

14 "Nuk del në pah të ketë një udhëheqës të UÇK-së,

15 megjithatë profili i Hashim Thaçit është bërë dominant edhe

16 dukshëm në takimet tona. Në takimet tona udhëheqësit ushtarakë

17 të UÇK-së qartazi e respektojnë Thaçin."

18 Dua t'ju bëj një pyetje lidhur me këtë konstatim që jepet

19 këtu, domethënë, mbështetur në atë çfarë ka konstatuar Byrnes,

20 udhëheqësit ushtarakë e shikonin me respekt Thaçin?

21 PË. Çfarë date ka ky kabllogram?

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Më 18 dhjetor, 18 dhjetor

23 1998.

24 PË. Besoj se ajo çfarë po thotë Byrnes këtu, dhe unë pajtohem

25 me të, që në një farë mënyre jo i njohur ose i panjohur dhe ai

1 përmes telefonatave të drejtpërdrejta të bëra me Petritsch, e
2 ka rritur dukshmërinë e tij, pra, është bërë një figurë më e
3 njohur.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të vazhdojmë tek një faqe
5 tjetër që ka numrin ERN 075323. Domethënë, është faqja 8 nga
6 20 faqet e këtij dokumenti. Ka një titull këtu që thuhet:
7 "Shtabi i Përgjithshëm". Edhe thuhet që shtabi është "jo
8 koherent, është në lëvizje të vazhdueshme". Dhe diku nga mesi
9 i këtij paragrafi thuhet që:

10 "Pavarësisht kësaj, ne kemi pasur mundësinë që të
11 identifikojmë disa persona të Shtabit të Përgjithshëm,
12 përfshirë këtu Hashim Thaçin, shefin e drejtorisë politike të
13 UÇK-së, Rexhep Selimin ... Ramë Bujën ..."

14 Dhe në qoftë se do të vijojmë tek faqja tjetër, lexoni
15 aty dhe:

16 "Jakup Krasniqin, anëtar të drejtorisë politike dhe
17 zëdhënës i UÇK-së, Sylejmani 'Sultani' Selimi ... dhe Azem
18 Sula ... Xhavit Haliti ..."

19 "Besoj që vazhdohet më tej me Sokol Bashotën ... dhe
20 Nuredin Ibishin ... (që gjithashtu mund të jenë) anëtarë të
21 Shtabit të Përgjithshëm, po nuk e konfirmojmë dot këtë gjë."

22 A pajtoheni me mua, Dëshmitar, që këtu kemi informacion
23 të hollësishëm mbështetur në burime goxha ose tejet të
24 besueshme, do të thoja unë, sa i takon identifikimit të
25 anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

1 PË. Po. Megjithatë, këtu vërej se duket sikur të gjithë këta
2 janë nga Drenica.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kjo më çon mua tek faqja
4 tjetër dhe tek pyetja e radhës, është faqja 12 nga 20 faqet e
5 dokumentit që kemi në fjalë ose 0757327, këtu thuhet:

6 "Duket se grupi i Drenicës ka luftuar dhe ia ka dalë me
7 sukses që të ketë kontroll në hierarkinë e re të UÇK-së që po
8 krijohet. Grupi i Drenicës duket se drejtohet prej Hashim
9 Thaçit dhe përbëhet kryesisht prej personave të moderuar që
10 janë më pro një zgjidhjeje të paqëshme sesa luftimeve."

11 Pra edhe një herë, këtu duket sikur sugjerohet që në
12 qoftë se është dikush që e drejton UÇK-në ky person është
13 Hashim Thaçi, a pajtoheni me mua?

14 PË. Nuk jam në gjendje të analizoj atë çfarë është thënë, po
15 kështu duket sikur thotë autori.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kalojmë tek mesi i faqes
17 thuhet që:

18 "Udhëheqja bëhet nga ish-të burgosur politikë të më
19 hershëm si, për shembull, Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja, të
20 cilët kanë qenë politikisht aktivë që prej fillimit të viteve
21 1980 ose ish-udhëheqës së lëvizjeve të studentëve të 1999s,
22 Thaçi, Rexhep Selimi, për shembull, luftëtarë si Sylejman
23 Selimi, komandanti i ushtrisë së Malishevës e të tjerë. Ish-të
24 burgosurit politikë raportohen që të jenë udhëheqës të krahut
25 moderuar, ndërkohë që ish-pjesëmarrësit e protestave

1 studentore si Thaçi dhe Selimi, janë më radikalë. Ata
2 pretendojnë që të mbështesin rrugën politike në kontaktet me
3 ne, Thaçi dhe Selimi në tonin e përdorur prej tyre duket sikur
4 janë më strikt sesa Buja, Krasniqi dhe Bashota. Thaçi dhe të
5 tjerët duket se kanë respektin e të gjithëve.”

6 Atëherë, këtu përfshihen disa anëtarë të udhëheqjes sipas
7 autorit të këtij kabllogrami dhe duket që ndërmjet tyre më i
8 rëndësishmi duket sikur është Hashim Thaçi?

9 PË. Duke e lexuar shumë shpejt këtë pjesë, pajtohem me ju që
10 kështu duket sikur është ideja e autorit dhe në veçanti që
11 Drenica ka fituar epërsi dhe është më lart, nëse mund të
12 shprehesha kështu, se grupet e tjera në të gjithë Kosovën. Kjo
13 është një përpjekje e madhe pra, për të mbledhur së bashku të
14 gjithë informacionin dhe këtë informacion ta bësh në mënyrë të
15 tillë që është koherent dhe i kuptimtë.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kalojmë tek faqja 075325,
17 atëherë këtu po flasim për madhësinë e UÇK-së ose sa e madhe
18 mendohej që të ishte UÇK-ja. Në këtë pjesë thuhet që një burim
19 i mbrojtur ka pretenduar disa herë. Dhe emri i personit është
20 redaktuar, pra, ky person:

21 “... ka pretenduar disa herë që UÇK-ja ka 30.000 ushtarë
22 dhe ... ka po aq armë. Ne e kuptojmë që organizimi i UÇK-së
23 parashikon që secila prej zonave të përmbajë pesë brigada.
24 Brigadat mund të kenë deri në pesë batalione nga 140 deri në
25 150 secili. Kështu që ne për rrjedhojë vlerësojmë që UÇK-ja

1 mund të ketë rreth 22.000 anëtarë. Ne mendojmë që ky është
2 numër goxha i lartë dhe mendojmë që dikund deri në 7.000 apo
3 8.000 të ketë anëtarë UÇK-ja.”

4 A keni ndonjë arsye që të thoni që këto shifra nuk janë
5 të sakta, Dëshmitar?

6 PË. Jo, nuk kam. Po nuk e di se si është mbledhur një
7 informacion i tillë. Zakonisht ky është një formacion i cili
8 mbledhet në Uashington nga shërbimet inteligjente jo nga
9 persona në terren. Kështu që është një përbërje disi befasuese
10 do thoja.

11 Por gjithsesi ky lloj informacioni i dërgohet zakonisht
12 Uashingtonit dhe pastaj konfirmohet ose gjithë burimet e
13 nevojshme shikonin se për çfarë po flisnim ne kur i
14 referoheshim UÇK-së. Mua nuk më kujtohet ose ky informacion
15 ose nuk më kujtohet që komuniteti i shërbimeve inteligjente të
16 kenë pajtuar me ndonjë shifër të tillë ose të ngjashme. Nuk më
17 kujtohet as tani dhe as atëherë s'mbaj mend.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa i takon strukturës së
19 UÇK-së sipas vlerësimit të Byrnes janë 22.000 veta që ishin
20 ndarë në zonat, që ndaheshin më pas në brigada, të cilat më
21 pas ndaheshin në batalione.

22 Në ndonjë fazë të përvojës tuaj, a keni pasur mundësi që
23 të shikonit komunikime të brendshme të UÇK-së të cilat ose
24 janë nxjerrë prej komandave të zonës ose komandave të
25 batalioneve apo të brigadave, ju ka rënë rasti të shikoni

1 dokumente të tilla ndonjëherë?

2 PË. Mendoj që këto hollësitë e lidhura me brigadat dhe
3 batalionet janë gjëra që s'kemi pasur asnjëherë mundësi që t'i
4 shikojmë apo t'i konfirmojmë. Mendoj që informacioni është
5 shumë herë më i hollësishëm sa i takon strukturës, është
6 informacion shumë më i hollësishëm sesa mund të prodhohej prej
7 ndonjë ambasade. Kështu që pyetja ime do ishte nuk e di sesi
8 komuniteti i inteligjencës së departamenteve të caktuara e
9 kanë mbledhur këtë informacion. Në qoftë se e kanë marrë këtë
10 punë seriozisht apo jo? Këtë nuk ua them dot.

11 Megjithatë, prej pikëpamjes time, mënyra se si e shikoj
12 unë, pra, lidhur me vazhdimin e negociatave, situata nuk është
13 se ndryshonte shumë për mua sepse për mua ishte e qartë që ne
14 na nevojitej UÇK-ja si pjesë e negociatave, pavarësisht sesa
15 brigada kishin apo jo. Kjo ishte e rëndësishme për mua, por ne
16 donim gjithashtu që ata të mos linin mënjanë LDK-në dhe të
17 thonin që LDK-ja nuk kishte rëndësi, se kjo ishte ajo se çfarë
18 po përpiqeshin të thonin shumë veta në atë kohë.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, ju po thoni që njohuria
20 juaj deri në çfarë mase ishte e organizuar ose jo UÇK-ja nuk
21 mbështetej deri në një farë mase në leximin e komunikimeve të
22 brendshme që lëshoheshin prej brigadave ose komandantëve të
23 zonave ose nga batalione brenda UÇK-së? Këtë po thoni në qoftë
24 se e kuptova drejt?

25 PË. Ma thoni dhe një herë se nuk e kuptova pyetjen.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mesa e kuptoni ju, a keni
2 pasur qasje në dosje dokumentesh të cilat janë lëshuar prej
3 komandantëve ose komandave të zonave ose nga batalionet e
4 njësive të tjera të UÇK-së?

5 PË. Jo, nuk më kujtohet ta kem bërë këtë gjë. Reagimi im
6 ishte që persona që e kishin si profesion këtë gjë të bënë
7 vlerësimet e tyre sa i takon ushtrive të huaja, se ne kemi
8 zyra të tëra në Agjencinë Inteligjente të Mbrojtjes, detyra e
9 të cilëve nga mëngjesi deri në darkë është që të merren me
10 informacionet ushtarake në gjithë botën, unë mund të kisha
11 ndonjë interes lidhur me atë çfarë mund të thonin këta kolegë.

12 Por nga pikëpamja ime ajo çfarë po përpiqesha të bëja unë
13 është që unë të sigurohesha, dhe po përmend këtu një term që
14 përmendet më shumë në ditët e sotme sesa përdorej atëherë.
15 Pra, unë po përpiqesha që të kishim një grup sa më përfshirës,
16 pra, që të kishin persona nga UÇK-ja, nga LDK-ja dhe nga të
17 pavarurit në mënyrë të tillë që të gjenim një zgjidhje. Këtë
18 po përpiqesha të bëja unë.

19 Po tani që lexova tekstin, kjo mund të sugjerojë që i
20 takonte që UÇK-ja ishte forcë e madhe potente dhe, mbase dhe
21 ishin, po nuk ndryshonte asgjë në punën time, unë isha i
22 interesuar që të gjithë palët të merrnin pjesë aktivisht në
23 negociata.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera për
25 ju, Dëshmitar. Ju faleminderit për kohën.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi

2 Barthe ka disa pyetje për ju tani.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të sqaroj diçka? Një diçka
4 që vura re në atë kabllogram ishte që kishe shumë paragrafë
5 dhe pashë atë (C), për shembull, që do të thotë
6 "Konfidenciale". Ose N/F do të thotë që "nuk ka formë", çfarë
7 do të thotë që përmbajtja e këtij kabllogrami nuk i duhet
8 dhënë një pale që nuk është amerikane, domethënë, me fjalë të
9 tjera, NATO, t'i i thua shërbimeve tuaja që të mos ia japin
10 këtë informacion zyrës së Gjermanisë e Francës e tjerë. Edhe
11 me thënë të drejtën jam pak i befasuar që pse këtë informacion
12 ne nuk donim që ta ndanim me aleatët. Unë thjesht sa për
13 koment për ta pasur parasysh.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam disa pyetje tjera. Ju
16 premtoj që nuk do t'ju mbaj shumë më gjatë këtu.
17 PË. Ju kërkoj falje që ju jap shpjegime kaq shumë të
18 hollësishme.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk jeni i
20 vetmi që e bëni këtë gjë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ambasador, juve na thatë
22 gjatë dy ditëve të fundit në dëshminë tuaj që z. Thaçi ka qenë
23 drejtuesi i delegacionit shqiptar të Kosovës në Rambuje që
24 përfaqësonte UÇK-në. Dhe besoj që ju e dini që z. Thaçi më pas
25 u bë kryeministri i të ashtuquajturës Qeveri e Përkohshme e

1 Kosovës, a është e drejtë kjo?

2 PË. Po, është e saktë kjo.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në Konferencën e Rambujesë
4 dhe në krijimin e Qeverisë së Përkohshme këto kanë qenë
5 gjithashtu objekt i intervistës me Mbrojtjen, me Mbrojtjen e
6 Thaçit më datën 9 korrik 2025, që reflektohet edhe në
7 paragrafin 33 dhe paragrafët pasues të përmbledhjes së
8 intervistës tuaj. A ju kujtohen këto diskutime që keni pasur
9 me Mbrojtjen e Thaçit për Rambujenë, krijimin e Qeverisë së
10 Përkohshme së Kosovës?

11 PË. Po, veçanërisht krijimin e grupit negociator, që ishe një
12 grup me tre krerë dhe nuk ishte askush, si me thënë, drejtuesi
13 i dy të tjerëve.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gjatë pyetjeve që ju bëri
15 Mbrojtja e Thaçit të hënën, ju tregoi një dokument që kishte
16 të bënte me deklaratat politike të Shtabit të Përgjithshëm të
17 UÇK-së. Për procesverbal kjo jepet në provën 1D50 dhe në faqen
18 27679 dhe faqet pasuese të transkriptit.

19 Në këtë dokument, z. Thaçi është deklaruar së bashku me
20 pesë persona të tjerë si përfaqësues politik i UÇK-së. A ju
21 kujtohet ta keni diskutuar këtë dokument edhe dje me
22 Gjykatësin Mettraux ose sot më herët?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ambasador, mbështetur në
25 njohurinë që keni pasur asokohe dhe njohurinë që keni sot, a e

1 dini se çfarë roli ka pasur z. Thaçi përpara luftës,
2 domethënë, përpara marsit të 1998? A e dini në qoftë se ai ka
3 luajtur ndonjë rol, ka pas ndonjë rol përpara kësaj periudhe?
4 PË. Nuk di të ketë pasur ndonjë rol. Nuk di asgjë. Ajo çfarë
5 di unë është që ai ka qenë student në Evropë, diku në Evropën
6 Perëndimore dhe është kthyer në Kosovë prej këtyre studimeve.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në përgjigje të pyetjeve të
8 Prokurorisë dje ju thatë që ju nuk e dini në qoftë se z. Thaçi
9 ka qenë një prej themeluesve të UÇK-së dhe thatë që nuk jeni
10 në gjendje që ta konfirmoni këtë. Për procesverbal kjo mund të
11 gjendet në faqen 75 të transkriptit të përkohshëm të ditës së
12 djeshme.

13 A ju kujtohet ta keni thënë këtë dje, Ambasador?
14 PË. Po, këtë e thashë në përgjigje të pyetjes që mu bë nga
15 Prokuroria në qoftë se z. Thaçi ishte themelues i UÇK-së apo
16 jo. Unë nuk mund ta them në qoftë se ka qenë një prej
17 themeluesve të UÇK-së apo jo. Mund të them që në atë kohë ne
18 mendonim që dikush ishte 31 vjeç, që kishte qenë në Evropën
19 Perëndimore, nuk mund të ishte themeluesi i asgjëje,
20 megjithatë nuk mund të them në qoftë se ky hamendësim është i
21 vërtetë apo jo.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja që kam tani është
23 kjo: A e dini se kur është themeluar UÇK-ja dhe kush e ka
24 themeluar UÇK-në?

25 PË. Nuk më kujtohen historitë tani, por më kujtohet që kanë

1 ekzistuar teori të ndryshme rreth kësaj gjëje, pra, njëra prej
2 tyre kishte të bënte dhe lidhej me sulmin në familjen Jashari
3 në maj.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në maj të cilit vit?

5 PË. Në maj të vitit 1998.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dje thatë më tej se përpara
7 negociatave të Rambujesë, z. Thaçi ishte përshkruar, pra, të
8 tjerët ua kishin përshkruar atë si anëtar të drejtorisë
9 politike të UÇK-së. Këtë mund ta gjejmë në faqen 74 të
10 transkriptit të ditës së djeshme. A është i saktë ky
11 informacion, Dëshmitar?

12 PË. Po, ai kishte postin e drejtorisë politike, domethënë,
13 anëtarit të drejtorisë politike. Shqetësimi im ishte që nuk e
14 dija se në qoftë se mund ta shikoje atë si shef të
15 delegacionit të Marrëveshjes së Rambujesë dhe nuk e kisha
16 shumë të qartë se çfarë pozicioni kishte ai.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po tani a e dini se kush ua
18 ka thënë ju në atë kohë se z. Thaçi ishte anëtar i drejtorisë
19 politike të UÇK-së?

20 PË. Kjo është një pyetje empirike mendoj që dikush tjetër
21 mund ta shikojë, po mendoj që është thënë diku nëpër njoftime
22 nëse nuk e kam gabim.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e fundit që kam për
24 ju është kjo, Ambasador: Duke prezumuar që informacioni është
25 i saktë, si e shpjegoni ju që z. Thaçi të merrte këtë rol kaq

1 shumë të madh brenda UÇK-së dhe më pas në Qeverinë e
2 Përkohshme të Kosovës, domethënë, si e shpjegoni ju që si
3 ishte e mundur për të, që kishte qenë thjesht një student më
4 përpara dhe kishte atë moshë, domethënë, që të merrte një fuqi
5 të tillë në dorë dhe që të bëhej një prej personave me
6 pozicione më të larta të UÇK-së? Çfarë shpjegimi keni ju për
7 një situatë të tillë?

8 PË. Nuk kam asnjë shpjegim. Kam mendime të cilat ndonjëherë
9 mund të jenë dhe konfliktuale me njëri-tjetrin. Njëra prej të
10 cilave është që mbase nuk ishte aq shumë i fuqishëm sa mund të
11 shikohej nga jashtë. Sepse në fund të fundit, çdo vendim që
12 merrte ai vinte si rezultat i shumë konsultimeve të tjera
13 pararendëse. Kështu që përshtypja ime është që ai ishte një
14 bashkëbisedues i besueshëm po nuk ishte vendimmarrës. Kjo
15 përshtypje bënte kuptim kur ai na tha që nuk mund të pajtohej
16 lidhur me atë çfarë ishte bërë në Rambuje dhe kur na tha, për
17 shembull, "Në qoftë se binte dakord pa u konsultuar, kur të
18 kthehej do ta vrisnin". Një vendimmarrës nuk e bën një koment
19 të kësaj natyre. Kështu që unë personalisht e kam kuptuar që
20 ai ishte i besuar për të mbledhur informacionin, atij i
21 besohej që të parashtronte argumentet e UÇK-së, por nuk ishte
22 besuar në vendimmarrje, nuk i ishte lënë në dorë vendimmarrja.
23 Ky është opinionimi im.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje
25 të tjera për ju.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

2 [Përkthim] A keni pyetje plotësuese?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, kemi. Faleminderit.

4 Pyetje vijuese të mëtejshme nga z. Misetic:

5 Z. MISETIC: [Përkthim]

6 PY. Mirëmëngjesi, Ambasadori Hill. Kam vetëm disa pyetje

7 shitesë që lidhen me pyetjet që ju bënë nga Gjykatësit më

8 herët. Gjykatësi Mettraux dhe Gjykatësi Barthe ju pyetën

9 lidhur me atë që quhet Deklarata Politike numër 7, që është

10 deklarata e datës 13 gusht 1998 për të cilën Shtabi i

11 Përgjithshëm i UÇK-së pretendohet të ketë shpallur kush ishin

12 përfaqësuesit politikë të tyre.

13 PË. Po.

14 PY. Megjithatë, kjo është lëshuar më 13 gusht. Juve nuk ju

15 kujtohet të jeni takuar me z. Thaçi përpara datës 6 nëntor. A

16 duhet ta shohim këtë për këtë periudhën tre mujore, duhet të

17 kuptojmë ndonjë gjë për këtë periudhën tre mujore lidhur me

18 atë që ju mendonit për këtë shpallje të datës 13 gusht?

19 PË. Nuk jam i sigurtë si mund ta lexoj, çfarë mund të

20 nxjerrim nga ajo përveç faktit që ata ishin, pra, UÇK-ja

21 shpesh nxirrte deklarata, lëshonte deklarata të kësaj natyre.

22 Natyrisht, ajo që është interesante është këtu në këtë rast

23 është që ata kanë komunikuar disa emra. Pra, e di që ne u

24 përpoqëm të kuptonim kush ishin këta persona. Por edhe këtu

25 nuk ishim në gjendje të bënim propozime të natyrës që bëmë

1 pastaj në Rambuje.

2 Pra, nuk mendoj që kishte ndonjë qëllim apo synim, ndonjë
3 vlerë që të takoheshim me ta. Do të theksoja se nuk ishte e
4 lehtë që të takonim, të shkonim të arrijmë tek njerëzit që nuk
5 jetonin në Prishtinë dhe, natyrisht, për ata ishte dhe rreziku
6 i arrestimit nga autoritetet serbe. Pra, mendoj që ka patur
7 shumë shqetësime të natyrës praktike për sa i takon mundësisë
8 për t'u takuar me ata. Por me atë që më kujtohet lidhur me atë
9 që po thoni ju, është që ndoshta në tre muaj ne nuk kemi patur
10 takim ose ndoshta kemi bërë takime dhe nuk më kujtohet diçka
11 thjesht.

12 PY. Do t'ju pyes për një dokument tjetër për të cilin ju bëri
13 pyetje Gjykatësi Mettraux që është një kabllogram që dua ta
14 shfaqim në ekran përsëri, është prova materiale 1D267.

15 PY. Ju kujtohet?

16 Paragrafi 2, shohim datën dhe orën, bëhet fjalë për një
17 mbledhje që është bërë më 21 shkurt në orën 1.30 të pasdites
18 në kështjellë. Ora është e rëndësishme për pyetjet që do t'ju
19 bëj në vijim pastaj.

20 Pra, ora 1.30 pasdite. Dhe në qoftë se shkojmë më poshtë
21 në përmbledhjen e kësaj --

22 PË. A mund të shoh kush ishte i pranishëm?

23 PY. Po.

24 PË. Po, Sekretari, unë vetë, Rubin, Dobbin, procesmbajtësi,
25 Thaçi, Rugova, Surroi dhe Qosja. Po.

1 PY. Dhe menjëherë më poshtë mund të shohim përmbledhjen ku
2 lexon:

3 "Sekretari u tha kryesisë së shqiptarëve të Kosovës se
4 ata duhet të riparojnë dëmin që kanë shkaktuar duke kërkuar
5 lëshime të reja nga ministrat e Grupit të Kontaktit ose të
6 pranojnë përgjegjësinë për dështimin e bisedimeve. Nëse
7 anëtarët e kryesisë nuk janë në gjendje të udhëheqin
8 delegacionin e tyre për ta çuar atë për të pranuar tekstin
9 aktual, Sekretarja do të detyrohet të arrijë në përfundimin se
10 ata nuk janë seriozë për sa i takon pages apo garancive të
11 sigurisë ushtarake ndërkombëtare. Ajo sugjeroi, se kryesia
12 pranoi -- ajo sugjeroi dhe kryesia pranoi një strategji për të
13 arritur në një pranim përfundimtar të tekstit nga mesnata në
14 datën 21 shkurt", që është po të njëjtën ditë. "Sekretarja
15 hodhi poshtë kritikën e shqiptarëve të Kosovës të tekstit dhe
16 ambasadori Hill tha, paralajmëroi se gjuha apo termat e
17 përdorur për referendum nuk ishin të mirëpritur."

18 Në qoftë se ndalojmë këtu për një çast. A mund të na
19 thoni bazuar në këtë përmbledhje, nëse ju kujtohet, cilat
20 ishin diskutimet, për çfarë diskutohej dhe çfarë po ndodhte?

21 PË. Po. Diskutimi ishte, mendoj, kishte të bënte me
22 perceptimin publik që ne merrnim për grupet, pra, që thonin që
23 pranonin këtë pas deklaratës së UÇK-së që sugjeronte se ata
24 nuk ishin dakord me këtë dhe ky ishte ministri i punëve të
25 jashtme italian, z. Dini, i cili tha, "Prisni një sekondë,

1 amerikanë, ju na thatë ne që ata po e pranonin këtë". Ju na
2 thatë neve që po arrinit të merrnit miratimin e tyre. Dhe pra,
3 në këtë mënyrë UÇK-ja duke bërë deklaratë në kuptimin që - në
4 kuptimin që nuk kishin pranuar asgjë, krijoi një rrethanë
5 sikurse ne nuk ishim të sigurtë dhe të hapur me aleatët tonë.

6 Dhe, për rrjedhojë, mendoj që Sekretarja Albright po e
7 lexonte këtë tekst atyre dhe u tha atyre, "Nuk mund të
8 lëvizim, të ecim përpara me këto lloj gjërash. Ju UÇK-ja duhet
9 të rregullonim këto çështje". Dhe mendoj që ndërhyrja ime
10 ishte se shumë njerëz ishin skeptikë me idenë e organizimit të
11 një referendumi sepse quhet referendum. Në Ballkan do të ishte
12 thjesht një census. Unë e dija që çdo shqiptar do votonte në
13 njërin anë dhe çdo serb do të votonte në anën e kundër dhe kjo
14 do të përcaktonte pastaj të ardhmen e Kosovës dhe të gjithë e
15 dinin se çka duhet të thoshte kjo gjë. Kjo është një prej
16 arsyes se pse serbët nuk do të vazhdonin më tej me Rambujenë,
17 se pse nuk do ta pranojnë atë, sepse përfshinte fjalën
18 referendume aty apo organizimin e referendumit.

19 Por pastaj për neve që të dilnim me gjuhën e referendumit
20 e bëri këtë edhe më të vështirë për të patur aleatë, partnerët
21 tanë dhe aleatët që të na mbështesnin ne në atë që po bënim.
22 Ne nuk donim këtë situatë dhe Ministri i Jashtëm Dini e
23 sugjeroi, ishte diçka që shkonte në favor të pavarësisë së
24 Kosovës.

25 PY. Kalojmë hap pas hapi lidhur me atë që ndodhi dhe më thoni

1 në qoftë se ua lexoj gabim, po këtu në këtë tekst duket sikur
2 thuhet që delegacioni i Kosovës kërkonte lëshime të reja dhe
3 ju po paralajmëroni se gjuha lidhur me referendumin nuk do të
4 përfshihej në tekst.

5 PË. Po.

6 PY. Në këtë pikë të negociatave e kam fjalën.

7 PË. Në këtë pikë të negociatave ky ishte premtim, ishte një
8 premtim për referendum por jo teksti i referendumit.

9 PY. Vazhdojmë më tej.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se kalojmë në faqen në
11 vijim që ju tregua nga Gjykatësi Mettraux, DHT05129, ju lutem.

12 PY. Dhe këtu paragrafi 11:

13 "Ambasadori Hill shtoi se kërkesat e momentit të fundit,
14 në minutë të fundit nga kryesia e bindën Grupin e Kontaktit në
15 nivelet më të larta se Shtetet e Bashkuara nuk ishin të
16 ndershme me ta dhe se Shtetet e Bashkuara po manovronin Grupin
17 e Kontaktit për të pranuar një "po" boshe nga shqiptarët të
18 pavlerë me qëllim që të vazhdonin më tej me bombardimet
19 ajrore, ushtarake kundër serbëve."

20 Dhe në qoftë se kalojmë në paragrafin 12:

21 "Ambasadori Hill kërkoi shpjegim për komunikatën 31 të
22 UÇK-së të cilën ministri i Punëve të Jashtme Italiane, Dini e
23 lexoi gjatë takimit të ministrave dhe ku thoshte që UÇK-ja nuk
24 i mbështeste përpjekjet në Rambuje. Përfaqësuesi i UÇK-së,
25 Thaçi, deklaroi se cilado qoftë marrëveshja që arrihej në

1 Rambuje që detyronte UÇK-në dhe për ta zbatuar atë, ata do ta
2 respektonin në Kosovë. Thaçi tha, "Unë e garantoj këtë. Kam
3 pushtetin për ta bërë një gjë të tillë". Hill u përgjigj se
4 kjo ishte e rëndësishme të thuhej për të rifituar, për të
5 ndihmuar për të rifituar besimin e Grupit të Kontaktit."

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe në qoftë se kalojmë në
7 paragrafin 17 të këtij dokumenti përpara se të kthehemi në
8 paragrafin paraparak.

9 PY. Pra, 17 qëndrimi i z. Thaçi:

10 "Përfaqësuesi i UÇK-së, z. Thaçi përsëriti se ishte e
11 drejta e delegacionit të kërkonte një gjuhë lidhur me
12 referendumin pas tre vjetësh, pas një periudhe tre vjeçare.
13 Edhe pse kërkesa për referendum kishte krijuar reagim negativ
14 tek negociatorët e grupit, te Grupi i Kontaktit, megjithatë,
15 shqiptarët e Kosovës e ndien që duhet që të paktën të merrej
16 parasysh kjo kërkesë. Thaçi mbrojti pozicionin e tij,
17 qëndrimin e tij duke deklaruar se referendumi i garantuar do
18 t'i jepte fund gjakderdhjes në Kosovë dhe siguroi Sekretaren
19 se referendumi do të pasqyronte në mënyrë të saktë edhe
20 përfaqësonte pjesëtarët e komunitetit jo shqiptarë në Kosovë.
21 Thaçi e quajti referendumin 'çelësi i Rambujesë.'"

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani kalojmë në paragrafin
23 paraparak.

24 PY. A mund të na ndihmoni të kuptojmë fjalinë:

25 "Thaçi tha 'E garantoj këtë. Kam pushtetin për ta bërë'."

1 Çfarë mund të garantonte dhe çfarë po kërkonte ai në atë
2 kohë sipas jush?

3 PË. Mendoj që ai po përpiqej të na siguronte neve që mund të
4 fliste në emër të UÇK-së dhe që të mos shqetësoheshim për
5 zërat që shprehshin qëndrime të ndryshme në UÇK. Nuk më
6 kujtohej të kem menduar se ai mund ta bënte një gjë të tillë,
7 problemi për neve ishte akoma aty. Ne kishim problem që të
8 bindnim aleatët tonë se UÇK-ja ishte serioze lidhur me sa i
9 takon Rambujesë.

10 Dhe kur u paraqit kjo çështje ajo tregoi, nxori në pah
11 tek partnerët tanë dhe aleatët se ne kishim një problem.

12 PY. Nëse marrëveshja përfshinte referendumin për pavarësi,
13 siç e kërkonte Thaçi --

14 PË. Po.

15 PY. -- a menduat ju që ai mund të përfaqësonte UÇK-në lidhur
16 me këtë pikë?

17 PË. Jim O'Brien, i cili ishte jurist i Departamentit të
18 shtetit dhe punonte drejtpërdrejt me Madeleine Albright,
19 kishte përfshirë faktin e referendumit, vullnetin e popullit
20 në Rambuje, jo tekstin e tij, por faktin se do të ishte një
21 tekst përfundimtar në Rambuje dhe një referencë lidhur me këtë
22 qëndrim të Kosovës ku duhej të përcaktohej vullneti i
23 popullit. Pra, ishte aty.

24 Partnerët tanë diplomatikë patën përshtypjen që kjo e
25 bënte të pamundur që Serbia të pranonte një gjë të tillë sepse

1 serbët e kuptuan se referendumi thjesht do të thoshte që ata
2 do të bëheshin të pavarur dhe ata nuk ishin gati ta pranonin
3 një gjë të tillë, serbët pra.

4 Ideja nuk ishte që të mos ishim shumë të qartë dhe të
5 shprehur lidhur me këtë me një tekst ku përfshihej
6 referendumi.

7 PY. A mund të shohim reagimin e Thaçit lidhur me faktin që
8 nuk do të kishte referencë të qartë dhe shprehimisht të qartë
9 aty?

10 PË. Po.

11 PY. Në tekst thuhet --

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe mund të kalojmë tek provat e
13 tjera, lista e materialeve që janë lëshuar, prova materiale
14 12282 që është një kabllogram i të njëjtës ditë në orën 4.00
15 pasdite, po të njëjtës ditë.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Është nga delegacioni i Shteteve
17 të Bashkuara në Uashington?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Do t'ju tregoj faqen kryesore dhe
19 pastaj mund do ju bëj pyetje që ta kuptojmë më mirë.

20 Kabllogrami mban datën siç e shihni 25 shkurt dhe raporton
21 lidhur me një takim - në qoftë se shkojmë më poshtë - i datës
22 20 shkurt. Kalojmë në faqen tjetër, së pari mund të shohim ku
23 dërgohet ky kabllogram dhe pastaj më thoni ju që të kthej
24 faqen.

25 PË. Në rregull.

1 PY. Në qoftë se kthejmë fagen dhe kalojmë në paragrafin 2,
2 shohim datën dhe orën e takimit për të cilin raportohet në
3 këtë kabllogram.

4 PË. Në rregull.

5 PY. Pra, kjo është dy orë e gjysëm pas takimit, fillimit të
6 takimit të parë.

7 Dhe kalojmë në fagen tjetër, paragrafi 4, në përmbledhje
8 thuhet:

9 "Sekretarja kërkoi një vendim nga delegacioni shqiptar
10 deri në orën 4.30 atë pasdite lidhur me faktin nëse ata
11 pajtoheshin me propozimin për një zgjidhje të përkohshme.
12 Shqiptarët nuk u angazhuan që të jepnin një përgjigje të
13 tillë."

14 Kalojmë në poshtë në faqe ku shohim qëndrimin e z. Thaçi:

15 "Thaçi: Vazhdon të këmbëngul për referendum."

16 Dhe aty thotë:

17 "Thaçi kërkoi ndjesë për harxhimin e kohës, humbjen e
18 kohës së Grupit të Kontaktit, por delegacioni shqiptar duhej
19 të merrte vendime të rëndësishme që nuk duhej të nxitoreshin.
20 Ai shpresonte që Shtetet e Bashkuara do ta kuptonin këtë
21 vonesë. Delegacioni shqiptar ishte dhe do të ishte gjithmonë,
22 ka qenë dhe do të jetë gjithmonë me Shtetet e Bashkuara.
23 Megjithatë populli i Kosovës duhet të jetë në gjendje të
24 shprehë gjykimin e tyre lidhur me statusin pas përfundimit të
25 skadimit të periudhës së përkohshme tre vjeçare."

1 Tani kalojmë në paragrafin 9, që është çështje për të
2 cilën po diskutonim tani:

3 "Sekretarja nënvijëzoi faktin se ky dokument që po
4 shqyrtohej nga delegacioni nuk e përjashtonte këtë të drejtë.
5 Ambasadori Hill ishte gati të bënte një letër, të nxirrte një
6 letër publike ku konfirmohej e drejta e popullit të Kosovës
7 për të organizuar një referendum pas periudhës tre vjeçare.
8 Thaçi mbështeti letrën e Ambasadorit Hill që kërkoi që ajo
9 letra e Ambasadorit Hill të bëhej publike por jo letër
10 zyrtare. Në qoftë se nuk ishte letër zyrtare nuk do të kishte
11 peshë."

12 Tani, ju kujtohet, ju freskon kujtesën kjo lidhur me
13 diskutimin që po ndodhte?

14 PË. Po, po. Natyrisht Thaçi kishte vështirësi që të bënte që
15 kjo të pranohej nga njerëzit e tij kjo çështje. Si dhe
16 negociatorë të tjerë nganjëherë mendon që e ke arritur një
17 marrëveshje dhe flet me personat në shtëpi pastaj thua "Çfarë?
18 Kjo është e tmerrshme. Kthehu atje dhe thuaji atyre që është e
19 papranueshme". Kjo ndodh gjatë gjithë kohës me negociatorët,
20 për ata që veprojnë si negociatorë.

21 PY. Në rregull. Për të përfunduar me këtë, kjo ka ndodhur,
22 pra, 30 minuta më vonë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe në qoftë se kalojmë tek prova
24 materiale 12359 dhe kjo në listën e materialeve të reja.

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Është interesante që thuhet "letër

1 publike" për kundër "letër zyrtarëve". Kjo është një lloj
2 burokracie që s'ka ndonjë rëndësi të madhe dhe që nuk e kuptoj
3 mirë fare biles.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do t'ju tregoj një letër në
5 faqen kryesore siç e shihni të dokumentit që përmenda dhe
6 kalojmë pak më poshtë.

7 PY. Dhe aty shohim në pikën 2 raportohet takimi i orës 4.30 i
8 po të njëjtës ditë --

9 PË. Po.

10 PY. -- takimi në kështjellë. Dhe siç e shihni anëtarët e
11 Grupit të Kontaktit ishin aty ashtu si dhe delegacioni.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe kalojmë në faqen tjetër,
13 paragrafi 8.

14 PY. Ku thuhet:

15 "Kryesia e delegacionit të Kosovës (Hashim Thaçi, Rexhep
16 Qosja, Ibrahim Rugova) plus Veton Surroi hynë në dhomë,
17 Ministri i Jashtëm Vedrine iu bëri pyetje të dyve duke
18 konstatuar, duke thënë që, duke theksuar se pyetja 2 nuk ishte
19 detyruese për rusët, çështja e dytë nuk ishte e detyrueshme
20 për rusët. Thaçi iu përgjigj pyetjes së parë lidhur me
21 kornizën dhe zgjidhjen politike duke thënë, duke deklaruar se
22 ne nuk themi jo, 'por në të njëjtën kohë duke këmbëngulur për
23 të drejtën përfundimtare të popullit të Kosovës për t'u
24 shprehur. Ne po kërkojmë të drejtën për referendum'. Dini e
25 pyeti se çfarë do të thoshte kjo? Dhe Thaçi tha se ishin të

1 përgatitur të thonin po, por vetëm pasi nëse pas periudhës së
2 përkohshme atyre do t'ju pranohej e drejta në mënyrë të qartë
3 për të organizuar referendumin. E drejta për vetëvendosje të
4 përfshihej në marrëveshje.

5 PË. Po.

6 PY. E saktë? Pra, ajo që Thaçi kërkon këtu, siç e kuptoni ju,
7 është në përputhje me atë që kishte kërkuar, që kërkohej nga
8 Kosova?

9 PË. Po, është situatë klasike e një negociatori që është aty
10 dhe përpiqet të argumentojë dhe që në të njëjtën kohë shtyhet
11 nga njerëzit në shtëpi.

12 PY. Po. Faleminderit. Tani kalojmë tek një temë tjetër që
13 ngriti Gjykatësi Mettraux me ju që është -- ka të bëjë me
14 takimin kur është bërë takimi me z. Milosheviq ku ai përmendi
15 z. Thaçi, dhe do të doja thjesht që t'ju rifreskoj kujtesën e
16 ndoshta të përcaktojmë datën aty dhe do të shkojmë në mënyrë
17 kronologjike për diçka që e keni parë dy herë dhe që është
18 publikuar nga Shërbimi i Hulumtimeve të Kongresit.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në dokumentin DHT02858
20 deri në DHT02880, ju lutem, në listën e dokumenteve që kemi
21 paraqitur fillimisht. Prova materiale 123810. Më thonë --

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] -- DHT02872, ju lutem. Kalojmë
24 poshtë, data 16 shkurt.

25 PY. Tani në mes të bisedimeve, midis bisedimeve të Rambujesë

1 thuhet:

2 "I dërguari i Shteteve të Bashkuara, Christopher Hill
3 shkoi me aeroplan në Beograd për t'u takuar me presidentin
4 jugosllav Milosheviq në një përpjekje për të bërë përparime
5 lidhur me çështjen e pranisë së trupave paqeruajtëse të NATO-
6 s. Milosheviqi vazhdoi të refuzonte pranimin e vendosjes së
7 trupave të NATO-s në tokën jugosllave. Në Uashington,
8 Sekretarja e Shtetit Albright e quajti këtë qëndrim 'prishës i
9 marrëveshjes' dhe paralajmëroi se pas kësaj do të vinin
10 'bombardimet e NATO-s'."

11 Dhe në qoftë se mund t'ju rifreskoj kujtesën pak më tej
12 me artikull gazete që kemi gjetur të takimit tuaj, lidhur me
13 takimin tuaj në këtë rast dhe atë që keni diskutuar.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Do kërkoja të shfaqim në ekran në
15 listën e dokumenteve të reja DHT12579 deri në DHT12594.
16 PY. Dhe, siç e shihni, këtu kemi disa raporte të shtypit nga
17 Shërbimi i Drejtësisë Ndërkombëtare dhe artikuj të tjerë
18 gazetash.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen DHT12585, ju
20 lutem.

21 PY. Këtu flitet për takimin e shkurtit 1999. Dhe lexon:

22 "Hill udhëtoi të mërkurën me përfaqësuesit britanikë dhe
23 francezë dhe negociatorin serb Nikola Sainovic për t'u takuar
24 me Milosheviqin. Zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, James
25 Foley, tha të mërkurën se Hill 'transmetoi mesazhin shumë të

1 qartë presidentit Milosheviq ... që të pranonte kushtet tani'
2 nën kërcënimin e bombardimeve ajrore të NATO-s."

3 Dhe:

4 "Agjencia e shtypit *France Presse* raportoi më 17 shkurt
5 'se një burim diplomatik afër konferencës së Rambujesë kishte
6 thënë ... se 'bisedimet zgjatën vetëm katër orë.'"

7 Që t'ju japim pak kohë edhe përkthyesve.

8 PË. Kjo është ora e Londrës?

9 PY. Po, për të qetësuar Wolfgang Petritsch lidhur me
10 shqetësimet që kishte për këtë udhëtim.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, ndërkohë që ju
12 lexoni a mund ta pyesni dëshmitarin në qoftë se bëhet fjalë
13 për të njëjtin takim?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Këtu po arrija dhe unë.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull. E kuptova.

17 Z. MISETIC: [Përkthim]

18 PY. Së pari, a ju kujtohet që keni vizituar Milosheviqin,
19 keni bërë vizitë, keni takuar Milohseviqin në Beograd gjatë
20 bisedimeve në Rambuje?

21 PË. Po, më kujtohet që kam shkuar dy herë. E kam vështirë të
22 kujtoj se kam qenë i shoqëruar nga britanikët dhe francezët
23 dhe më kujtohet që jam shoqëruar nga britanikë dhe francezë
24 por jo nga negociatori i BE-së. Jam i habitur që thotë këtu që
25 Wolfgang Petritsch po vraponte drejt aeroplanit në pistën e

1 ngritjes. Se kështu duket. Çdo negociatë ka probleme, por nuk
2 mendoj që kjo ka qenë mungesë, që këtu ka patur mungesë
3 organizimi.

4 PY. Në rregull. Pyetja ime është dhe Gjykatësi Mettraux jua
5 bëri nëse Milosheviqi -- ose nëse ju e dinit se kush ishte
6 Thaçi në këtë takim me Milosheviqin, ku në takim kur
7 Milosheviqi e quajti Thaçin një person që torturon dhe vret
8 njerëz.

9 PË. Po.

10 PY. A mund të ketë ndodhur që kjo bisedë të jetë bërë në
11 shkurt?

12 PË. Absolutisht e mundshme që të jetë bërë aty. Mendova që
13 kishte ndodhur më herët, por mund të jetë dhe në këtë datë.
14 Nuk e di nëse Milosheviqi thjesht shqetësohej sepse ne po
15 anonim më shumë drejt UÇK-së dhe jo LDK-së dhe ai ishte i
16 shqetësuar për këtë në fakt. Kishte bërë komente të ngjashme
17 pas takimit në Junik ku Holbrooke ishte parë në atë
18 fotografinë që pastaj u shfaq në mediat nëpër gjithë botën i
19 ulur afër atij personi që dukej si Che Guevara dhe ku pastaj
20 kjo gjë dëmtonte tërësisht Rugovën.

21 PY. E kuptoj.

22 PË. Ky ishte shqetësimi i tij i vazhdueshëm në një farë
23 mënyre, por ne e dinim që për të organizuar Rambujenë duhej që
24 t'i grumbullonim të gjithë, të gjithë të ishin së bashku.

25 PY. Faleminderit. Tani do të kaloj tek pyetjet që ju bëri

1 Gjykatësi Gaynor.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të kalojmë tek kabllogrami që
3 u tregoi ai, i pari është prova materiale P1067.

4 PY. Siç e shihni, kjo është e datës 3 nëntor dhe dua t'ju bëj
5 disa pyetje lidhur me të.

6 PË. Në rregull.

7 PY. Dua të kalojmë tek faqja e parë fillimisht.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Pak më poshtë.

9 PY. Numër 2, aty lexon:

10 "Pjesa në vijim është një version i redaktuar" -- jo i
11 redaktuar, "në fakt është një vlerësim i redaktuar lehtë i
12 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i përgatitur në bazë të
13 kërkesës së COM nga komandanti i Shtetet e Bashkuara të
14 Amerikës CDOM, udhëheqësit të ekipit që është një vëzhgues
15 politiko-ushtarak me përvojë. Në interes të kohës, ky raport
16 nuk është miratuar nga seksioni i departamenti -- nga
17 përfaqësuesit e departamentit të ambasadës apo agjencisë që
18 ndjek çështjet e Kosovës."

19 PË. Jo nga unë, unë nuk e kam miratuar.

20 PY. Fjalia e dytë, kjo fjalia e dytë a ka ndonjë ndikim në
21 mënyrën sesi raporti është interpretuar?

22 PË. Mendoj se ambasada në Beograd përpigëj të jap sinjal këtu
23 se të thojë që ky vjen nga një burim pa verifikim, burim i
24 paverifikuar. Verifikimet janë elementë madhorë në Qeverinë e
25 Shteteve të Bashkuara. Kjo është arsyeja sepse çdo kabllogram

1 duket si petition sepse ka gjithmonë 15 zyra që duhet ta
2 shikojnë, duhet të shikojnë një gjë apo një tjetër. Edhe këtu
3 ka pasur disa prej tyre.

4 PY. Tani, Gjykatësi Gaynor ju pyeti duke ju thënë që kjo ka
5 ndodhur tre ditë përpara takimit tuaj të 6 nëntorit me z.

6 Thaçi. A ju kujtohet kjo?

7 PË. Më kujtohet.

8 PY. Asgjë në këtë kabllogram nuk sugjeron, nuk lë të mendoj
9 se Shaun Byrnes ka patur ndonjë informacion se z. Thaçi ishte
10 përfshirë në shkelje të të drejtave të njeriut në kohën kur
11 është bërë ky kabllogram, është kështu?

12 PË. Kështu.

13 PY. Edhe mesa ju kuptova unë në dëshminë tuaj më herët, ai
14 nuk ju ka, -- Shaun nuk ju ka informuar juve paraprakisht
15 përpara takimit të datës 6 nëntor lidhur me ndonjë shkelje të
16 drejtave të njeriut në të cilat ishte përfshirë z. Thaçi?

17 PË. Jo, me aq sa më kujtohet jo. Mund të më ketë kërkuar që
18 të ndihmoj të theksojmë se ne nuk duam të ndaluar, persona të
19 ndaluar.

20 PY. Në rregull. Këtë e thatë më herët që nuk ju kujtohet
21 ndonjë diskutim i kësaj gjëje gjatë takimit.

22 PË. Nuk më kujtohet.

23 PY. Në rregull.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani kalojmë tek faqja tjetër e
25 kabllogramit që u tregua nga Gjykatësi Gaynor që është prova

1 materiale P1069, ju lutem.

2 PY. Ky është kabllogrami i 18 dhjetorit që Gjykatësi Gaynor
3 ju tregoi në lidhje me disa pohime të bëra nga z. Byrnes
4 lidhur me z. Thaçi. Ju kërkuat datën e kabllogramit dhe u tha
5 juve se data e kabllogramit është 18 dhjetori që është data
6 aty.

7 Këto komente lidhur sa u përket personave ushtarakë që
8 trajtonin me respekt, i drejtoheshin me respekt z. Thaçi a
9 pajtoheni që këto janë bërë nga z. Byrnes në takimin me z.
10 Thaçi të pranishëm?

11 PË. Po.

12 PY. Në rregull.

13 PË. Ishte e paqartë për mua se nga vinte kjo, me thënë të
14 drejtën.

15 PY. Besoj se ju e njihni, e dini që z. Byrnes ka dëshmuar në
16 këtë proces?

17 PË. Besoj që e di, dikush më ka thënë që e ka parë, kjo ka
18 ndodhur para shumë kohësh, po nuk e di.

19 PY. Arsyeja që po ju pyes është relevante për ju konkretisht.
20 Ai ka dëshmuar se është takuar me z. Thaçi më pak se pesë
21 herë, për një periudhë dy javore nga fundi i tetorit në fillim
22 të nëntorit. Po ju jap kontekstin sepse në këto takime mund të
23 keni qenë i pranishëm në ndonjërin prej tyre më 6 nëntor?

24 PË. Po.

25 PY. E kuptoni?

1 PË. Po.

2 PY. Pra, ky kabllogram, lidhur me këtë kabllogram pyetja ime
3 e parë është nëse e dini nëse z. Thaçi ka qenë në Kosovë nga
4 mesi i nëntorit apo deri kur është kthyer nga Rambuje?

5 PË. Nuk më kujtohet që kam menduar nëse ai ka qenë apo nuk ka
6 qenë, thjesht nuk më kujtohet kjo gjë.

7 PY. Duke patur parasysh se është shkruar më 17 dhjetor.

8 PË. Po.

9 PY. Dëshmia e z. Byrnes është se ai ka qenë vetëm një
10 periudhë dy javore që e ka parë këtë gjë, pra, vetëm këtë
11 periudhë. Dhe unë po ju pyes tani, meqenëse keni qenë i
12 pranishëm në njërin prej takimeve, a keni bërë, keni
13 konstatuar të njëjtat gjëra lidhur me personat ushtarakë që
14 trajtojnë Taçin me respekt?

15 Z. PACE: [Përkthim] Përpara se dëshmitari të përgjigjet a
16 mund të sqarojë dëshmitarin nëse bëhet fjalë për të gjithë
17 takimet që janë bërë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të tjerë.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Bëhet fjalë për periudhën e
20 aktakuzës.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjithë
22 periudha e aktakuzës.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, besoj se ka qenë vera. Ai
24 është takuar në Rambuje dhe po flasim për periudhën përpara
25 Rambujesë, periudha përpara Rambujesë dhe gjithë takimet që

1 janë bërë.

2 Z. PACE: [Përkthim] Lidhur me këtë dua të paraqiten
3 provat dhe mendoj që avokati duhet të ketë njohuri për
4 gjithçka që është thënë apo bërë dhe t'i vejë këto gjëra në
5 listën e dokumenteve që përdoren në këtë gjykim, duhet të jetë
6 gjithçka konkrete.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 Z. PACE: [Përkthim] Ne nuk po themi ndonjë gjë nga z.
9 Byrnes. Kjo është a po i kujtohet gabim ose po paraqet në
10 mënyrë të gabuar dëshminë e z. Byrnes. Pra, na duhet bazë për
11 këto pyetje që po bëni.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Është në paragrafin 71 të
13 intervistës së z. Byrnes.

14 Z. PACE: [Përkthim] Nëse është ashtu është në listën e
15 provave, dokumenteve tuaja.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka nevojë që të jetë aty.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.
18 Keni mundësi që t'i bëni pyetje ju vetë z. Pace.

19 Z. MISETIC: [Përkthim]

20 PY. Pyetja për juve është: Në konstatimet apo komentet që
21 janë aty të paktën në pjesë, a bazohen ato në të paktën njërin
22 prej takimeve ku ju keni qenë i pranishëm? Dhe kjo është
23 arsyeja që po ju pyes. Pra, a mund të shpjegoni me fjalët e
24 tua cila ishte dinamika që ju keni parë apo s'keni parë midis
25 Thaçit dhe personit që u identifikua nga z. Pace në marrjen në

1 pyetje si komandant Çeliku, cila ishte dinamika mes këtyre
2 dyve?

3 PË. Ky është personi që mbante armën?

4 PY. Po, saktë. Çfarë keni parë ju?

5 PË. Bashkëbiseduesi im kryesor në këtë takim ishte z. Thaçi.

6 Të tjerët nuk folën me aq sa më kujtohet nuk më kujtohet

7 ndonjë ndërveprim midis z. Thaçi dhe të tjerëve që do

8 sugjeronte ndonjë rol hierarkik për Thaçin apo të tjerët.

9 Thaçi u ul aty, ai kishte disa fletore me vete, u ul, këmbët
10 këmbë mbi këmbë dhe më kujtohet shumë mirë kur filluam të
11 bisedojmë. Nuk më kujtohet ndonjë urdhër, nuk më kujtohet që
12 dikush ka thënë diçka diku se çfarë të bënte.

13 PY. Në rregull. Dhe, për në fund, sa i takon pyetjes së

14 Gjykatësi Barthe si e shpjegoni që z. Thaçi mund të ketë

15 arritur disa pozita të caktuara përfshirë pozitën si

16 kryeministër në Qeverinë e Përkohshme, pyetja ime për juve

17 është: Ndërveprimet e z. Thaçi me Shtetet e Bashkuara në

18 Rambuje bazuar në këtë a e dini nëse kjo gjë ka patur ndikim
19 në profilin e tij?

20 PË. Besoj që kjo ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë z. Thaçi.

21 Por për sa i takon asaj që ka ndodhur më vonë, dikush tjetër

22 mund të përgjigjet për këtë. Por me atë sa e kam parë unë, kjo

23 e ka ndihmuar jashtë mase atë dhe ai u bë personi që dukej që

24 ishte më i afërt me neve.

25 PY. Ambasadori Hill ju pretoj që kjo ishte hera e fundit që

1 do të dëgjoni nga unë në këtë sallë gjyqi. Ju falënderoj
2 përsëri për praninë tuaj dhe kohën tuaj. Me këtë përfundoj
3 pyetjet tuaja. Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë pyetje
5 tjetër.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit. Kemi vetëm një çështje
7 të vogël që dua të trajtoj që doli nga pyetjet e bëra.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju nuk keni
9 marrë pjesë në këtë.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Më lejo të bëj pyetje që dalin nga
11 pyetjet e Gjykatësve. Dhe nuk është marrje në pyetje, është
12 thjesht pyetje që kanë dalë nga këto pyetje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

14 Z. DIXON: [Përkthim] Vetëm një çështje të vogël dhe do të
15 përfundojmë shpejt. Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

16 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

17 Z. DIXON: [Përkthim]

18 PY. Z. Ambasador Hill, desha t'ju bëj një pyetje lidhur me
19 pyetjen që iu bë juve nga Gjykatësi Mettraux më herët ku ai ju
20 pyeti për periudhën pas bisedimeve të Rambujesë, por përpara
21 nënshkrimit të datës 18 mars, pra, kjo periudhë e qetë, ku nuk
22 pati zhvillime. Dhe do t'ju lexoj pyetjen që në një mënyrë që
23 të keni kontekstin e plotë. Gjykatësi Mettraux ju tha:

24 "A e dini ku shkuan z. Thaçi, z. Krasniqi dhe z. Veseli
25 nga Franca në atë kohë pas raundit të parë të bisedimeve?"

1 Dhe përgjigja juaj ishte:

2 "Nuk e di. Më kujtohet që ata udhëtuan në një aeroplan
3 francez. Mendoj se kanë shkuar në Shkup, por mund mendoj që në
4 fakt kanë shkuar në Prishtinë. Thjesht e mora vesh këtë këtu
5 në Hagë, dje apo pardje. Por kanë shkuar në vende të
6 ndryshme."

7 Dhe tani pyetja ime është: Duke patur parasysh atë që i
8 thatë dje z. Pace që përfaqëson ZPS-në lidhur me Kadri
9 Veselin, ju thatë që nuk ju kujtohet se në çfarë konteksti ju
10 kishit dëgjuar emrin e tij apo me çfarë merrej ai. Duke pasur
11 parasysh këtë që thatë në dëshminë tuaj, a është e saktë se
12 për sa i takon periudhës së qetë për të cilën ju u pyetët nga
13 Gjykatësi, juve nuk ju kujtohet asgjë lidhur me z. Veseli me
14 faktin që ku ishte ai, ku ka udhëtuar dhe aq më pak se me kë
15 ka qenë?

16 PË. Nuk më kujtohet cili ka qenë rrugëtimi i tij apo programi
17 i punës së tij, agjenda e tij. Mund të them si koment i
18 përgjithshëm që e gjitha kjo ka qenë pjesë kur këta njerëz u
19 shpërndanë nga aeroplani në Prishtinë, që dolën nga aeroplani.
20 Të gjithë kishin bënë konsultime dhe më vonë mësova se z.
21 Thaçi kishte shkuar në Shqipëri edhe pse u përpoqëm të
22 verifikonim me ambasadën tonë në Shqipëri ne nuk gjetëm ndonjë
23 informacion.

24 Pra, është e drejtë të themi që ne prisnim që të gjithë
25 ata të shkonin dhe të shpërndanin, bashkëdanin këtë opinion

1 dhe kjo ka ndodhur dhe në momentin kur u rimblodhën ndjenja
2 ishte pozitive për Rambujenë siç ishte më pozitive ditën më
3 përpara.

4 PY. Lidhur me emrin e Kadri Veselit, a është e vërtetë që
5 juve nuk ju kujtohet fare se ku ka qenë, ku ka shkuar?

6 PË. Po, saktë. Megjithatë, dua të theksoj diçka. Kanë kaluar
7 26, 27 vite keni parasysh. Edhe unë jam asokohe përpjekur të
8 merrja një po nga të gjitha palët për çështjen e autonomisë.
9 Kjo ka qenë detyra ime.

10 PY. Faleminderit. Kaq pyetje kisha.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

13 Faleminderit, z. Ambasador.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuroria.

15 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ambasadori

17 Hill, mbaroi dëshmia juaj. Faleminderit që erdhët.

18 Faleminderit që ndatë informatat që kishit. Faleminderit që
19 respektuat rregullat e sallës së gjyqit. Dhe ju urojmë gjithë
20 të mirat në të ardhmen.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit. Ishte një përvojë e
22 veçantë më duhet të them.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Po

24 shpresojmë të mos ketë qenë përvojë e keqe.

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Kam pas përvoja më të këqija.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
2 dhe ditën e mbarë.

3 [Dëshmitari largohet]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse jeni
7 dakord, do fillojmë në orën 2.00 me dëshmitarin tjetër.

8 Edhe faleminderit edhe përfaqësueses së ambasadës
9 amerikane. Faleminderit që na ndihmuar kur kishim nevojë. Nuk
10 e di nëse do të jeni ju javën tjetër, nëse po, do të shihemi
11 javën tjetër atëherë.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Për ne nuk ka problem. Po Zyra e
13 Mbrojtjes së Dëshmitarëve na tha që ai do të vijë në orën 1.00
14 dhe ka nevojë për një orë që të përgatitet.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po në
16 rregull. Do vijë në 1.00, do e bëjë dhe një orë, në 2.00 duhet
17 të jemi gati për të filluar.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, thjesht ua thashë këtë që të
19 keni parasysh se si është procedura.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

21 Takohemi në orën 2.00 atëherë. Faleminderit për
22 pjesëmarrjen.

23 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.39

24 --- Seanca rifillon në orën 14.02

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z.

1 Misetic.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Dërguam një
3 email sot paradite për dëshmitarin e javës tjetër. Sa më
4 shpejt të vendosni aq më mirë do të ishte.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
6 [Përkthim] Sekretare e seancës, paraqisni lëndën, ju lutem.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Kjo është
8 lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjithë të
11 akuzuarit janë të pranishëm në sallën e gjyqit.

12 Do të fillojmë tani me dëshminë e dëshmitarit të
13 Mbrojtjes me numër 1D009.

14 Uroj që të më zgjasi zëri deri në fund të seancës.

15 Ka disa aspekte në fakt që dua të trajtoj përpara se të
16 sjellin dëshmitarin në sallë.

17 Trupi Gjykses mban parasysh emalin që ka dërguar Mbrojtja
18 e z. Thaçi për planifikimin e dëshmitarit 007 të hënën, më 17
19 nëntor 2025, ku ka kërkuar që të fillojë në mesditë në orën
20 12.00, edhe të shtyhet Konferenca për Ecurinë e Çështjes për
21 pas Përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit në fjalë.

22 Ka ndonjë kundërshtim nga palët dhe pjesëmarrës lidhur me
23 dëshmitarin dhe me Konferencën për Ecurinë e Çështjes?

24 Mbrojtja? Ndonjë prej Mbrojtjes ka kundërshtim?

25 Jo, në rregull.

1 Z. Laws, ju?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duke mbajtur
4 parasysh parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve, Trupi
5 Gjykses atëherë përshtat kalendarin për javën tjetër si në
6 vijim: Dëshmitari 007 do të fillojë dëshminë të hënën, më 17
7 nëntor 2025 në orën 12.00 të mesditës. Pasi të përfundojë
8 dëshminë dëshmitari 007, do të mbahet një konferencë për
9 ecurinë e çështjes të mërkurën, më 19 nëntor 2025. Gjithashtu,
10 Trupi Gjykses liron ditën në sallën e gjyqit që ishte
11 parashikuar për 21 nëntor 2025.

12 Trupi Gjykses më tej do të lëshojë katër urdhra me gojë.

13 Së pari, Mbrojtja e Thaçit ka kërkuar leje t'i
14 kundërpërgjigjet parashtrimi F0372 që është përgjigja e ZPS-së
15 ndaj kërkesës së dytë të Mbrojtjes së Thaçit për pranimin e
16 dokumentave përmes provave jogojore.

17 Trupi Gjykses rikujton se urdhrin për rishikimin e
18 afateve për dorëzimin e mocioneve për mocione jogojore, pra,
19 përkatësisht është urdhri F03535, kishte vendosur që nuk do
20 pranoheshin kundërpërgjigje. Sidoqoftë, Trupi Gjykses mban
21 përsysh se Mbrojtja e Thaçit kërkon që t'i lejohet
22 kundërpërgjigje dhe është për çështje thjesht diskrete që ka
23 të bëjë vetëm me dy prova materiale të propozuara.

24 Më tej Trupi Gjykses mban parasysh se ZPS-ja nuk ka
25 kundërshtim për kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për t'u

1 kundërpërgjigjur.

2 Duke mbajtur parasysh fushëveprimin e kufizuar të
3 kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për t'u kundërpërgjigjur edhe
4 natyrën e provave materiale të propozuara që janë në fjalë,
5 atëherë Trupi Gjykses gjykon që është e nevojshme që të lejojë
6 parashtrimet për këto dy prova materiale. E rrjedhimisht,
7 lejon Mbrojtjen e Thaçit të bëjë parashtrime të shkurtra në
8 kundërpërgjigjen e vet.

9 Z. Misetic, mund të bëni parashtrimet nëse dëshironi.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Më falni, a mund ta bëjmë pas
11 pushimit tjetër sepse nuk kam pasur shans t'i rishikoj.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
13 pa problem.

14 Urdhri i dytë me gojë.

15 Më 20 janar 2025, Trupi Gjykses pranoi si prova gjyqësore
16 deklaratat e Dëshmitarëve të Prokurorisë 02183 dhe i dha
17 numrin P01968. Gjatë seancës ZPS-ja bëri me dije se do të
18 përgatiste një version të redaktuar publik të deklaratës në
19 fjalë.

20 ZPS-ja nxori versionin e redaktuar publik të kësaj
21 deklarate në paketën e materiale 1592.

22 Më 14 shkurt 2025, ZPS-ja dorëzoi materialin 01610-101634
23 RED PRV dhe përkthimin përkatës për të që u pranuar si provë
24 gjyqësore dhe kërkoi që të merrnin numrat përkatëse P01968.1
25 dhe P01968.1_AT.

1 A mund të konfirmoni se nuk keni kundërshtime ekipet e
2 Mbrojtjes? Mbrojtësi i Viktimave? ZPS-ja?

3 Pasi dëgjuam palët dhe pjesëmarrësit, Trupi Gjykses
4 pranon si prova gjyqësore versionin e redaktuar publik të
5 materialit P01968 dhe përkthimin përkatës dhe urdhëron që t'i
6 bashkëngjiten provës P01968 përkatëse me prapashtesën .1 dhe
7 prapashtesën .1_AT.

8 Me kaq mbyll urdhrin e dytë me gojë.

9 Urdhri i tretë.

10 Më 14 shkurt 2025, ZPS-ja kërkoi që materialet P01969,
11 01972, 975, 976, 01978 dhe 019800 -- 910, më falni, dhe
12 përkthimet përkatëse të riklasifikoheshin si publike.

13 A ka kundërshtime?

14 Mbrojtja? Mbrojtësi i viktimave? ZPS-ja?

15 Pasi dëgjuam palët dhe pjesëmarrësit, Trupi Gjykses i
16 riklasifikon materialet e sipërcituara dhe përkthimet e tyre
17 si materiale publike.

18 Me kaq mbyll urdhrin e tretë me gojë.

19 Urdhri i katër me gojë.

20 Më 14 shkurt 2025, ZPS-ja informoi Trupin Gjykses se
21 provat materialet të Mbrojtjes së Thaçit 1D00230 dhe D00233,
22 mund të riklasifikohen si publike.

23 A mund të konfirmohen se nuk ka kundërshtime?

24 Z. MİSETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ekipet e

1 Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime. Po të tjerët?

2 Atëherë nuk ka kundërshtime.

3 Pasi dëgjua palët dhe pjesëmarrësit, Trupi Gjykses e
4 riklasifikon materialin 1D00230 dhe 1D00233 bashkë me
5 përkthimet përkatëse si materiale publike.

6 Me kaq mbyll urdhrin e katërt me gojë.

7 Sekretarja e seancë kishte një korrigjim për të bërë?

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dje në
9 faqet SPOE00058041 dhe SPOE00058153 deri në 18 -- 8155 nga
10 dokumenti SPOE 00058041, që përfundon më pas me 445, u dorëzua
11 nga ZPS-ja për pranim dhe faqet përkatëse me numër
12 SPOE00058337 dhe 58338 të dorëzuara nga Mbrojtja e Thaçit u
13 pranua dhe morën numrin P04507.

14 Por ky numër prove i është dhënë një materiali tjetër më
15 2 tetor 2025 dhe përkatësit i është dhënë dokumentit me ERN
16 052690, 052841.

17 Pra ne propozojmë që dokumenti që ka marrë numrin P04507
18 më 2 tetor të mbajë numrin që i është caktuar fillimisht,
19 ndërsa faqeve që u pranuan dje, t'u jepet një numër i ri,
20 përkatësisht është numri P04508.

21 Faleminderit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
23 kundërshtime?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

1 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
3 Mettraux kishte një pyetje.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, kam një pyetje
5 për ju.

6 Tani që miratuam kërkesën tuaj për ndryshimin e
7 kalendarit për javën tjetër, kur mendoni se do ta çoni
8 shënimin përgatitor të dëshmitarit? Pra, nëse ka ndonjë shënim
9 përgatitor të mos prisni deri momentin e fundit të na e
10 dërgoni që ta lexojmë dhe të na dërgoni sa më shpejt që të
11 jetë e mundshme.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Sa i takon këtyre katër ditëve
13 duhet të keni parasysh që është e vështirë me këta dëshmitarë
14 që të kemi kohën e nevojshme për t'ju lexuar deklaratat e
15 tyre.

16 Seanca përgatitore është parashikuar për të premtën. Unë
17 mund t'ju them që do respektoj afatin prej 24 orësh, por nuk
18 mund t'ju premtoj që do e dërgojmë përpara.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë keni të
20 premtën?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Kemi seancën përgatitore me
22 dëshmitarin dhe kini dhe parasysh që kemi një diferencë kohore
23 prej shtatë orësh, që do të thotë që ne do e fillojmë punën të
24 premtën në mbrëmje me këtë dëshmitar.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po

1 interesohuni se mund ta përshpejtoni.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] i kemi bërë disa përpjekje, edhe e
3 vetmja kohë që kishte në dispozicion dëshmitari ishte kjo që
4 sapo ju thashë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 Z. PROSPER: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,
9 Dëshmitar. A më dëgjoni?

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, ju më dëgjoni mua?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, kam
12 kufjet.

13 Sekretarja e seancës do t'ju japi tekstin e betimit
14 solemn të cilin do ta citoni në përputhje me rregulloren e
15 Gjykatës. Ju lutem lexoni me zë të lartë tekstin që keni
16 përpara.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
18 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
19 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
20 vetëm të vërtetën, dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të
21 cilën kam dijeni

22 DËSHMITARI: MICHAEL DURKEE

23 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
25 Tani mund të uleni.

1 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që
2 mendohet se do të zgjasë përafërsisht dy ditë. Sikurse e dini
3 fillimisht do t'ju bëjë pyetje Mbrojtja e Thaçit, më pas mund
4 të kenë pyetjet e ekipet e tjera të Mbrojtjes. Pasi të
5 përfundojë Mbrojtja do t'ju bëjë pyetje Prokuroria si dhe
6 Gjykatësit e Trupit Gjykues mund të kenë pyetje për ju.

7 Mbrojtja e Thaçit ka parashikuar dy orë e gjysmë për
8 pyetjet e veta. Ekipet e tjera së bashku kanë kërkuar një orë
9 për t'ju bërë pyetje. Prokuroria ka kërkuar po ashtu dy orë e
10 gjysmë. Sa i takon parashikimeve kohore i lutem palëve të jenë
11 të kujdesshëm në shfrytëzimin e kohës. Trupi Gjykues mund të
12 lejojë pyetje shtesë nëse përmbushen kushtet përkatëse.

13 Dëshmitar, përgjigjuni qartë, me fjali të shkurtra. Nëse
14 nuk kuptoni një pyetje lirisht kërkon që të përsëritet
15 pyetja, ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që ta sqarojmë.
16 Gjithashtu mos harroni të na thoni bazën e njohurisë suaj për
17 faktet dhe rrethanat për të cilat ju bëjnë pyetje.

18 Në qoftë se Prokuroria ju kërkon të flisni për
19 korrigjimet që keni bërë në deklaratat tuaja, duhet të thoni
20 për procesverbal që deklaratat me shkrim, bashkë me
21 korrigjimet përkatëse pasqyrojnë saktësisht dëshminë tuaj.

22 Gjithashtu flisni pranë mikrofonit e prisni pesë sekonda
23 përpara se të përgjigjeni si dhe, ju lutem, flisni ngadalë për
24 përkthyesit që po na ndjekin.

25 Gjatë ditëve që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit nuk

1 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
2 jashtë sallës së gjyqit. Nëse dikush jashtë gjykatës ju bën
3 pyetje për dëshminë tuaj, ju lutem na e thoni menjëherë.

4 Ju lutem ndërprisni fjalën nëse ua kërkoj unë, dhe
5 gjithashtu nëse shihni që ngre dorën ndërprisni po ashtu
6 fjalën, sepse kjo do të thotë që do të jap një udhëzim.

7 Në çdo moment që keni nevojë për pushim na thoni ose
8 ngrini dorën, dhe do të bëjmë organizimin përkatës.

9 Gjithashtu në orën 3.00 do të bëjmë një pushim shumë të
10 shkurtër, vetëm dhjetë minuta pushim edhe do ta përfundojmë
11 ditën. Nëse do të kemi një ditë më të gjatë do të bëjmë një
12 pushim tjetër, megjithatë nuk presim që të ndodhë.

13 Jeni gati që të vazhdoni?

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, jam gati.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
16 fillojmë me z. Tavakoli e cila do t'ju bëjë pyetje në emër të
17 ekipit të Thaçit.

18 Pyetje nga znj. Tavakoli:

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

20 PY. Mirëdita, z. Durkee. Jemi takuar më herët. Unë quhem Nina
21 Tavakoli dhe përfaqësoj z. Hashim Thaçi.

22 Ju lutem, a mund të thoni për procesverbal emrin tuaj.

23 PË. Michael Leroy Durkee.

24 PY. Datëlindja?

25 PË. 16 gusht 1939.

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 110

1 PY. Po kombësia jua?

2 PË. E ShBA-së.

3 PY. A keni dhënë deklaratë për Mbrojtjen e Thaçit që e keni
4 nënshkruar më 27 tetor 2023?

5 PË. Po.

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të nxjerrë
7 në ekran materialin DHTW39 [Sipas përkthimit] deri në
8 DHT11742.

9 PY. Z. Durkee, a e njihni dokumentin që shihni në ekran?

10 PË. Po.

11 PY. Çfarë është?

12 PË. Është deklarata që kam përgatitur dhe dorëzuar për
13 Mbrojtjen më 2023.

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen e fundit, në
15 fundin e faqes.

16 PY. A është ky nënshkrimi jua në fund të faqes?

17 PË. Po.

18 PY. A keni pasur mundësi ta rishikonit dokumentin përpara se
19 ta nënshkruanit?

20 PË. Po.

21 PY. A e keni pasur po ashtu mundësi ta rishikonit edhe
22 njëherë javën e kaluar?

23 PË. Po.

24 PY. A jeni takuar me mua dhe kolegët e mi dy herë javën e
25 fundit përmes videolidhjes?

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 111

1 PË. Po.

2 PY. Në këto takime a ju është dhënë mundësia të bëni
3 korrigjime dhe sqarime në deklaratën tuaj?

4 PË. Po.

5 PY. A ju kujtohet që këto sqarimet dhe korrigjimet i hodhëm
6 në një shënim të cilin më pas jua lexuam ju?

7 PË. Po.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shënimi përgatitor në vijim të
9 takimit që kemi pasur së bashku është me numër DHT12570 deri
10 në DHT12573.

11 PY. Duke marrë parasysh këto korrigjime dhe sqarime që na
12 dhatë javën e kaluar dhe që i hodhëm në këtë shënim,
13 informacioni që keni dhënë në këtë deklaratë për Mbrojtjen e
14 Thaçit a është i saktë dhe i vërtetë me aq sa besoni dhe
15 mendoni ju?

16 PË. Po.

17 PY. Duke mbajtur parasysh edhe korrigjimet edhe sqarimet në
18 këtë shënim, informacioni që keni dhënë ju në deklaratën tuaj
19 si dëshmitar a pasqyron saktësisht atë që do të thonit edhe
20 sot në sallën e gjyqit nëse do t'ju bënin të njëjtat pyetje?
21 Pra, të njëjtat pyetje që ju kemi bërë kur keni dhënë
22 deklaratën si dëshmitar?

23 PË. Po.

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kërkojmë pranimin e deklaratës
25 së dëshmitarit, DHT11739 deri në DHT11742, që është pranuar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 112

1 fillimisht nga Trupi Gjykues në mënyrë të përkohshme në
2 vendimin F03452. Kërkojmë po ashtu pranimin e Shënimit
3 Përgatitor numër 1, me numër DHT12570, DHT12573 për pranimin.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
5 kundërshtime?

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë tjetër
8 ka kundërshtim?

9 Në rregull, atëherë materiali DHT12570, DHT12573 dhe
10 shënimi përgatitor pranohen.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti
12 do të marrë numrin e provës 1D00427 dhe klasifikimi është
13 konfidencial.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po materiali
15 i dytë çfarë ishte?

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ishte deklarata.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E
18 humba fare fillin.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Tani sapo pranua shënimin
20 përgatitor. Tani flasim për deklaratën, kërkojmë pranimin e
21 deklaratës.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I humba pak
23 numrat. Ju lutem ma jepni dhe një herë, ju lutem, numrin.

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po. Bëhet fjalë për deklaratën
25 që ka numrin DHT117839, DHT11742.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 113

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 DHT11739, 11743 --

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] 42.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
5 42, pranohet.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Deklarata do të marrë
7 numrin e provës 1D00428, dhe klasifikimi është konfidencial.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

10 PY. Më 10 nëntor 2025 Mbrojtja e Thaçit dorëzoi me email një
11 përmbledhje të këtij dëshmitari që është pranuar sipas
12 rregullës 154, nuk morëm asnjë kundërshtim për përmbledhjen
13 kështu që me lejen tuaj do ta lexoj me zë.

14 Michael Durkee është një oficer i shërbimeve të huaja
15 amerikane që tashmë është në pension, i cili ka qenë
16 këshilltar politik për katër komandantë të lartë të NATO-s në
17 Evropë nga 1993 deri në 2009, përfshirë faktin që ka qenë
18 këshilltar i Gjeneralit Clark, Wesley Clark.

19 Në 1999, Michael Durkee kishte si përgjegjësi t'i jepte
20 këshilla Gjeneralit Wesley Clark edhe oficerëve të lartë të
21 NATO-s edhe shërbeu si oficer ndërlihdës për SACEUR dhe
22 Ambasadorët e NATO-s si dhe me terrenin në Kosovë, me aktorët
23 në terren në Kosovë.

24 Në kuadër të përgjegjësisive të tij, z. Durkee ka marrë
25 pjesë në një takim mes Gjeneralit Clark edhe delegacionit

1 shqiptar të Kosovës në Rambuje ku ka komunikuar me z. Hashim
2 Thaçi. Gjenerali Clark dhe Michael Durkee krijuan përshtypjen
3 se udhëheqësit e UÇK-së donin pavarësinë e Kosovës, por nuk
4 kishin një strategji të qartë ushtarake, nuk kishin mundësi të
5 realizonin këtë qëllim.

6 Z. Durkee po ashtu do japë komentet e veta lidhur me
7 dhunën pas luftës që gllabëroi Kosovën në verën e 1999-s.
8 Sipas tij ka qenë një reagim social i shtrirë gjithandej që
9 nuk mund ta kontrollonte as KFOR-i as UÇK-ja. Nuk kishte e
10 koordinuar nga lart, po ishte një reagim spontant i motivuar
11 nga dëshira për shpagim, hakmarrje dhe gjakmarrje.

12 Udhëheqja e UÇK-së nuk ishte në gjendje ta kontrollonte
13 dhunën, pjesërisht sepse emocionet e personave që ishin
14 larguar ishin kaq të forta sa që ishte e vështirë të
15 kontrollohej, po dhe për faktin se UÇK-ja nuk kishte një linjë
16 komanduese të fortë.

17 Sipas z. Durkee, z. Thaçi nuk kishte asnjë motiv të
18 nxiste dhunën nga ana e UÇK-së, por bëri çdo përpjekje të
19 mundshme për të zvogëluar, për t'i zbutur rastet e dhunës
20 sepse nëse do të urdhëroheshin akte dhune, sidomos dhune
21 etnike, kjo rrezikonte marrëdhënien me ndërkombëtarët, të
22 cilën z. Thaçi kërkonte që ta realizonte, pra që të kishte një
23 marrëdhënie të mirë me ata.

24 PY. Z. Durkee, dua të filloj me disa pyetje për karrierën
25 tuaj dhe përvojën profesionale.

1 Sa vite keni shërbyer, keni punuar në shërbimin të huaj
2 amerikan?

3 PË. Nga 1967 deri në fund të 1999-s.

4 PY. Faleminderit. Në paragrafin 3 -- do sqarojmë diçka, ju
5 lutem. Ju thatë deri në fund të 1999-s?

6 PË. Jo, në 1998-n, 1998-n desha të thoja.

7 PY. Dhe keni dalë në pension më 31 dhjetor 1998, apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Në paragrafin 3 ju thoni -- thoni që keni filluar punën
10 në 1967, keni punuar në poste të ndryshme diplomatike,
11 kryesisht në Evropë dhe Amerikën Jugore. A mund të na jepni
12 një ide se çfarë postesh keni pasur në këtë përudhë kohore,
13 shkurtimisht?

14 PË. Kryesisht kam qenë oficer politik në ambasadat jashtë
15 vendit, dhe kam punuar në Departamentin e Shtetit në
16 Uashington. Si oficer politik për shërbimet e huaja je
17 përgjegjës kryesisht për mbledhjen e informacionit politik,
18 bën analiza politike dhe vlerësime dhe rekomandime për nivelet
19 e larta.

20 PY. Faleminderit. Në cilat shtete keni shërbyer në këtë
21 periudhë?

22 PË. Në Ekuador, në Norvegji, në Zvicër. Kam qenë oficer për
23 Spanjën, në fakt, në kohën e regjimit të Frankos, pas rënies
24 së Frankos. Në Kanada, dhe më pas në Uashington dhe në
25 Uashington ku kam mbyllur dhe karrierën time.

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 116

1 PY. Kur jeni promovuar në shërbimin e huaj? Kur jeni ngritur
2 në detyrë?

3 PË. Fillimisht jam ngritur në detyrë kur po shërbeja në
4 Helsinki, në Finlandë në 1984.

5 PY. Pasi u ngritët në detyrë dhe u bëtë oficer i lartë i
6 shërbimeve të huaja, çfarë posti mbajtët?

7 PË. Kjo ka ndodhur kur kam qenë në fakt zëvendësshef i
8 misionit në Helsinki në Finlandë. Dhe më pas kam qenë një nga
9 ndihmësit e lartë të ndihmës sekretarëve të Departamentit të
10 Shtetit --

11 PËRKTHYESJA: S'e dëgjoj fare

12 DËSHMITARI: [Përkthim]

13 PË. -- dhe më pas kam qenë këshilltar politik për komandën e
14 marinës që ishte me bazë në Londër. Më pas u caktova
15 këshilltar politik i SACEUR. Pra, nga 1993 deri në 1998 [Sipas
16 përkthimit] kam qenë këshilltar politik për drejtuesit e lartë
17 politikë.

18 PY. Këta udhëheqës ushtarakë që i keni këshilluar ju, kanë
19 qenë të gjithë amerikanë, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Ju keni dalë në pension nga shërbimi i juaj i Shteteve të
22 Bashkuara me 31 dhjetor 1998 me gradën këshilltar ministre. A
23 mund të na e shpjegoni çfarë është kjo gradë?

24 PË. Nuk dua që të futem shumë në detaje me strukturën e
25 gradave. Megjithatë më duhet t'ju them që ky është niveli i

1 dytë më i lartë në nivelin e karrierës në shërbimin e huaj?

2 PY. Po niveli më i lartë kush është?

3 PË. Niveli më i lartë është ai i ministrit.

4 PY. 1999 nuk ka qenë fundi i karrierës tuaj diplomatike, apo
5 jo, Dëshmitar?

6 PË. Jo.

7 PY. Ju në paragrafin 4 të deklaratës thoni që jeni punësuar
8 nga SHAPE drejtpërdrejtë, pra, nga NATO-ja, nga data 1 janar
9 1999 deri sa keni dalë përfundimisht në pension në vitin 2004.
10 A është kështu.

11 PË. Po.

12 PY. PO, dhe më pas keni vazhduar që t'i jepni këshillat tuaja
13 si këshilltar i lartë jo me pagë i SACER-it në vitin 2008, apo
14 jo?

15 PË. Po.

16 PY. Në paragrafin 4 ju thoni që jeni kthyer në Departamentin
17 e Shtetit Amerikan si zëvendës i dërguari i posaçëm për pjesën
18 e Lindjes së Mesme për çështjet e sigurisë nga viti 2008 deri
19 në prill 2009. A është e saktë kjo?

20 PË. Po.

21 PY. A është posti i fundit diplomatik që keni mbajtur ju,
22 Dëshmitar, ky që sapo përmendëm?

23 PË. Po.

24 PY. Tani do flasim për përvojën profesionale në Ballkan. Në
25 paragrafin 5 të deklaratës ju thoni që keni punuar në Bosnje

1 me Admiralin Layton Smith dhe roli ka qenë si komandant i
2 misionit të IFOR-it. Na e shpjegoni çfarë roli ka qenë ky?
3 PË. Si me shumë oficerë të tjerë amerikanë që kanë shërbyer
4 në poste të NATO-s, Admirali Layton ka pasur rol të dyfishtë.
5 Domethënë ka qenë komandant i lartë i Shteteve të Bashkuara,
6 domethënë, komandant i forcave të Marinës në Evropë, i
7 Shteteve të Bashkuara dhe gjithashtu ka qenë komandant i NATO-
8 s, komandant i forcave të Aleancës në selinë e NATO-s në
9 Itali, në Napoli. Unë e kam pasur postin e punës në Londër,
10 dhe ndërkohë zyra e NATO-s kishte dy seli, domethënë kishte
11 një në Napoli, që e thashë dhe më përpara, në Itali, dhe një
12 tjetër ishte në një tjetër shtet. Unë, pra, në Londër në këtë
13 rast.

14 Unë kam punuar me të dy shtabet në Londër dhe në Napoli
15 në mënyrë të tillë që unë të jepja kontributin tim për sa i
16 takon detyrave që kishin të bënin me Marrëveshjen e Dejtonit.
17 PY. Kur ka ndodhur kjo?

18 PË. Në Londër kam qenë në periudhën 1993-1994, deri në 1995,
19 ndërkohë që marrëveshja e Dejtonit e 1995-s kërkonte shumë
20 parapërgatitje ushtarake sepse ishte hera e parë kur NATO-ja
21 do të merrte përsipër një mision përtej territorit të shteteve
22 të NATO-s.

23 PY. A keni shkuar ndonjëherë në Bosnje gjatë rolit tuaj në
24 atë kohë, gjatë punës që keni kryer në atë kohë?

25 PË. Kam -- mund të them që Admirali Smith ka jetuar në

1 Sarajevë dhe e kam vizatuar një herë. Por në verën e vitit
2 1995 jam ricaktuar për të punuar për SHAPE.
3 PY. Faleminderit. Ju jeni thirrur këtu për të dhënë dëshmi
4 lidhur me Kosovën. Tani dua t'ju bëj pyetje në qoftë se keni
5 ndonjë përvojë profesionale që ka të bëjë me vendet e
6 Ballkanit.
7 PË. Si pjesë e partneritetit për paqe që është krijuar në
8 vitin 1993, dhe si ish-shtete të Paktit të Varshavës ne
9 filluam që të shikonim mundësinë e aplikimit ose kërkesës për
10 anëtarësim në NATO dhe në SHAPE, ne filluam që të shikonim
11 mundësi dhe çfarë duhej që të bënim këto shtete që të bënim
12 kërkesë dhe më pas eventualisht të bëheshin anëtarë të NATO-s.
13 Kështu që në këtë kontekst ne kemi vizituar vende të ndryshme
14 të Ballkanit, përfshirë këtu Bullgarinë, ndërmjet vendeve të
15 tjera. Por edhe shtete të tjera të cilat po shkëputeshin
16 gradualisht nga ish-Jugosllavia, përfshirë këtu Slloveninë dhe
17 Kroacinë.
18 PY. Keni marrë shumë çmime dhe dekorata gjatë karrierës tuaj.
19 Disa prej tyre janë dhënë në hollësi në paragrafin 6 të
20 deklaratës që na keni dhënë. A ju është dhënë ndonjë çmim ose
21 ndonjë dekoratë për punën në Kosovë?
22 PË. Medalja që më ka dhënë NATO-ja ka të bëjë me kontributin
23 që unë kam dhënë për ish-Jugosllavinë mbi bazën e ndihmës që
24 unë kam dhënë për SACEUR dhe Shtabin.
25 PY. A mund të na thoni kur ju është dhënë ky çmim

1 mirënjohjeje? A ju kujtohet kur ka qenë?

2 PË. Gjenerali Clark ma ka dhënë si çmim, nuk më kujtohet viti
3 tamam po besoj diku ka qenë te 1997.

4 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykues se çfarë arsimimi keni?
5 Domethënë çfarë diplomash keni?

6 PË. Unë kam diplomë universitare në sociologji. Po ashtu kam
7 një diplomë master. Kam studiuar gjithashtu dhe për Fulbright
8 në Universitetin e Oslos dhe kam punuar për sociologjinë
9 politike, kam punuar së bashku me një profesor amerikan. Kam
10 studiuar gjithashtu edhe në Harvard për një vit, në atë çfarë
11 më pas u bë shkolla e Kenedit, dhe gjithashtu kam një diplomë
12 në ekonomi që e kam marrë në vitin 1967, dhe në të njëjtin vit
13 po ashtu jam bërë pjesëtar i shërbimit të huaj të Shteteve të
14 Bashkuara.

15 PY. Dua që të sqaroj diçka, se thatë se çmimin për Kosovën e
16 keni marrë në 1997-n. Është e saktë kjo apo e thatë gabim?

17 PË. Jo, nuk mund të jetë 1997. Përpara se të ishte -- para se
18 të largohej Gjenerali Clark, besoj duhet të ketë qenë nga
19 fundi i vitit 1999 ose fillimi i vitit 2000. Ju kërkoj ndjesë.

20 PY. Nuk ka problem. Përpara sesa të bëheshit anëtar i
21 shërbimit të huaj të Shteteve të Bashkuara ju keni shërbyer
22 për shërbimin ushtarak të Shteteve të Bashkuara, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Në paragrafin 2 ju thoni që keni shërbyer si shef i togës
25 dhe më pas keni qenë si asistent i oficerit të operacioneve

1 për batalionin, dhe në fund fare keni qenë oficer
2 inteligjence, në nivel asistenti. A mund të na thoni çfarë
3 mësimesh keni nxjerrë ju nga përvoja që keni pasur me ushtrinë
4 amerikane?

5 PË. Mendoj që mësimi më i madh që kam mësuar është që ushtria
6 amerikane është një makineri shumë e madhe që funksionon në
7 nivele të ndryshme dhe që ka funksione dhe objektiva të
8 ndryshme. Për ilustrim, për shembull, si udhëheqës i togës unë
9 kam pasur përgjegjësi që të udhëzoja 40 veta për operacionin
10 ose ushtrime të ndryshme që duhej që të ndërmerim.
11 Domethënë, pikëpamja ime ose detyrat që kam pasur kanë qenë në
12 hierarki nga lart poshtë.

13 Kur mora pozicionin në batalion si S3, pra oficer
14 operacionesh, kam qenë më shumë i përfshirë te pjesa e
15 planifikimit të operacioneve të mundshme ose stërvitjet,
16 veprimtari të cilat kishin të bënin me këto lloj kompanish ose
17 togash. Domethënë, unë në karrierën time kam marrë një ide të
18 mirë se si funksiononte ushtria.

19 Kam punuar gjithashtu -- kam parë marrëdhënien që
20 krijohet nga brigadat, çfarë marrëdhënie kishin brigadat me
21 batalionet, me kompanitë, deri në nivelin e divizioneve. Dhe
22 mënyrën se si funksiononte pjesa e raportit, e hierarkisë ose
23 si funksiononte pjesa e strukturës dhe komandës brenda
24 ushtrisë.

25 PY. Faleminderit. Në paragrafët 1 dhe 5 të deklaratës tuaj,

1 ju thoni që në periudhën nga 1993 deri në 2009 ju keni qenë
2 këshilltar politik i gjashtë komandantëve të shtabeve dhe
3 gjithashtu keni dhënë kontributin tuaj si këshilltar politik i
4 komandantëve të Aleancës së Lartë të NATO-s në Evropë, A është
5 e saktë kjo?

6 PË. Po.

7 PY. Sipas përvojës tuaj profesionale a besoni ju që e kuptoni
8 drejt se si funksionon pjesa ushtarake dhe cilat janë
9 konceptet ushtarake?

10 PË. Besoj se po.

11 PY. Tani do flasim lidhur me rolin tuaj në SHAPE, që është
12 Selia në Evropë e Fuqive të Aleancës në vitin 1999, dhe ku ju
13 keni qenë këshilltar i Gjeneralit Clark.

14 Na e shpjegoni ju lutem çfarë është SHAPE. Ky është një
15 akronim. Na e shpjegoni cila është forma e plotë e SHAPE dhe
16 çfarë përfaqëson ky si institucion.

17 PË. SHAPE është një lloj njësie e veçantë dhe më duhet të
18 them që në historinë ushtarakë domethënë është një strukturë e
19 veçantë.

20 PËRKTHYESJA: Përkthyesit i luten folësve që të flasin më
21 ngadalë.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Atëherë, në përgjigje të pyetjes
23 tuaj, kjo është një strukturë komande supreme ushtarake në
24 NATO dhe janë selitë -- domethënë është Selia Supreme e
25 Forcave të Aleatëve në Evropë. Pra, SHAPE në vetvete ishte

1 mishërimi gatishmërisë së kombeve të NATO-s për të përfshirë
2 forcat e tyre për mbrojtjen e përbashkët. SHAPE në vetvete
3 përbëhet nga disa shtresa. Në fillim fare është SHAPE dhe
4 pastaj kemi komandat e vartësit në Evropë dhe në Shtetet e
5 Bashkuara. Pra, ka seli shumëkombëshe me stafe shumëkombëshe
6 që do të thotë që kemi oficerë të NATO-s, të vendeve anëtare
7 të NATO-s të cilët funksionojnë në vende të ndryshme. Dhe në
8 këtë mënyrë Aleanca e NATO-s pasqyrohet nga përvoja dhe nga
9 informacioni që është në dispozicion duke marrë parasysh
10 shumatorin e gjithë komponentëve të ndryshëm të NATO-s ose të
11 vendeve përkatëse. Atëherë në këtë mënyrë bëhet më e prekshme
12 e puna sepse shkëmbehet më shumë informacion, shkëmbehet më
13 shumë bashkëpunimi dhe kolegët dhe njësitë e ndryshme të
14 shteteve anëtare të NATO-s japin kontributin e tyre për
15 arritjen e objektivave të përbashkët.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

17 PY. Në vitin 1999, sa shtete anëtare kishte NATO-ja asokohe,
18 ju kujtohet apo jo?

19 PË. Më kapët gafil. Mendoj që kemi qenë diku 15 në atë kohë.

20 Ose jo, nuk besoj që është shifra e duhur kjo se në 1997-n

21 filluam domethënë u bënë anëtarë edhe Polonia, Hungaria, mbase
22 dhe Estonia. Ju kërkoj ndjesë. Nuk e di. Siç e thashë më kapët
23 mat.

24 PY. Besoj që kanë qenë 19. A do pajtoheshit me mua lidhur me
25 këtë?

1 PË. Besoj që ju e dini më mirë se unë se nuk jam shumë i mirë
2 me numrat.

3 PY. Si ishin të organizuar zyrat, shkurtimisht?

4 PË. shte një përzierje e zyrtarëve ndërkombëtarë dhe të
5 oficerëve amerikanë të natyrës ushtarake dhe civile.

6 Domethënë, në përgjithësi unë kisha një staf prej 14 vetëve.

7 PY. Kur thua kisha një staf prej 14 vetëve çfarë do të thotë
8 kjo?

9 PË. Unë isha shefi dhe kisha 14 veta nën vartësinë time.

10 PY. Faleminderit.

11 PË. Unë isha oficer i çështjeve ndërkombëtare. Duhet t'jua
12 shpjegoj në terminologjinë e NATO-s që bëhej fjalë për
13 këshilltarë të çështjeve ndërkombëtare dhe jo për këshilltar
14 siç kurse qenë më herët, se parapëlqej më tepër që unë të
15 quhesha këshilltar për çështjet ndërkombëtare jo këshilltarë
16 politikë siç kishte qenë rasti kur unë kisha punuar për
17 SACEUR. Pra, me fjalë të tjera unë isha këshilltar i lartë për
18 Gjeneralin Clark, ndërkohë që kishte dhe persona të tjerë që
19 ishin të stafit tim që kishin ndonjëherë kontakte të
20 drejtpërdrejtë me Gjeneralin Clark për aspekte specifike, për
21 shembull. John Duncan, ose oficeri Steve Covington që ishte
22 përgjegjës për ndërlidhjen dhe menaxhimin e ditëpërditshëm të
23 delegacionit rus dhe që ishte përfshirë në stafin më të
24 përgjithshëm të SHAPE për qëllime të zbatimit të marrëveshjes
25 së Dejtonit në Bosnje. Domethënë, këto ishin disa prej

1 detyrave të mia të ditëpërditshme.

2 PY. Faleminderit. Do t'i kthehem prapë çështjes së stafit

3 tua j më pas, por për momentin dua t'ju pyes për rolin konkret

4 që keni pasur në vitin 1999 si këshilltar politik për komandën

5 Supreme të Aleancës në Evropë. Çfarë përgjegjëse keni pasur në

6 atë kohë, Dëshmitar?

7 PË. Unë kam qenë përgjegjës në përgjithësi për të siguruar që

8 Gjenerali Clark të ishte plotësisht i informuar dhe të bënte

9 vlerësimet e nevojshme lidhur me zhvillimet politike në të

10 gjithë rajonin që kishin ndikim mbi realizimin e misionit të

11 tij ushtarak. Këtu përfshiheshin, për shembull, dhe

12 marrëdhëniet e vazhdueshme me ushtrinë ruse për të cilën ne

13 ishim përgjegjës. Por ashtu pjesë e rolit kishte të bënte me

14 ndihmën e vazhdueshme për anëtarë të rinj të NATO-s dhe të

15 punonim me kombet aspiruese që dëshironin që të bëheshin

16 anëtarë të NATO-s, për shembull, vendet të ish-Paktit të

17 Varshavës. Po ashtu ishte detyra jonë që të punonim

18 bashkërisht për ato kombe të cilat dëshironin të merrnin pjesë

19 në Bosnje dhe më pas në Kosovë. Në një pikë në SHAPE ne kishim

20 52 kombe të ndryshme të cilat merrnin pjesë në një operacion

21 ose në një tjetër dhe ata të gjithë kishin nevojë për

22 udhëzime, domethënë se si të mund të punonin në një mjedis

23 shumëkombësh. Dhe së fundi ishte vlerësimi i vazhdueshëm

24 lidhur me atë se çfarë do të ndodhte me operacionet në terren

25 si në Bosnje fillimisht por më pas edhe në Kosovë.

1 PY. Kur thoni vlerësim i vazhdueshëm, për çfarë e keni fjalën
2 kur i referoheni Kosovës, Dëshmitar?

3 PË. Ne shihnim se si evoluonte mjedisi operacional.
4 Domethënë, merrnim parasysh përpjekjet e vazhdueshme të
5 presionit të Slllobodan Milosheviq dhe forcave të tij për të
6 shtypur rezistencën shqiptar, po ashtu shikonim edhe ndikimin
7 dhe fuqitë ndërmjet shqiptarëve të Kosovës në atë kohë, dhe
8 mundoheshim që të mendonim se si do ta menaxhonim këtë situatë
9 në mënyrë të tillë që operationet e NATO-s dhe të vendeve jo
10 NATO të mund të ishin sa më të struktura kur ato u përfshinë
11 me KFOR-in.

12 PY. Pse ishte e rëndësishme për SACEUR që të këshillohej
13 lidhur me këto tema?

14 PË. Çdo komandant ushtarak duhet që të ketë një ide, të ketë
15 një vlerësim të mirë të mjedisit të përgjithshëm ku kryhen
16 operationet ushtarake që drejtohen prej tij, sepse në fund të
17 fundit ky person do ndikohet dhe do udhëzohet nga aktorë
18 politikë që shkojnë përtej sferës së ndikimit të tij. Pra, që
19 mund të jenë qeveritë e të tjera kombeve përbërëse, domethënë,
20 ka shumë elementë të tjerë të cilët formësojnë mjedisin në të
21 cilin do të duhej që të kryente veprimtaritë e veta një
22 komandant i caktuar.

23 PY. Ku mbështeteshit ju për t'ia dhënë këtë ndihmë SACEUR-it?

24 PË. Sikur e thashë dhe më herët, SHAPE është një makineri e
25 shkëlqyer, ka shtresëzime të ndryshme. Ka aktorë kombesh, ka

1 qeveri kombëtare, ka anëtarë të NATO-s, po ka gjithashtu edhe
2 shtete partnere të qeverive kombëtare dhe është një vend ku
3 mbledhen së bashku informacione të shumta, përfshirë këtu
4 informacione që vijnë nga shtabet e NATO-s, po ka gjithashtu
5 edhe rrugë informacioni që lidhen me komandat e varura.

6 Për shembull, në rastin e Kosovës, kur Gjenerali Jackson
7 krijoi selinë e vet atje kishte fluks të përditshëm
8 informacioni, domethënë merrnim [E pakuptueshme] informacion.
9 Mund të merrnim raporte të përditshme të drejtpërdrejta
10 ndoshta edhe të tërthorta nga Misioni i Kombeve të Bashkuara
11 është Kosovë që prej momentit që ai u vendos atje.

12 Mbase duhet që të shtoj dhe diçka tjetër, që përpara
13 kësaj kohe, Misioni i Verifikimit të OSBE-së bënte raporte të
14 rregullta për Kosovën.

15 PY. T'i kthehem dhe një herë rolit të shteteve anëtare. A e
16 kam kuptuar drejt se kishte fluks informacioni nga shtetet
17 anëtarë të NATO-s si, për shembull, Shtetet e Bashkuara,
18 Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Irlanda, besoj, drejt SACER,
19 a ishte kështu? Domethënë drejt zyrës tuaj, në drejtim të
20 zyrës tuaj?

21 PË. Tek stafi i SHAPE dhe pastaj në zyrën time, sepse bëhej
22 një lloj filtrimi -- jo në kuptimin e bllokimit të
23 informacionit por në kuptimin e vlerësimit të informacionit që
24 na jepej.

25 PY. Në kontekstin e Kosovës, për shembull, a keni marrë

1 vlerësime ushtarake dhe politike lidhur me atë çfarë ndodhte
2 në terren në Kosovë nga të gjitha shtetet anëtare të NATO-s?
3 PË. Po, të gjitha shtetet anëtare që i kishin burimet e
4 nevojshme që mund të kontribuonin me këtë informacion, sepse
5 disa kombe të NATO-s nuk kishin zyra ose persona në terren që
6 mund ta bënë këtë gjë. Megjithatë për shtete që ishin
7 aktivisht të përfshira, po, sigurisht që merrnin informacion.
8 Sigurisht, për shembull, Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e
9 Bashkuar, Gjermania dhe shtete të tjera e jepnin, e përcillnin
10 këtë informacion.
11 PY. Këtë informacion ju a e merrnit parasysh kur e
12 këshillonit SACEUR-in?
13 PË. Kjo do ishte pjesa më e madhe e bazës së informacionit që
14 ne përdornim për vlerësim dhe më pas ia përcillnim Gjeneralit
15 Clark.
16 PY. NATO-ja a kishte agjencinë e vet të inteligjencës apo
17 mbështetej nga agjencitë e inteligjencës së shteteve anëtare?
18 PË. Në SHAPE kishte një komponent të inteligjencës. Kishte
19 një komponent të inteligjencës dhe në shtabin e NATO-s, në
20 shtabin, në zyrën kryesore të NATO-s. Por në asnjë rast nuk
21 kishte agjentë që funksionin në terren, por më tepër ishin në
22 kapacitetin ose pozicionin e marrjes së informacionit që i
23 jepnin nga burimet kombëtare ose nga selitë kombëtare të NATO-
24 s.
25 PY. Domethënë, presumohet që në qoftë se disa prej këtyre

1 shteteve të NATO-s kishin agjentë në terren, ju i meni marrë
2 informacionet nga këta agjentë të tyre në terren, kështu, apo
3 jo, Dëshmitar? Domethënë në qoftë se e thashë diçka që nuk i
4 përgjigjeni dot në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen mund ta
5 thoni.

6 PË. Po mundohem që të gjej një mënyrë më të përgjithshme për
7 t'ju përgjigjur pyetjes që më bëtë. Si pjesë e stafit tim në
8 atë kohë unë kam pasur një përfaqësues gjerman dhe një
9 përfaqësues britanik. Domethënë ky i Gjermanisë ishte
10 përfaqësuesi i punëve të jashtme të Gjermanisë. Në rolin e
11 tyre përmes kanaleve kombëtare që merrnin informacion këto
12 informacione jo domosdoshmërisht mbërrijnë në NATO ose në
13 SHAPE, por shkak të marrëdhënies të punës që kishim ne dhe për
14 shkak të angazhimit që të merrnim informacionin më të madh dhe
15 të bënim këshillimin më të saktë për SACEUR-in ata e ndanin ca
16 prej atij informacionit që kishin ashtu siç ndaja dhe unë
17 informacionet që merrja nga kanalet amerikane, që mendoja që
18 ishin të rëndësishme për misionin e SACER-it.

19 Po, por nuk mund të merrja gjithë informacionin që kishin
20 shtetet anëtarë ose që ishin të disponueshme në kanalet
21 kombëtare. Kishte edhe anëtarë të tjerë të NATO- që herë pas
22 here na jepnin informacion dhe vlerësim që ata i kishin marrë
23 burimeve të tyre kombëtare, por kjo ndarje e informacionit
24 bëhej më tepër *ad hoc*, pra në mënyrë të rastësishme jo të
25 vazhdueshme.

1 PY. Dua që të kalojmë së bashku disa burime të tjera. A
2 mbështeteshit ju në takimet që bëheshin në misionet e NATO-s
3 për të krijuar këshillimet tuaja ose për të krijuar një ide
4 për sa i takon këshillave që i jepnit Gjeneralit Clark?

5 PË. Unë merrja pjesë në mënyrë të rregullt në takimet e
6 komitetit politik të NATO-s që ishte një vend ku jepeshin dhe
7 diskutoheshin tema të cilat ishin me vlerë për momentin dhe i
8 raportoja Gjeneralit Clark për natyrën e diskutimeve
9 gjithashtu edhe këshillat që jepeshin për ambasadorët.

10 PY. A keni patur një rrjet tuajin personal kontaktesh ju në
11 Kosovë, apo jo?

12 PË. Jam përpjekur shumë që ta krijoja këtë rrjet personal,
13 por ishte shumë, shumë e vështirë që të krijohej një rrjet i
14 fortë i burimeve të rregullta.

15 PY. Në momentin kur ju e mblidhnit gjithë këtë informacion,
16 ju këshillonit SACER-in, kështu ndodhte, kjo ishte rrjedha?

17 PË. Po.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
19 Tavakoli, informacioni është shumë interesant por nuk shoh se
20 ka ndonjë rëndësi shumë të madhe. Mbase do ishte mirë që të
21 kalonim tek pyetjet që kanë të bëjnë me dëshminë tuaj.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Më duhet dhe pesë minuta, në
23 fakt, derisa të futemi në temë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi rreth 45
25 minuta që dëgjojmë.

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

2 PY. Për çfarë e përdorte SACEUR-i këtë informacion?

3 PË. Gjenerali Clark thithte informacion të shumtë në mënyrë
4 tillë që të vendoste vetë lidhur me përparësitë dhe lidhur me
5 këshillat që jepte për NATO-n. Siç e dini, këshillimi
6 Atlantikut Verior përbëhej nga ambasadorë të shteteve anëtare
7 dhe nga Sekretari i Përgjithshëm.

8 Fillimisht në Bosnje dhe më pas në fushatat ajrore në
9 Kosovë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s mori përgjegjësi për
10 më shumë kompetencë të drejtpërdrejtë për sa i takon -- nuk
11 ishte parë domethënë asnjëherë një kompetencë e tillë e
12 drejtpërdrejtë që kishte të bënte me operacionet ushtarake.
13 Kështu që marrëdhënia e Gjeneralit Clark me Javier Solana u bë
14 në fakt një marrëdhënie shumë e rëndësishme dhe që rezultoi në
15 veprimet të cilat u morën më pas.

16 PY. Pyetja e fundit përpara sesa të bëjmë pushimin ka të bëjë
17 më John Duncan, se ju përmendët se John Duncan ka punuar me
18 juve. A ka pasur ndonjë ekspertizë të spikatur z. John Duncan?

19 PË. Për shkak të përvojës së tij të mëparshme John Duncan
20 është konsideruar si eksperti ynë i brendshëm për gjëra që
21 kishin -- ose tema të cilat kishin të bënin me shqiptarët e
22 Kosovës. Shqiptarët e Kosovës dhe shqiptarët e Shqipërisë për
23 shkak të natyrë së njohurive që kishte ai.

24 PY. A përfshihej këtu edhe UÇK-ja dhe Qeveria e Përkohshme e
25 Kosovës?

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 132

1 PË. Po.

2 PY. A ju raportonte në mënyrë të drejtpërdrejtë ai juve?

3 PË. Ai ishte pjesë e ekipit tim, por për këto çështje ose për
4 çështje të caktuar ai kishte kontakt të drejtpërdrejtë me
5 Gjeneralin Clark.

6 PY. Në rregull. Tani dua të kalojmë te takimi që keni pasur
7 me z. Thaçi në vitin 1999.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Doni që të bëjmë pushim tani
9 apo më pas?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përdori kohën
11 që keni deri në orën 3.00.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

13 PY. Në paragrafin 12 të deklaratës tuaj ju përshkruani faktin
14 që keni shoqëruar Gjeneralin Clark në një takim me Hashim
15 Thaçin dhe delegacionin shqiptar në Rambuje, në mars ose prill
16 1999.

17 PË. Po.

18 PY. Do ju tregoj një dokument dhe ju lutem më thoni në qoftë
19 se kjo është deklarata që keni dhënë ju për ne.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares që të
21 paraqesë në ekran provën 1D100360.

22 PY. Ju lutem hidhini një sy këtij dokumenti. Z. Durkee, a
23 është ky takim që përshkruani ju në deklaratën tuaj?

24 PË. Më duket të jetë e saktë sa i takon natyrës së takimit që
25 është zhvilluar. Përmbajtja e raportit besoj që është e tillë

1 që është në favor të interesave të shqiptarëve të Kosovës në
2 mënyrë taktike kështu.

3 PY. A ju kujtohet se ku është mbajtur ky takim? Këtu thuhet
4 që është mbajtur në Mons?

5 PË. Është e vështirë që njerëzit të kuptonin dallimin
6 ndërmjet shtabit të NATO-s dhe Brukselit dhe që është organi
7 politik, domethënë, i NATO-s, domethënë ishte e vështirë për
8 ta që të bëhej dallimi midis krahut ushtarak të NATO-s dhe
9 krahut politik të NATO-s. Është një lloj frazeologjie,
10 zhargoni që ne përdornim zakonisht, por është bërë për të
11 treguar që nuk është bërë në shtabin kryesor. Domethënë është
12 përdorur në SACEUR.

13 PY. Lista e pjesëmarrësve që kanë marrë pjesë në këtë takim a
14 është e saktë? Ju lutem shikoni paragrafin e dytë ose të
15 parin.

16 PË. Të gjitha këto emra unë i njoh si -- domethënë, janë
17 persona të cilët unë i kam parë, i kam takuar vetë. Personat
18 që i kam takuar personalisht kanë qenë z. Thaçi dhe z.
19 Krasniqi, të tjerët janë thjesht emra të dëgjuar jo të takuar.

20 PY. A ka pasur ndonjë person nga ana e NATO-s?

21 PË. Në takime të kësaj natyre Gjenerali Clark zakonisht
22 shoqërohet nga një ose dy ose më tepër persona që ishin
23 ndihmës ushtarakë që ishin me gradën kolonel që ishin oficerë
24 ushtarakë me përvojë që mund të ishin shpesh nga Shtetet e
25 Bashkuara po dhe nga shtete të tjera, dhe këta përgjithësisht

1 ishin persona që mbanin shënime. Unë punoja me këta persona
2 pas takimeve të tilla në mënyrë të tillë që të bëja një lloj
3 vlerësimi për SACEUR-in në mënyrë që të transmetohej rëndësia
4 dhe mesazhet kryesore të këtyre takime.

5 PY. Ju në paragrafin 12 të deklaratës ju thoni që qëllimi i
6 takimit ishte që pjesërisht Gjenerali Clark dëshironte të
7 kuptonte më mirë synimet politike të UÇK-së dhe kapacitet
8 ushtarake në rast do të urdhërohej dhe do të kryhej një
9 operacion ushtarak. Pse ishte e rëndësishme që të kuptoheshin
10 synimet ose objektivat politike të UÇK-së në këtë kohë,
11 Dëshmitar?

12 PË. Siç çdo komandant ushtarak që mendon për misionin, që po
13 koncepton misionin, është e rëndësishme për të për të ditur se
14 cili është mjedisi në terren në qoftë se jepet urdhër që të
15 vijojë me operacionin ushtarak. Domethënë nuk mund të kryesh
16 ti operacionin ushtarak pa u përgatitur dhe pa ditur se kush
17 do jenë aktorët kryesorë, çfarë aftësisht kanë ata, çfarë
18 synimesh, çfarë objektivash kanë ata, në çfarë mënyrash ata
19 mund të kërcënohen ose mund të ndihmojnë misionin që të jetë
20 në përgatitje e sipër.

21 PY. Dhe çfarë përfundimi u nxor pas këtij takimi sa i takon
22 synimeve politike të UÇK-së?

23 PË. Mendoj se në atë pikë Gjenerali Clark po mendonte se deri
24 në çfarë mase ato mund të bëheshin bashkëpunues të misionit.

25 PY. Për kë e keni fjalën?

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 135

1 PË. E kam fjalën për UÇK-në. Ose mund të bëheshin ndoshta
2 "armiq" të misionit, dhe në këtë rast do të duhej që merrnin
3 veprime ndaj tyre. Pra, duhej të dinim në qoftë se do kishim
4 të bënim me partner ose me armiq.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur të jetë e
6 përshtatshme mund të ndaloni znj. Tavakoli.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

8 PY. Çfarë përfundimi nxorët ju lidhur me këtë?

9 PË. Mendoj se në atë pikë ato përbënin, domethënë, UÇK-ja
10 përbënte potencial për bashkëpunim, por ishte shumë herët për
11 ta thënë këtë me saktësi.

12 PY. Pse mendonit ju që kishin potencial që të ishin
13 bashkëpunëtorë?

14 PË. Sepse ishin shumë të gatshëm që të gjenin mënyra që të
15 merrnin mbështetjen e NATO-s për fushatën ajrore për t'i
16 rezistuar shtypjes serbe.

17 PY. Si e demonstruan këtë gatishmëri të tyre ata?

18 PË. Sepse ata vazhdonin të pyesnin në qoftë se ne mund të
19 bombardonim serbët sepse atë e dinin se çfarë përvoje kishte
20 pasur Bosnja në të cilën NATO-ja kishte ushtruar kompetencat e
21 veta dhe kishte bombarduar, pra, pjesën e serbëve në Bosnje.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani mund të
24 bëjmë pushim.

25 Dëshmitar, do bëjmë dhjetë minuta pushim. Është rregull i

1 përgjithshëm që e kemi ky.

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë

6 pushim për dhjetë minuta.

7 --- Seanca ndërpritet në orën 15.03

8 --- Seanca rifillon në orën 15.15

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na pyetën
10 nëse do vazhdonim deri në 4.00 apo 4.30 sot, kjo varet.

11 Znj. Tavakoli, a mendoni se do përfundoni deri në 4.30
12 sot? Kjo është në fakt koha që keni kërkuar.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo, kam kërkuar dy orë e
14 gjysëm. Filluam në 2.30, kështu që 3.20, 4.20 --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po më thoni
16 që nuk mund të mbaroni?

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ndoshta mund të përfundoj. Do
18 të më duhen ndoshta 20 minuta më shumë sesa dy orë e gjysëm.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk do
20 vazhdojmë më tej se orën 5.00 gjithsesi.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do të përpiqem.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk mund të
23 jetë ashtu. Ose do të përfundoni ose s'do përfundoni.

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk e di varet sesa të gjatë do
25 të jenë përgjigjet.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po na e lini
2 neve atëherë që të marrim këtë vendim?

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mund të vazhdoj deri në orën
4 4.30 dhe shohim se si shkon.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
6 mund të mbaroni deri në 4.30 do të ishte në rregull, por duhet
7 të mbaroni.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk mund të angazhohem, të
9 premtoj një gjë të tillë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do vazhdojmë
11 deri në 4.00 atëherë. Faleminderit.

12 Mund të sillni dëshmitarin në sallë.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Durkee,
15 vazhdojmë me pyetjet që po ju bën znj. Tavakoli.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

17 PY. Po flisnim për takimin kur u takuat me Hashim Thaçin dhe
18 thatë se po përpiqeshit të kuptonit cilat ishin synimet dhe
19 aftësitë ushtarake dhe politike të UÇK-së.

20 Cili ishte përfundimi në të cilin dolët sa u përket
21 aftësive, kapaciteteve ushtarake të UÇK-së?

22 PË. Në atë kohë, nuk kishim informacion shumë të mirë dhe për
23 rrjedhje nuk mund të bënim një vlerësim të mirë të
24 kapaciteteve të tyre, nuk e dinim cilat ishin kapacitetet e
25 tyre ushtarake të sakta. E dinim që kishin luftëtar në terren.

1 PY. Sa u takon qëllimeve politike, qëllimeve politike të UÇK-
2 së cilat ishin ato, cili ishte përfundimi në të cilin arritët
3 ju?

4 PË. Ishte e qartë që ata ishin të vendosur për pavarësinë nga
5 Serbia.

6 PY. Në paragrafin 14 të deklaratës suaj keni thënë që nuk
7 ishit në gjendje të merrnit ndonjë informacion konkret sa u
8 takon nivelit të forcës së UÇK-së, armëve, planeve të
9 dislokimit. Bazuar në këtë mendim apo analizë të tyre që ishte
10 e vagullt, Gjenerali Clark dhe unë ... u largua me ndjenjën se
11 udhëheqësit e UÇK-së donin pavarësinë për Kosovën por nuk
12 kishin një strategji të qartë të ushtarake apo kapacitetet e
13 tilla për të arritur atë qëllim."

14 Për çfarë e kishit fjalën kur thoni mendim "i vagullt" i
15 paqartë?

16 PË. Sepse nuk na dhanë shumë informacione lidhur me se sa
17 persona, sa luftëtarë kishin në terren ku ishin të vendosur
18 ata, si do përdreshin, cilat ishin nivelet e furnizimit që
19 kishin, pra, do të ishte e vështirë që të merrnim, të kuptonim
20 ndonjë strategji të qartë pas kësaj, atë që po përpiqeshin të
21 bënin përveçse angazhimit apo vendosjes së tyre për të arritur
22 pavarësinë.

23 PY. A kishit informacion lidhur me këto çështje nga burime të
24 tjera në atë kohë?

25 PË. Ne po merrnim informacion në mënyrën se si UÇK-ja po

1 furnizohej me armë përmes kufirit me Shqipërinë, mbledhja,
2 grumbullimi i fondeve përmes diasporës së Kosovë në vende të
3 tjera të Evropës dhe Shtetet e Bashkuara. Pra, e dinin që ata
4 merrnin mbështetje dhe se kjo mbështetje transformohej në
5 zhvillimin e kapaciteteve ushtarake, po ishte e vështirë që të
6 kuptohej sasia dhe cilësia e tyre dhe vendi ku ishin këto.
7 PY. Gjithashtu, në të njëjtin paragraf thatë se UÇK-ja "nuk
8 kishte strategji ushtarake të qartë apo kapacitetin ushtarak
9 për të arritur qëllimin e tyre". Për çfarë e kishit fjalën për
10 këtë?
11 PË. Është e vështirë të kuptohej se si mendonin se mund
12 zmbrapsin dhe të mposhtnin forcat e Serbisë me aftësitë, me
13 kapacitetet që kishin duke patur parasysh se qëllimi ishte
14 pavarësia. Pra, a mund t'i mposhtnin forcat serbe vetëm ata?
15 Është vështirë për ta thënë këtë. Dhe, për rrjedhojë,
16 strategjia ushtarake -- cila ishte strategjia ushtarake që
17 mund të mendohej për të arritur këtë pavarësi.
18 PY. Edhe pse donin të mposhten serbët, forcat ushtarake serbe
19 ata, pse donin t'i mposhtnin?
20 PË. Po të mos i mposhtnin, atëherë Kosova nuk do të bëhej e
21 pavarur.
22 PY. Në Shënimin Përgatitor 1, paragrafi 10, keni deklaruar,
23 ju thatë se vlerësimi në paragrafin që sapo lexova më sipër
24 ishte mendimi juaj personal -- por që nuk ishte mendimi juaj
25 personal po ishte një mendim që ndanin shumë njerëz në mënyrë

1 të gjerë dhe ishte në përputhje me raportet që ju i merrnit
2 nga stafi i shtabit suprem të aleatëve në Evropë dhe burime të
3 tjera në këtë kohë.

4 Për çfarë e kishit fjalën?

5 PË. E kisha fjalën se vlerësimi kolektiv në SHAPE, në
6 komandën supreme në atë kohë dhe ajo që kuptonim ne që mund të
7 nxirrnim përmes raportimeve kombëtare ishte se UÇK-ja kishte
8 për qëllim pavarësinë, nuk dukej që kishin nivelin e forcave
9 apo kapacitet e tjera apo strategjinë për ta arritur atë gjë.
10 PY. Dhe ju thatë që kishte një -- ky ishte vlerësim kolektiv
11 i përgjithshëm në komandën e NATO-s dhe burime të tjera. Jeni
12 në gjendje të na thoni kush ishin këto burimet e tjera?

13 PË. Për të folur në përgjithësi këto ishin raportimet në
14 nivel kombëtar tek të cilat kishin një lloj qasje.

15 PY. Tani në këtë takim dhe, kjo është në deklaratën tuaj, ju
16 keni bërë komentin lidhur se si Thaçi erdhi dhe ju tha që ai
17 nuk veproi si komandant ushtarak apo luftëtar. "Ai dukej më
18 shumë si një figurë politike, i arsyeshëm dhe i gatshëm për
19 t'u angazhuar, por i qartë që Kosova duhej të bëhej e
20 pavarur".

21 Tani, kjo ju çoi juve të arrinit në përfundimin se Hashim
22 Thaçi dukej -- çfarë ju çoi juve të mendonit se Hashim Thaçi
23 dukej më shumë si figurë politike sesa komandant ushtarak?

24 PË. Mendoj se kjo ishte bazuar në atë që më kujtohet, lloji i
25 bisedës që u zhvillua, foli pothuajse tërësisht për aspiratat

1 politike, më shumë sesa objektivat ushtarake që mund të
2 kishin. Dhe në këtë kuptim, ai po fliste si udhëheqës politik
3 më shumë sesa komandant ushtarak.

4 PY. Gjatë vitit 1999, a ndryshoi mendimi juaj apo ngeli i
5 njëjti sa i takon faktit që Thaçi ishte figurë politike më
6 shumë sesa -- dhe jo figurë ushtarake?

7 PË. Gjatë kalimit, me kalimin e vitit, gjatë atij viti mendoj
8 që ne u përqendruam kryesisht tërësisht në qëllimet politike
9 të tijat dhe aktivitetet politike të tijat sepse natyrisht ai
10 ishte angazhuar në konkurrencën politike për të ardhmen e
11 Kosovës, për një Kosovë të pavarur dhe aty kishte njerëz të
12 tjerë nga diaspora dhe në Kosovë të cilët aspironin të merrnin
13 rol të njëjtë, role të njëjta. Pra, ai ishte një konkurrencë
14 politike aktive edhe në mes të përpjekjeve të tyre për t'ju
15 rezistuar serbëve.

16 PY. Kush ishin këta konkurruesit e tjerë?

17 PË. Kryesisht, z. Rugova në LDK. Por kishte dhe fraksione të
18 tjera që u krijuan, përfshirë ata që u formësuan si parti
19 politike më vonë.

20 PY. Faleminderit. Tani do të kalojmë tek Marrëveshja
21 Ushtarake Teknike. Në paragrafin 9 të deklaratës, siç është
22 korrigjuar në paragrafin 8 të Shënimit Përgatitor 1, ju e
23 përshkruani se si Gjeneral Clark ju dërgoi juve në Kosovë si
24 përfaqësues të tij në negociatat për Marrëveshjen Tekniko-
25 Ushtarake, e saktë?

1 PË. E saktë.

2 PY. Tani, me pak fjalë, cili ishte qëllimi i këtij dokumenti,
3 kësaj marrëveshjeje?

4 PË. Komandanti, një komandant si Gjenerali Clark që kur
5 merrej me komandantë vartës të tij, siç ishte Gjenerali
6 Jackson, tregonte respekt për rolin dhe përgjegjësitë e
7 komandantit që ishte vartës. Pra, Gjenerali Clark kuptoi se ai
8 nuk mund të ishte pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në ato
9 bisedime, në ato negociata që po zhvilloheshin midis
10 Gjeneralit Jackson dhe përfaqësuesve serbë.

11 PY. E për çfarë po bëheshin këto negociata, cila ishte --

12 PË. Kërkoj ndjesë.

13 PY. -- cili ishte qëllimi?

14 PË. Qëllimi ishte tërheqja e forcave serbe nga Serbia --
15 kërkoj ndjesë, nga Kosova. Dhe për rrjedhojë, kishte ndikim,
16 mision me ndikim të drejtpërdrejtë në atë që për Gjeneralin
17 Jackson. Gjeneral Jackson ishte ngarkuar përgjegjës për të
18 përgatitur këto dhe Gjenerali Clark kishte interes madhor në
19 mënyrën sesi do të zhvilloheshin këto, për çfarë do të bihej
20 dakord dhe do të bëhej marrëveshje por nuk ka luajtur rol të
21 drejtpërdrejtë në të.

22 PY. Dhe ju shkuat atje si përfaqësues i tij, a është e saktë?

23 PË. Po, për të qenë sytë dhe veshët e tij dhe në qoftë se do
24 të ishte e nevojshme dhe zëri i tij.

25 PY. Dhe cili ishte roli juaj? A kishte më shumë se kaq?

1 PË. Më kujtohet vetëm dy herë kur Gjenerali Jackson dhe unë
2 patëm biseda të ndara lidhur me mënyrën se si po shkonin
3 gjërat dhe çfarë duhet, se si të vendosej baza për një mision
4 ushtarak të suksesshëm, një pjesë e saj kishte të bënte me
5 fjalët, termat e marrëveshjes, termat e tërheqjes që do të
6 përdreshin, pra, për tërheqjen e forcave ushtarake serbe. Në
7 fjalë të tjera, kush ishin forcat ushtarake serbe që duhej të
8 tërhiqeshin. Këto ishin temat. Sepse forcat serbe në Kosovë
9 përfshiheshin - ishin jo vetëm ushtria jugosllave e rregullt,
10 forcat serbe, forcat ushtarake por edhe forcat e ministrisë së
11 punëve të brendshme dhe MUP-it dhe disa forcave të tjera jo
12 ushtarake që janë përdorur.

13 PY. Dhe është e saktë, apo jo, se Marrëveshja Ushtarake
14 Teknike krijoi një afat kohor kalendar për tërheqjen e forcave
15 serbe?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe a u tërhoqën forcat serbe?

18 PË. Po.

19 PY. Duke respektuar kalendarin?

20 PË. Po. Forcat serbe të organizuara.

21 PY. Në cilin moment NATO e konsideroi luftën midis UÇK-së dhe
22 Serbisë si të përfunduar, pra, kur kishte përfunduar?

23 PË. Kur forcat serbe të organizuara u tërhoqën nga Kosova.

24 Ata nuk ishin më armiq apo kundërshtarë dhe për rrjedhojë nuk
25 kishte më konflikt.

1 PY. Dhe data, cila ishte data?

2 PË. Në Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake ishte caktuar data,
3 mendoj, në fund të qershorit.

4 PY. A mendoj që ka qenë data 20 qershor. A pajtoheni me këtë?

5 PË. Duket e saktë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Znj. Tavakoli, për cilin
7 konflikt po flisni, konfliktin ndërkombëtar midis NATO-s dhe
8 forcave jugosllave, po pyesni ju apo ndonjë konflikt tjetër jo
9 ndërkombëtar?

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të dyja në fakt, i nderuar
11 Gjykatës.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në atë rast duhet ta
13 saktësoni dhe sepse ky i fundit konflikti jondërkombëtar është
14 çështje për këtë Trup Gjykues dhe për të cilën do të vendosë.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kur -- mendoj se e bëra këtë
16 pyetje. Në cilin moment e ka konsideruar NATO luftën midis
17 UÇK-së dhe Serbisë të përfunduar? Kjo ishte pyetja ime. Pyetja
18 ime në 15:28 ora.

19 PY. Që të jemi të qartë, ju i thatë Gjykatës se ju e
20 konsideruat se NATO mendoi se lufta midis UÇK-së dhe Serbisë
21 kishte përfunduar. Cila ishte lufta -- Marrëveshja Tekniko-
22 Ushtarake për të cilën -- a u bë për të njëjtën luftë, apo jo?

23 PË. Marrëveshja Tekniko-Ushtarake kishte të bënte me
24 marrëdhënien midis NATO-s dhe serbëve, qeveria e Serbisë dhe
25 Jugosllavia.

1 PY. Cila ishte marrëdhënia midis nënshkrimit të MTA,
2 Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake dhe përfundimit të luftës midis
3 Serbisë dhe NATO-s dhe përfundimit të luftës midis UÇK-së dhe
4 Serbisë?

5 PË. Konflikti midis UÇK-së dhe forcave serbe kishte të bënte
6 me përdorimin aktiv të forcave serbe brenda Kosovës. Me sa e
7 di unë UÇK-ja nuk ka bërë asnjë përpjekje të ndërmarrë veprime
8 apo aksione kundër forcave serbe në Serbi, që do të thotë,
9 përtej kufirit të Kosovës, pra, kur nuk do të kishte, kur nuk
10 pati më serbë, forca serbe në Kosovë nuk di se si mund të
11 kishte më konflikt të mëtejshëm pas largimit të këtyre
12 forcave.

13 PY. Faleminderit.

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund të shfaqim tani në ekran
15 dokumentin DHT12201 deri në DHT12205? Dhe tani në qoftë se
16 mund të fillojmë në këtë faqe. Po.

17 PY. A mund ta shikoni këtë dokument, ju lutem, z. Durkee?
18 Mund të lexoni faqen e parë.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dhe pastaj kalojmë shpejt në
20 faqet e tjera dhe kthehemi tek faqja e parë.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mund të kalojmë më shpejt te
23 këto faqe. Faleminderit.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit. Tani mund të

1 kthehemi tek faqja e parë.

2 PY. Kjo thuhet të jetë gazeta zyrtare e Republikës Federale
3 të Jugosllavisë, data 25 qershor 1999, "Vendimi për
4 përfundimin e luftës":

5 "Gjendja e luftës në Republikën Federale të Jugosllavisë
6 ka përfunduar."

7 "Ky vendim hyn në fuqi më 26 qershor 1999."

8 Pastaj kemi "Kuvendin Federal", "Asambleja Federale" dhe
9 datën 24 qershor 1999.

10 Ça është ky dokument, z. Durkee?

11 PË. Ky duket të jetë procesi formal përmes të cilit qeveria e
12 ish-Jugosllavisë mori vendimin për përfundimin e luftës.

13 PY. Cilën datë tregojnë ato si përfundim të luftës?

14 PË. 26 qershor.

15 PY. Për cilën luftë bëhet fjalë?

16 PË. Nuk përmend aty cilat janë forcat armike, por hamendësoj
17 dhe supozoj që bëhet fjalë për konfliktin me NATO-n.

18 PY. Dhe pastaj në qoftë se shkoni më poshtë, ju shihni një
19 pjesë të heqjes së disa rregulloreve të ndryshme të gjendjes
20 së luftës, a pajtoheni me këtë dhe pastaj kemi pjesën tjetër
21 të dokumentit?

22 PË. Po.

23 PY. Faleminderit,

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] do të doja ta paraqes këtë
25 dokument për pranim si provë, ju lutem.

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 147

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'ka
3 kundërshtime.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dorëzojmë edhe faqet e
5 dokumentit në versionin origjinal në serbisht.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më lejoni të
7 përfundoj me të parin fillimisht.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në rregull.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT12201 deri
10 në DHT12205 pranohet.

11 Diçka tjetër që kërkon të pranohet?

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kemi dhe versionin origjinal në
13 serbisht që është DHT1274, DHT12190, DHT12191. Nuk e kisha
14 kuptuar, kërkoj ndjesë, në serbisht është dokument më i madh,
15 ka më shumë faqe. Dhe po dorëzoj thjesht katër faqe, këto
16 katër faqet që përmenda nga ai dokument.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
18 [Përkthim] I kam shënuar më parë DHT12201 deri në 12205 është
19 pranuar.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të më
22 jepni tani numrat e tjerë?

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Është përkthimi anglisht i
24 dokumentit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 148

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dhe janë, ne po dorëzojmë,
2 paraqesim për pranim në prova edhe versionin, dokumentin
3 origjinal që është në serbisht.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
5 [Përkthim] Përveç versionit shqip dhe serbisht?

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, ju lutem. Katër faqet që
7 janë relevante nga përkthimi serbisht.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
9 Atëherë këtë e kam shënuar të parin. DHT1274, 2190, 12191 dhe
10 12195.

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, faleminderit, i nderuar
12 Gjykatës.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Përkthimi në serbisht
15 dhe katër faqet përkatëse në Serbisht do të marrin numrin e
16 provës materiale 1200429. Klasifikimi është publik.

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]
18 PY. Faleminderit, z. Durkee. Tani do të kalojmë në Kosovën e
19 pasluftës.

20 Në paragrafin 15 të deklaratës suaj ju thonë se pas
21 largimit të forcave serbe të Kosovës, ju kishit, patët mundësi
22 të plotë dhe të lira të vërenit dhe realitetin o realitetet në
23 terren në Kosovë. A patët, bëtë vizitë në Kosovë pas luftës në
24 verën e 1999 dhe në qoftë se po sa herë?

25 PË. E kam bërë këtë. Kam qenë rreth katër herë.

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 149

1 PY. Me kë keni qenë atje?

2 PË. Dy herë kam qenë me Gjeneralin Clark dhe dy herë të tjera
3 kam shkuar vetëm.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa kohë keni
5 qëndruar gjatë atyre udhëtimeve atje?

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, nuk kuptova?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndenjtë
8 dy ditë?

9 PË. Pjesë e atyre dy ditëve me Gjeneralin Clark. Pra, kur
10 udhëtuam ndarë, mund të kenë qenë më gjatë dy, tre ditë ose
11 ndoshta dhe katër ditë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, deri në
13 gjashtë, shtatë ditë në tërësi?

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Në tërësi.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

17 PY. Kur udhëtuat me Gjeneralin Clark ndryshe nga udhëtimet që
18 keni bërë vetëm, pra, cili ishte dallimi mes këtyre?

19 PË. Pjesërisht sepse me atë, me Gjeneralin Clark bëheshin
20 mbledhje, takime me Gjeneralin Jackson dhe komandantin e KFOR-
21 it dhe stafin e UNMIK-ut Bernard Kouchner.

22 PY. Më fal që po ju ndërpres një sekondë, është kur ishit
23 vetëm apo me Gjeneralin Clark, kërkoj ndjesë.

24 PË. Mendova se më pyetët se ku ishit me Gjeneralin Clark.

25 PY. Pyetja ime ishte më e gjatë. Ka të bëjë në fakt me -- ta

1 heqim atë. Kur keni shkuar me Gjeneralin Clark -- vazhdoni të
2 tregoni.

3 PË. Siç e thashë, ne kur isha me Gjeneralin Clark bënim
4 takime me përfaqësues ndërkombëtarë të nivelit të lartë në
5 Kosovë, përfshirë Gjeneralin Clark, Bernard Kouchner.
6 Gjithashtu kishim takime dhe me njerëz në Kosovë për të
7 dëgjuar pikëpamjet e ndryshme lidhur me atë që po ndodhte,
8 përfshirë edhe një herë që më kujtohet me z. Rugova i cili
9 ishte kthyer në Kosovë në një moment të caktuar dhe ne po
10 përpiqeshim të kuptonim njerëzit, ça mendonin njerëzit në
11 terren, çfarë po ndodhte dhe çfarë duhej të bëhej.

12 Kur udhëtova në Kosovë, dua të shtoj që ne kishim
13 avantazhin se kur të udhëtoje me Gjeneralin Clark ne
14 fluturonim me helikopter dhe kishim shoqërues për të siguruar,
15 kolonë ushtarake për të na siguruar ne aty ku donim të
16 shkonim. Kur kam shkuar vetëm ka qenë më e vështirë sepse nuk
17 mund ta bëja këtë me një transport të pavarur.

18 PY. Kur keni shkuar në Kosovë, ku shkonit konkretisht?

19 PË. E fillonim nga Prishtina. Mбай mend që në një nga vizitat
20 Gjenerali Clark do shkonte të vizitonte Mitrovicën sepse
21 Mitrovica dukej sikur ishte një zonë e vështirë dhe deshëm të
22 shkonim aty për qëllime ushtarake. Në këtë periudhë kohore
23 ishte e qartë se shumë prej personave që jetonin në atë zonë
24 nuk deshën të pranonin që Kosova ishte pjesë e Serbisë dhe
25 kishte shumë tensione dhe, si pasojë pati shumë akte dhune,

1 pati shumë incidente në urë, në pjesën ndarëse në Mitrovicë.

2 Nuk besoj se në atë kohë Gjenerali Clark ka vizituar
3 Trepçën, pjesën e minierës sepse e dimë që nga shqetësimet do
4 ishte cila do të jetë tani baza ekonomike e Kosovës.

5 PY. Na thoni ku keni shkuar, kjo ka rëndësi, pra, thatë në
6 Prishtinë dhe jashtë Prishtinës?

7 PË. Po përpiqem t'ju tregoj për udhëtimet, kur kemi udhëtuar
8 me helikopter, po kemi udhëtuar edhe me helikopter edhe me
9 automjete dhe i kemi pasur mundësinë të shihnim çfarë ndodhte
10 në zonat mes Prishtinës dhe zonave të tjera në periudhën në
11 fjalë.

12 PY. Kur thoni "periudha", për cilën periudhë e keni fjalën?

13 PË. Para konfliktit, pas konfliktit, kemi parë çfarë ka
14 ndodhur në fshatra dhe në qytete.

15 PY. Dëshiroj t'ju tregoj dy letra nga SACEUR drejtuar Javier
16 Solana.

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po për këtë do të duhet të
18 kalojmë në seancë private.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
20 seancë private.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 152

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 153

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 154

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 155

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 156

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 157

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

5 PY. Pak më herët thatë se kur ishit në Kosovë, keni marrë
6 informacione nga persona të ndryshëm. Më korrigjoni nëse e kam
7 gabim, po mua më thatë që merrnit informacione të përditshme
8 prej KFOR-it, nga stafit i UNMIK-ut, jeni takuar me Bernard
9 Kouchner të SRSG. Po a keni pasur kontakte me shqiptarët e
10 Kosovës?

11 PË. Po dhe me shqiptarët e Kosovës.

12 PY. Po keni takuar anëtarë të botës diplomatike?

13 PË. Jam takuar me diplomatët asokohe, përfshirë dhe të
14 Amerikës.

15 PY. A keni takuar anëtarë të UÇK-së apo të Qeverisë së
16 Përkohshme të Kosovës?

17 PË. Unë kam pasur takime edhe veçmas nga Gjenerali Clark me
18 disa nga personat që punonin në strukturat e TMK-së si dhe me
19 personat që nuk ishin të përfshirë drejtpërdrejt në
20 strukturat qeveritare, për shembull, jam takuar me gazetarë.

21 PY. Me kë?

22 PË. Për shembull, jam takuar me Veton Surroin.

23 PY. A njihni ndonjë shqiptar tjetër të Kosovës -- a ju
24 kujtohet ndonjë shqiptar tjetër i Kosovës që ta keni takuar?

25 PË. Nuk kujtohen emrat. Unë përpigësja të takohesha me

1 persona të ndryshëm.

2 PY. A jeni takuar me Gjeneralin Jackson, Mike Jackson?

3 PË. Po.

4 PY. Sa herë?

5 PË. Sa herë që shkoja i bëja një telefonatë për mirësjellje.

6 Nuk doja të mendonte që unë nuk doja ta takoj dhe hyja në

7 territorin e tij pa e njoftuar.

8 PY. Këto raportime dhe marrëdhënie pune a vazhduan dhe gjatë

9 verës së 1999-s kur nuk ishin më në shtetin përkatës, në

10 vendin përkatës?

11 PË. Po merrnim raportim të vazhdueshëm nga KFOR-i dhe

12 Gjenerali Jackson.

13 PY. Këto raportime vinin nga KFOR-i?

14 PË. Po, merrnim raportime edhe prej UNMIK-ut edhe misione

15 diplomatike që po formoheshin asokohe në Prishtinë.

16 PY. Këto komunikime që keni pasur ju, a ju ndihmuan ju që të

17 formonit pikëpamjet që keni shprehur në deklaratën tuaj sa i

18 takon natyrës së dhunës që gllabëroi Kosovën përfshirë për

19 personat që ishin përgjegjës për këtë dhunë dhe pse po

20 ndodhte?

21 PË. Po.

22 PY. Pra, këto komunikime që ju kanë ndihmuar ju të formonit

23 pikëpamjet tuaja sikurse i keni shkruar në deklaratën tuaj,

24 ishin akte dhune që nuk organizoheshin nga nivelet e larta po

25 ishin raste sporadike nga terreni, apo jo?

1 PË. Ka pasur raste që ekzistonin dyshime për përfshirjen e
2 udhëheqjes së UÇK-së. Mua nuk më kujtohet të kem parë ndonjë
3 provë konkrete personalisht që këto të kenë qenë akte dhune të
4 drejtuara nga UÇK-ja. Unë çfarëdo që dëgjoja ia raportoja
5 Gjeneralit Clark por këto ishin më shumë raste sporadike dhune
6 që ndodhnin në bazë.

7 PY. Këto burimet e informacionit, komunikimet që keni pasur
8 me *Sir* Mike Jackson, Bernard Kouchner a ju ndihmuan po ashtu
9 të formonit pikëpamjet tuaja?

10 PË. Po.

11 PY. Krahës vizitave personale në Kosovë dhe informacionet që
12 sapo na përshkruat që merrnit për natyrën e akteve të dhunës
13 pas luftës, a keni marrë informacione të tjera asokohe, për
14 shembull, nga kanalet qeveritare, drejtoritë përkatëse të
15 NATO-s për burime të hapura edhe kështu me radhë?

16 PË. Po, kemi marrë raportime nga burime të ndryshme,
17 përfshirë nga OJQ-të që ishin gjithnjë e më shumë aktive,
18 përfshirë nga *Human Rights Watch*. Kemi marrë po ashtu nga
19 OSBE-ja, grupet për menaxhimin e krizave. Asokohe edhe
20 gazetarët perëndimorë po udhëtonin më shumë dhe ata po ashtu
21 raportnin.

22 PY. Të gjitha këto informacione ju ndihmuan ju të formonit
23 pikëpamjet tuaja që i keni shprehur në deklaratë?

24 PË. Kanë qenë pjesë e informacioneve që formuan pikëpamjet e
25 mia.

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Është ora 4.00. Nëse dëshironi
2 që të përfundojmë tani?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për sot
4 përfunduar. Do të kthehemi nesër në orën 9.00 dhe shpresojmë
5 që të përfundojmë nesër brenda një orari të arsyeshëm.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
8 që erdhët sot.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shihemi nesër
11 në orën 9.00.

12 --- Seanca mbyllet në orën 15.58

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25